RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE"

Nr.	Emërtimi	*Faqe*
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**2-11**
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**2-2**
2	Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve	**3-8**
3	Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	**9-11**
II	**HYRJA**	**12-15**
1.	Titulli	12-12
2.	Marrësi	12-12
3.	Qëllimi dhe Objektivat	12-12
4.	Identifikimi i çështjes	12-13
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13-13
6.	Përgjegjësitë e audituesve	13-13
7.	Kriteret e vlerësimit	14-14
8.	Standardet e auditimit	14-14
9.	Metodat e auditimit	14-15
10.	Dokumentimi i auditimit	15-15
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**15-85**
	Drejtimi 1: Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.	16-23
	Drejtimi 2: Auditim mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm.	24-30
	Drejtimi 3: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.	31-34
	Drejtimi 4: Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.	35-48
	Drejtimi 5: Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	48-54
	Drejtimi 6: Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".	54-73
	Drejtimi 7: Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	74-76
	Drejtimi 8: Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".	76-81
	Drejtimi 9: Të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	82-86
IV	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**86-106**
V	**ANEKSE**	**107-164**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ñBashkinë Sarandëò, më poshtë e emërtuar ñBSò, për periudhën për periudhën nga data 01.07.2019 deri në 31.12.2020 me objekt ñAuditim Financiar dhe Përputhshmërieò. Auditimi kishte në fokus, tetë drejtime kryesore sipas programit. Në këtë auditim u angazhuan 5 (pesë) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga auditim u konstatuan të meta dhe mangësi në veprimtarinë institucionale, ndër të cilat përmendim; Bashkia Sarandë, Njësi e Qeverisjes Vendore (NJQV) nuk rezulton të ketë ndëmarrë veprime administrative të mjaftueshme në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme të cilat kanë impaktit të lartë financiar. Mbledhja e të ardhurave mbetet sërisht një pjesë e dobët e veprimtarisë institucionale e cila shoqërohet me mungesë të regjistrave të plotë mbi debitorërt mosaplikimin e gjobave/kamatave referuar legjislacionit fiskal. Mangësi evidentohen në bashkëveprimin dhe rakordimin me agjentët tatimor për llogaritjen, mbledhjen dhe transferimin e të ardhurave në buxhetin e NJQV. Procedurat e prokurimit publike paraqesin kufizime në pjesëmarrje rrjedhojë e aplikimit të kritereve të sforcuara të cilat nuk kanë arritur të garantojnë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomik, marrjen e shërbimit në mënyrë plotësisht të dokumentuar. Buxhetet e konsoliduara hartohen dhe miratohen sipas treguesve të viteve të mëparshme dhe nuk përfshijnë nominalisht kërkesat e institucioneve të varësisë si dhe dinamikat institucionale, çka vë në diskutim cilësinë e hartimit dhe zbatimit të tyre. Në punimet e kryera nga shoqëritë ndërtuese në infrastrukturën e NJQV nuk disponohej në të gjitha rastet leja përkatëse për kryerjen e punimeve të ndërtimit e cila ndikon gjithashtu negativisht në imazhin e institucionit si dhe implikon kosto financiare shtesë për subjektet të cilët kanë zbatuar punime në mungesë të lejeve përkatëse. Institucioni vijon të paguaj dëmshpërblime si rrjedhojë e vendimeve të gjykatës për largimeve të padrejta nga puna. Numri i lartë i lëvizjeve në disa prej pozicioneve kyçe ku veçojmë emërimet/komandimet e shpeshta të Kryeinspektorit të IMTV në një hark të shkurtër kohor vetëm disa muaj mbart riskun për mospërmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave funksionale. Nga strukturat përkatëse të BS nuk janë marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për punonjësit e konstatuar me procedurë jo të rregullt emërimi në shërbimin civil të cilët vijojnë veprimtarinë e tyre administrative në mënyrë të parregullt. Mungojnë përshkrimet e punës sipas pozicionit e cila ndikon në ndarje të plotë dhe të qartë të proceseve të punës. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së dhe sistemi i kontrollit të brendshëm paraqitet joeficent. Ndërkohë pavarësisht përpjekjeve Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka arritur të siguroj uljen e problematikave të vazhdueshme të konstatuara në institucion, etj.

Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimeve, Projekt Raportit, observacioneve të paraqitura, takimeve dypalëshe me subjektin e audituar në terren, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.2 Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi paraqitet sa më poshtë:

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi i procesit të mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat, nga ana e Bashkisë Sarandë rezultoi se: **a.** Për vitin 2019, numri i bizneseve debitorë paraqitet 1,996 subjekte dhe vlera e debisë paraqitet 240,293,817 lekë, ndërsa për vitin 2020 numri i bizneseve debitore është 2,313 subjekte dhe vlera e debisë është 286,286,480 lekë. Debitorët e tatim taksave gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë pësuar rritje. Vlera prej **286,286,480 lekë** për taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, është borxh tatimor i pa mbledhur dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në vlerën më sipër, rritja e debisë në terma bruto për periudhën **vitet 2019** dhe **2020** llogaritet **86,436,484 lekë.** **b.** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë, për periudhën nën auditim nuk ka llogaritur në asnjë rast gjoba/kamata për mospagimin në afat të taksave dhe tarifave nga subjektet, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar dhe në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018 ó*Për miratimin e paketës fiskale 2019'*. Kjo Drejtori nuk disponon një databazë analitike të debitorëve, në mënyrë që të llogaritet saktësisht vlera e kamatëvonesave dhe gjobave për secilin debitor, dhe më pas të ndërmerren hapat e mëtejshëm institucional për arkëtimin e tyre. **c.** Regjistri i tatimpaguesve nuk paraqet informacion të plotë, pasi nuk paraqet debinë e mëparshme të mbartur të secilit tatimpagues, por vetëm debinë e vitit ushtrimor. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar dhe nuk ndihmojnë për analizat të nevojshme. **d.** Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH*ò, i ndryshuar, lidhur me mospagimin në afat të detyrimit tatimor, tatimpaguesit duhet të paguajnë gjobë, sikurse përcaktohet në nenin 114 të këtij ligji në vlerën rreth **62,696,739 lekë** gjobë për pagesë të vonuar e llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit, por jo më tepër se 365 ditë, për taksat dhe tarifat vendore të papaguara e cila përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në këtë vlerë përfshihet dhe gjoba për detyrimin e shtuar në **vitet 2019** dhe **2020** e llogaritur në vlerën rreth **18,929,590 lekë**. **e.** Në paketën fiskale të vitit 2019 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018, në pikën B.8, përcaktohet se vlera e gjobës për pagesat e vonuara do të jetë 0,05 % të detyrimit për çdo ditë	**Drejtimi nr. 4** *"Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre."* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 35-48 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Bashkia Sarandë të kërkojë, arkëtimin e vlerave debitore nga bizneset, duke zbatuar sipas rastit edhe masat shtrënguese në zbatim të Kreut XI ñ*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*ò të Ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, konkretisht: -Detyrimet për mospagesën e taksave dhe tarifave **në vlerën 286,286,480 lekë**; -Gjobat për pagesë të vonuar në vlerën **62,696,739 lekë. (**Kjo vlerë të saktësohet pas llogaritjeve të kryera nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore). - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të llogarisë vlerën e saktë të gjobave për pagesë të vonuar/kamatat për çdo debitor për secilin vit, dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere. - Bashkia Sarandë, të marrë masa për të korrigjuar paketën fiskale aktuale në lidhje me nivelin e gjobave për pagesë të vonuar në shumën 0,05% të detyrimit për çdo ditë vonesë, duke e saktësuar në masën 0,06% e detyrimit, por jo më shumë se 365 ditë referuar kuadrit ligjor në fuqi. Bashkia Sarandë, të bashkërendoj veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës (Drejtoria Tatimore Rajonale, Qendra Kombëtare e Biznesit, etj.), dhe të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj. Të zhvillohet korrespondencë e rregullt dhe periodike me QKB-në, QKL-në, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, ZVRPP-në, ALUIZNIN, etj, për të evidentuar bizneset që ushtrojnë

	vonesë. Ky përcaktim i paketës fiskale lidhur me moslikuidimin në afat të taksave dhe tarifave, bie në kundërshtim me përcaktimin e nenit 114 ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet vlera e gjobës për pagesat e vonuara 0,06%. Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë të përcaktojë vlera të ndryshme nga ato që janë përcaktuar në ligj. **f.** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk rezulton të ketë ndërmarrë masa për arkëtimin e detyrimeve dhe nuk ka zbatuar asnjë masë shtrënguese. Deri në përfundim të auditimit në terren , nga kjo Drejtori nuk është dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Siguruese mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò.			aktivitet në territorin e saj por edhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave
2.	Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Sarandë për investimet publike të prokuruara dhe të realizuara gjatë periudhës vitet 2019 dhe 2020 vetëm në 5 raste nga investimet e kryera në infrastrukturë i ka pajisur me lejen përkatëse, ndërsa në 28 raste të tjera punimesh të situacionuara në vlerën 298,470,231 lekë kjo leje mungon, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, i ndryshuar. <u>Mospajisja me lejet përkatëse për kryerjen e punimeve të ndërtimit krijon precedent të gabuar në veprimtarinë institucionale të Bashkisë Sarandë</u> duke qenë financues i këtyre projekteve por gjithashtu dhe organi i cili duhet të kujdeset për garantimin e mbikëqyrjes dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit. Kjo përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore në fuqi. <u>Evidentohet se, institucioni nuk ka arritur të garantojë një bashkëpunim të brendshëm efektiv midis drejtorive për aq kohë sa investimet e veta kanë mbetur të pa pajisura me leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit</u>. Veç aspekteve që lidhen me procesin e mbikëqyrjes së territorit dhe mungesës së koordinimit të brendshëm, kryerja e punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ndikon në mos përfitim të kreditimit të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera në funksion të punimeve të situacionuara nga subjekti ndërtues i cili nuk duhet të kishte filluar punimet në mungesë të saj. Dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë që kryerja e punimeve pa lejet përkatëse ndikon në mospërfitimin e zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Kreditimi i padrejtë i TVSH-së ul padrejtësisht detyrimet e pagueshme në buxhetin e shtetit nga subjekti ndërtues, të cilat mund të shkojnë deri në 93% të TVSH-së së vlerës së punimeve të faturuara, llogaritur në vlerën **55,515,463 lekë**.	**Drejtimi nr. 9** *"Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 82-86 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Bashkia Sarandë të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve konstatimin e KLSH-së mbi mungesën e Lejeve të Ndërtimit të veprave infrastrukturore evidentuar në Aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim vlerësimin e detyrimeve tatimore për TVSH-në në shumën e llogaritur prej rreth **55,515,463 lekë** ndaj subjekteve përkatës.

3.	Nga auditimi rezultoi se, lista që Bashkia Sarandë dispononte mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure brenda territorit të saj, përmbante 15 subjekte që e ushtrojnë këtë aktivitet dhe të cilëve iu ka përfunduar licenca përpara fundit të vitit 2020. -Nga kjo listë, vetëm 1 subjekt, óO shpkô ka bërë rinovim të licencës, ndërkohë pjesa tjetër e subjekteve operojnë pa licencë që nga viti 2015, në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr.970, datë 2.12.2015 dhe në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 344, datë 19.4.2017. Si rrjedhojë, **vlera prej 14,000,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që disponon Bashkia Sarandë e cila nuk rezulton e azhurnuar në terren. Rregullisht, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të verifikonte në terren nëse subjektet e kësaj liste operojnë aktualisht në treg, kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimi, apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë. Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin e subjekteve që operojnë pa licencë dhe për arkëtimin e tarifave, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15.1 të VKM nr.970, datë 2.12.2015. Gjithashtu, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh. Në këtë drejtim vihet re një neglizhencë totale nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë Sarandë për kontrollin e këtyre subjekteve lidhur me detyrimet tatimore të cilat kanë ndikime financiare në buxhetin e NJVV.	**Drejtimi nr. 4** *"Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre."* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 35-48 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	-Bashkia Sarandë, pas kryerjes verifikimeve përkatëse, mbi vijueshmërinë e aktivitetit nga këto 14 subjekte për vitet 2019 dhe 2020, duke shfrytëzuar të dhëna të nevojshme nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, QKB si dhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **14,000,000 lekë (** 1,000,000 lekë/ licencë). -Bashkia Sarandë, të verifikoj të gjitha subjektet me objekt aktiviteti ñTregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëseò të cilët operojnë në territorin e saj dhe për subjektet të cilët operojnë pa licencë duke kryer pezullimin e aktivitetit të tyre deri në licencimin konform legjislacionit në fuqi. -Bashkia Sarandë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh duke kryer kontrolle të vazhdueshme në terren si dhe duke marrë të dhëna zyrtare nga QKB apo Drejtoria Rajonale e Tatimeve.
4.	Nga auditimi rezultoi se, në relacionin e mbajtur nga komisioni i inventarizimit, më datën 19.12.2019 pas verifikimit në terren, është evidentuar mosrakordim ndërmjet gjendjes kontabël dhe asaj fizike. Ky mosrakordim material kishte të bënte me kontejnerët e mbeturinave të cilët i janë dhënë në dorëzim operatorit ekonomik ñK ò SHPK me NIPT J G, i cili ka lidhur kontratën e pastrimit të qytetit të Sarandës për vitin 2018. Sasia e kontejnerëve të munguar, që kanë qenë nën përgjegjësi të operatorit ekonomik ñK ò SHPK është 155 kontejnerë metalik dhe 13 kontejnerë plastik. Për këtë arsye, nga komisioni i inventarizimit më datë 25.11.2019 është mbajtur një procesverbal ku specifikohet mungesa e kontejnerëve të sipërcituar. Referuar kontratës që autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë ka me operatorin ekonomik ñK ñ SHPK në nenin 26.1 pika citohet ñ Mirëmbajtja dhe siguria e kontejnerëve do të kryhet nga sipërmarrësiò. Mungesa e inventarëve kontejnerë mbeturinash me vlerë kontabël **5,365,918 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë**.	**Drejtimi nr. 5** *"Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, ..."* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 48-54 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Nga Bashkia Sarandë, të marren masa për arkëtimin e vlerës **5,365,918 lekë nga operatori ekonomik "K " SHPK me NIPT J G** duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, duke iu referuar dhe kontratës së lidhur mes palëve për kryerjen e shërbimit, si dhe të nxirren përgjegjësitë ndaj përgjegjësve material në Bashkinë Sarandë.

5.	Nga auditimi rezultoi se, në vitin 2019 rezulton të jenë paguar 4,391,882 lekë për vendimet gjyqësore si rrjedhojë e dëmshpërblimit të akorduar për largim të padrejtë nga puna të punonjësve. Gati gjysma e këtyre vendimeve i përkasin viteve të mëparshme ndërsa vlera prej 1,969,060 lekë janë vendime të cilët kanë marrë formë të prerë gjatë vitit 2019. Pagesa e dëmshpërblimeve paraqitet në vlerën prej 2,964,509 lekë dhe pjesa tjetër përbëhet nga pagesa e tarifës përmbarimore prej 1,427,373 lekë. Për vitin 2020 vlera e dëmshpërblimeve të paguara për largim nga puna është 950,000 lekë, pa pagesë të tarifës përmbarimore, ndërsa për periudhën janar-shkurt 2021 paraqitet 381,350 lekë. Për vitet 2019-2021/02 evidentohen në total **5,723,232 lekë** efekte financiare negative në buxhet si rezultat i zbatimeve të vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna. Problematika e krijuar evidenton nevojën për qasje institucionale më të kujdesshëm nga nivelet menaxheriale mbi marrëdhëniet e punësimit në vijim.	**Drejtimi nr. 3** *"Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ..."* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 31-34 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Titullari i Bashkisë Sarandë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet, përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe të marrë masat e nevojshme për eliminimin e procedurave të parregullta në largimin e punonjësve dhe efekteve negative që këto vendime krijojnë në buxhetin e njësisë vendore. - Bashkia Sarandë të ndjekë proceset në të gjitha shkallët e gjykimit duke u kujdesur që të evitohet tarifa e shoqërive përmbarimore e cila rëndon padrejtësisht buxhetin e njësisë vendore.
6.	Nga auditimi i procedurës së prokurimit *Rikonstruksion i Ujësjellësit Ksamil (Depo+Rrjeti shpërndarës-lagja nr.3 dhe nr.4", viti 2020"* rezultoi llogaritje e gabuar e fondit limit. Në këtë procedurë me urdhrin e prokurimit nr. 24 datë 12.10.2020, protokoll ska, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka caktuar një shoqëri private R S shpk, për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë tender. Kjo shoqëri ka hartuar projektin përkatës të këtij investimi i cili është përcjell nga Ujësjellës Kanalizimet SHA, Sarandë me shkresën nr. 396/4 prot, datë 16.09.2020. Baza ligjore e përdorur në urdhër është VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 59 dhe 61 pika 2 e tij. Nga ana e R S shpk nuk është hartuar një procesverbal apo akt i cili të përcaktojë fondin limit por në dosje gjendet vetëm një preventiv zbatimi punimesh i ndërtuar bazuar në manualin e punimeve të ndërtimit/2015 me një vlerë fondi limit 131,206,085 lekë. Nëse do ti referohemi relacionit teknik të paraqitur nga R S shpk, (në faqen e tij të parë i referohet vitit 2018 ndërsa firma elektronike në fund të materialit mban datën 13.10.2020). Në të përshkruhen llogaritjet e volumeve të projektit të cilat janë dukshëm më të vogla se preventivi i hartuar. Nga auditimi u evidentuan ndryshime në volume lidhur me zërin ñGërmimeò i cili në relacion paraqitet 8,553.5 m3 (7,553.5+1,000) nga të cilat 1,000 m3 paraqitet volumi i depos së ujit, ndërsa në preventiv ky zë punimi paraqitet 11,032 m3 ose 2,478.5 m3 më tëpër në vlerën 2,974,200 lekë pa tvsh. Ndërkohë, zëri ñMbushje me material të gërmuarò paraqitej në relacionin teknik në volumin 5,257.3 m3 ndërsa në preventiv paraqitej 12,230 m3 ose 6,972.7 m3 më tepër në vlerën 3,486,350 lekë pa tvsh. Efekti financiar llogaritet në shumën **6,460,550 lekë.**	**Drejtimi nr. 6** *"Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik.."* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 54-73 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	- Bashkia Sarandë të analizojë procedurën e hartimit në mënyrë të pasaktë të fondit limit për objektin, *"Rikonstruksion i Ujësjellësit Ksamil (Depo+Rrjeti shperndares-lagja nr.3 dhe nr.4"* në vlerën prej **6,460,550 lekë** dhe të nxjerr përgjegjësitë përkatëse. - Bashkia Sarandë nëpërmjet një grupi pune me specialist të fushës, të kryej verifikimet e nevojshme mbi punimet e kryera në vepër për zërin ñGërmimeò dhe ñMbushje me material të gërmuarò, të evidentuar nga ana jonë me diferencë midis volumeve të parashikuara në relacionin teknik dhe preventivin e hartuar, duke reflektuar korrigjimet e nevojshme në situacionin përfundimtar.

7.	Nga auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH rezultoi se: -Auditimi i mëparshëm i zhvilluar nga KLSH në Bashkinë Sarandë është kryer sipas programit të auditimit nr. 365/1 datë 28.05.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2019. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 365/7 prot. datë 27.09.2019. Në vijim, me auditimin tematik të KLSH-së referuar programit të auditimit nr. 610 prot, datë 25.06.2020 është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna ku dhe është rikërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve e konstatuara me status të pazbatuar, zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi. Raporti Përfundimtar i auditimit tematik mbi zbatimin e rekomandimeve dhe shkresa përcjellëse e KLSH, janë administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 5229 prot, datë 07.12.2020. -Bashkia Sarandë ka kthyer përgjigje mbi planin e masave të marra për zbatimin e rekomandimeve ***në tejkalim të afatit 20 ditor të parashikuar*** nga neni 15, shkronja ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò. Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë: ***a.*** *Janë rekomanduar **15**(pesëmbëdhjetë) **masa organizative**, nga të cilat **pa zbatuar 10**(dhjetë), **në proces zbatimi 4**(katër) dhe **zbatuar pjesërisht 1** (një) masë.* ***b.*** *Janë rekomanduar **13**(trembëdhjetë) **masa për shpërblim dëmi**, nga të cilat janë **pa zbatuar 13**(trembëdhjetë) masa.* ***c.*** *Janë rekomanduar **5**(pesë) **masa për uljen e borxhit tatimor**, nga të cilat janë **pa zbatuar 5**(pesë) masa.* ***d.*** *Janë rekomanduar **4**(katër) **masa për eliminimin e efekteve negative**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 4**(katër) masa..* ***e.*** *Janë rekomanduar **18**(tetëmbëdhjetë) **masa administrative**, nga të cilat janë **pa zbatuar 3**(tre), **15** (pesëmbëdhjetë) masa janë **në proces zbatimi.*** ***f.*** *Janë rekomanduar **9**(nëntë) **masa disiplinore**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 9**(nëntë) masa.* ***g.*** *Është rekomanduar **1**(një) **masë për njoftimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**, e cila gjendet **e pa zbatuar**.* Sa më lart rezultoi se, numri i rekomandimeve të zbatuara nga ana e Bashkisë Sarandë mbetet në nivel të ulët pavarësisht pranimit dhe angazhimeve institucionale të marra. Megjithëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga përcjellja e tyre dhe efektet financiare të konstatuara kapin vlera të konsiderueshme mungojnë veprimet administrative të nevojshme për përmbushjen e tyre. Ndërkohë disa prej rekomandimeve megjithëse janë zbatuar në afate tepër të gjata nuk përputhen me masën e rekomanduar. Gjetjet e konstatuara në auditimet	**Drejtimi nr. 7** *"Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit"* *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 74-76 dhe 118-162 të Raportit Përfundimtar*	E lartë	-Bashkia Sarandë të marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH të cilat evidentohen me status, *i pazbatuar, i zbatuar pjesërisht* apo *në proces zbatimi*, evidentuar në **Aneksin nr. 6** të Raportit Përfundimtar të Auditimit, me qëllim përmirësimin e gjendjes, rikuperimin e vlerave financiare të evidentuara si dhe vendosjen përpara përgjegjësisë të personave të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë sjellë pasoja negative në veprimtarinë e institucionit.

	e KLSH nuk rezultojnë të jenë paraqitur për analizë apo diskutim në Këshillin Bashkiak sa i përket problematikave të evidentuara si dhe masave të të marra për përmirësim. Mangësitë e vërejtura mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në vijimësi nga KLSH si dhe masat e pamjaftueshme të marra në kuadër të përmirësimit të situatës, evidentojnë nevojën për rishikimin e mënyrës së qasjes institucionale në këtë drejtim. Kjo për shqyrtimin dhe marrjen e veprimeve administrative të përshtatshme në afate kohore të shkurtra, me cilësi të lartë vendimmarrëse, në kuadër të detyrave të caktuara nga ligjvënësi në mbrojtjen e interesit publik.			

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Nga auditimi i kryer në ñBashkinë Sarandëò u konstatuan të meta dhe mangësi në veprimtarinë institucionale të cilat evidentohen por nuk kufizohen në:

-Nga ana e Bashkisë Sarandë mungojnë veprime administrative të mjaftueshme në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëna pavarësisht në pranimit të tyre, angazhimeve institucionale të marrarëndësisë dhe impaktit të lartë financiar që ato kanë.

-Mbledhja e të ardhurave sërisht mbetet një pjesë e dobët e veprimtarisë institucionale.

-Mangësi evidentohen në bashkëveprimin dhe rakordimin me agjentët tatimor për llogaritjen, mbledhjen dhe transferimin e të ardhurave në buxhetin e BS.

-Prokurimet publike të kryera sërisht paraqesin kufizime në pjesëmarrje nëpërmjet aplikimit të kritereve diskriminuese apo favorizuese.

-Buxhetet e konsoliduara hartohen dhe miratohen sipas treguesve të viteve të mëparshme dhe nuk përfshijnë nominalisht kërkesat e institucioneve të varësisë dhe dinamikat institucionale, çka vë në diskutim cilësinë e hartimit dhe zbatimit të tyre.

-Evidentohet numër i lartë lëvizjesh në disa prej pozicioneve kyçe ku veçojmë emërimet/komandimet e shpeshta të Kryeinspektorit të IMTV në një hark të shkurtër kohër vetëm disa muaj.

-Në punimet e kryera nga shoqëritë ndërtuese në infrastrukturën e NJQV jo në të gjitha rastet disponohej leja përkatëse të ndërtimit.

-Si rezultat i largimeve të padrejta nga puna buxheti i Bashkisë cënohet në vazhdimësi duke paguar persona (ish-punonjës) të cilët nuk japin kontributin e tyre në punë.

-Nga strukturat përkatëse të BS nuk janë marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për punonjësit e konstatuar me procedurë jo të rregullt emërimi në shërbimin civil të cilët vijojnë veprimtarinë e tyre administrative në mënyrë të parregullt.

-Institucioni vijon funksionimin pa përshkrime pune të miratuara prej një kohë të gjatë.

-Mungon zbatimi dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së dhe sistemi i kontrollit të brendshëm paraqitet joeficent.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm pavarësisht përpjekjeve nuk ka arritur të siguroj uljen e problematikave të vazhdueshme të konstatuara në institucion.

Opinioni i auditimit mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2019

Për drejtimin e Bashkisë Sarandë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Sarandë, për vitin ushtrimor 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare.

Opinion i pamodifikuar, me theksim cështjeje[1]:

Në vlerësimin tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705[2], dhe (ISSAI 1200[3]), pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñTheksimi i Çështjesò.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim cështjeje:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Sarandë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e ***opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes.***

Theksimi i çështjeve:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Sarandë, sa i takon llogarive të mëposhtme**:**

- Llogaria 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò është pasqyruar më shumë për vlerën 1, 451,340 lekë;
- Llogaria 202 ñStudime e kërkime″ është pasqyruar më shumë për vlerën 104.693,177 lekë
- Llogaria 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò është pasqyruar më pak për vlerën 2,000,000 lekë;
- Llogaria 467 ñ Kreditorë të ndryshëmò është pasqyruar më pak për vlerën 38,910,086 lekë.

---

[1] ***Opinioni i pamodifikuar me theksim cështjeje.*** *Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*

[2] *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

[3] *Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Sarandë

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Sarandë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinioni i auditimit mbi Përputhshmërinë

-Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Sarandë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, në rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, garantimin e të drejtave për mbrojtje e përfshirje sociale dhe për përkujdesje sociale, (kriteret e auditimit Përputhshmërie), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[4]

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë[5], i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit Përputhshmërie së KLSH-së, i kryer në subjektin Bashkia Sarandë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në

[4] Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e KLSH-sëò

[5] Një opinion *i kualifikuar* shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar mbi përputhshmërinë.***

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000[6])

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit Përputhshmërieò. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Sarandë rezultoi se:

Nga ana e institucionit mungojnë veprime administrative të mjaftueshme në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme, pavarësisht pranimit të tyre, angazhimeve institucionale të marra, si dhe rëndësisë e impaktit të lartë financiar që ato kanë. Problematika janë evidentuar, në proceset e mbledhjes dhe kontabilizimit të të ardhurave, bashkëveprimin jo në nivelin e kërkuar me agjentët tatimor në mbledhjen e tyre, në procedurat e prokurimit publik dhe marrjes në dorëzim të mallrave, punëve e shërbimeve të prokuruara, në procesin e buxhetimit, konsolidimin dhe argumentimin e tij, numrin e lartë të ndryshimeve në disa prej pozicioneve kyçe të institucionit, mungesën e lejeve për ndërtimin e veprave publike, vlera të konsiderueshme të paguara për largime të padrejta nga puna, mungesën e dokumentit për përshkrimet e punës, moszbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së, të cilat në gjykimin tonë kanë ndikuar negativisht në veprimtarinë e institucionit. Vlera totale e parregullsive me efekt financiar për vitet 2019-2020 arrin në rreth **244.8 milion lekë.**

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

[6] **ISSAI 4000** ï Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñMbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi ñBashkinë Sarandëò, në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 101/1 prot, datë 04.02.2021, ndryshuar me shkresën nr.101/2 prot, datë 04.03.2021 dhe shkresën nr.101/3 prot, datë 02.04.2021 për periudhën e auditimit nga data 01.07.2019 deri në 31.12.2020, me afat auditimi nga data 08.02.2021 deri më datë 16.04.2021, dhe lloj auditimi ñAuditim Financiar dhe Përputhshmërieò, i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K X Përgjegjës grupi
2. M M
3. E C
4. E M
5. S M

Titulli:
Raporti Përfundimtar i Auditimit ñAuditim Financiar dhe Përputhshmërieò në Bashkinë Sarandë.

Marrësi:
Ky Raporti Përfundimtar i adresohet Kryetarit të Bashkisë Sarandë Z. A G .

Objektivat dhe qëllimi:
Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga ñBashkia Sarandëò, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizmit, të efiçencës, dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.
Përbushja e qëllimit të auditimit në, dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e te cilave ushtron veprimtarinë ñBashkia Sarandëò. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për tôu bërë publike.

Identifikimi i çështjes:
Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së ñBashkia Sarandëò, për periudhën objekt auditimi nga 01.07.2019 deri më 31.12.2020, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:
Mbi shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm dhe masat e marra nga Institucioni për zbatimin e tyre, veprimet adminstrative të ndërmarra për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, bashkëveprimin për mbledhjen e detyrimeve nëpërmjet agjentëve tatimorë, procedurat e ndjekura në hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, përputhshmërinë e procedurave të ndjekura në kryerjen e shpenzimeve vjetore, hartimin e pasqyrave financiare vjetore konform kuadrit ligjor mbi raportimin financiar, funksionalitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përmbushjen e detyrimit funksional e

ligjor nga struktura e auditimit të brendshëm si garant i kontrollit të brendshëm, marrëdhëniet e punësimit në institucion dhe të tjera çështje të vlerësuara të rëndësishme për auditimin.

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe hartimin e Pasqyrave Financiare:

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar si dhe akteve ligjore e nënligjorë e rregullative të dala në zbatim të tij.

-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-*Nëpunës zbatues,* i caktuar si është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiar të institucionit.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar;

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Hartimi i Pasqyrave Financiare vjetore është kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për përgatitjen dhe raportimin e tyre, (*ISSAI 1700*). Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor **2019**.

Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara *(ISSAI 4000),* nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300);

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse.(ISSAI 1500/ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-tò, si dhe ISSAI 30 ñKodi Etikò, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Kriteret e vlerësimit:
-Ligji nr 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër Financat e Vetëqeverisjes Vendoreò;
-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, i ndryshuarò;
-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 92/2014, datë 24.07.2014 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
-Ligji nr. 125/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar;
-VKM nr. 142 datë 12.03.2014 ñPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në Institucionet e Administrates Shtetërore dhe Institucionet e Pavaruraò, i ndryshuar;
-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar;
-Akte të tjera ligjore, nënligjore, e rregullative, të detyrueshme për zbatim.

Standardet e Auditimit
Auditimi u bazua në:
-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Manualin e Auditimit Financiar dhe atij Përputhshmërie, Rregulloren ñPër Procedurat e Auditimitò miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, e ndryshuar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI);
-ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò ku përcaktohen parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
-ISSAI 4000 ñStandarti i Auditimit Përputhshmërieò;
-ISSAI 1700 òOpinioni në auditimin e Pasqyrave Financiareò.
-ISSAI 10 ñDeklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-tò, si dhe
-ISSAI 30 ñKodi i Etikës:
Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC etj.

Metodat e auditimit
Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:
(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve. Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në;
-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.
-*Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare.

-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.
-*Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.
-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-konstatimeve të mbajtur, Projekt Raportit të Auditimit dhe observacioneve të paraqitura përgjatë secilës fazë, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III- PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

-Bashkia Sarandë organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò *dhe* ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò, akteve ligjore/nënligjore si dhe rregullores së brendshme të institucionit.

Bashkia Sarandë në kuadër të reformës territoriale, kjo njësi ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në sipërfaqe, në territor dhe në popullsinë e saj, ku veçori kryesore është dhe bashkimi i territorit të njësisë administrative e Ksamilit me të.
Bashkia Sarandë përbëhet nga qyteti i Sarandës, Fshati Ksamilit si dhe nga fshatrat Gjashtë, Metoq, Çukë, dhe Shelegar. Sipërfaqja administrative e saj arrin në rreth ***58.96 Km²***, me një popullsia civile të regjistruar e cila arrin në rreth ***55,680 banorë***.
Saranda, është një ndër destinacionit kryesore turistike për Shqipërinë. Zhvillimi urban, ka krijuar mundësinë që në qytet të vendosen një numër i konsiderueshëm strukturash hotelerie të cilat e shndërrojnë Sarandën (së bashku me Ksamilin) në një prej destinacioneve më të rëndësishme turistike.

2. Forma dhe mënyra e organizimit
Struktura organizative aktuale e Bashkisë Sarandë është miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 43 datë 23.12.2019 me 123 punonjës gjithsej, sipas pasqyrës më poshtë:

EMERTIMI	***Nr. punonjësish***
Kryetari	*1*
Nënkryetar	*3*
Sekretar i Përgjithshëm	*1*
Kabineti Kryetarit	*4*
Sekretar i Këshillit Bashkiak	*1*
Drejtorie e Taksave Vendore	*12*

Drejtoria e Planifikimit të Territorit	*7*
Drejtoria e Shërbimeve Publike	*9*
Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar	*6*
Drejtoria Juridike	*5*
Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore	*14*
Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar	*6*
Drejtoria e Turizmit, Projekteve dhe Integrimit Europian	*9*
Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, pyjeve, ujitjes dhe Kullimit	*8*
Drejtoria e Policisë, Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit	*20*
Auditi i Brendshëm	*3*
Drejtoria e Kujdesit Social	*14*
Total punonjës	***123***

Aktiviteti i BS është audituar së fundi nga KLSH sipas programit nr. 365/1 prot, datë 28.05.2019, i ndryshuar, për periudhën 01.01.2017-30.06.2019 me lloj auditimi ñAuditimi Financiar dhe Përputhshmërieò. Auditimi ka rezultuar me dhënien e një *opinioni të kualifikuar* mbi Pasqyrat Financiare 2017 dhe 2018 edhe ñPërputhshmërinë e aktivitetitò.

Drejtimi 1: ***Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.***

1. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK

1.2 Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi

1.3 Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike. Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

a) veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
b) pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
c) informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
ç) mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Titullarët e njësive të sektorit publik zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet këtyre komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

a) ***Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike****;*

Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcakohet se ó*Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje'*. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, ñPër rregullat e etikës në administratën publikeò, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Sarandë nuk disponon Kod Etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuara të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

b) Politikat menaxheriale dhe stili i punës;

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***a)*** *miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*ô. Për sa më sipër rezulton se Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK, përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***b)*** *ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*ô. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ó*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave'*. Grupit të

auditimit i janë paraqitur dy urdhra: Urdhri nr.35/1 datë 11.09.2019 óPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit buxhetor të vitit 2020ô dhe Urdhri nr. 101 datë 04.08.2020 óPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit buxhetor të vitit 2021ô ku në të dy rastet urdhërohet ngritja e grupit të menaxhimit stratgjik për hartimin e buxhetit vjetor. Por grupit të auditimit nuk i është paraqitur urdhri i titullarit në të cilin përcakton ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, si organ i rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar të njësisë publike dhe në sistemin e kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit për MFK. Nga kjo rezulton se për vitin 2019 dhe 2020 titullari i Bashkisë Sarandë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 óPër përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeô, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se *óGMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'*. Për sa më sipër, për periudhën 2019 dhe 2020 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS.

Në nenin 10 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se *óKoordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues mund t'i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës.*ô Me Urdhrin nr. 139, datë 30.09.2020, Titullari ka caktuar kordinatorin e riskut për Bashkinë Sarandë, Znj. L Q . Për sa më sipër, nëpunësi autorizues i Bashkisë Sarandë është caktuar Z. R Ç nëpërmjet shkresës nr. 3004 prot, datë 23.07.2020. Në këtë rast, përgjegjësinë e koordinatorit të MFK dhe të riskut, e ka nëpunësi autorizues dhe është ai që duhet të delegojë disa prej detyrave. Për më tepër, nuk mund të delegohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë, por sikurse përcakton ligji, disa prej tyre. Në urdhrin e caktimin të koordinatorit të riskut, nuk përcaktohen se cilat nga detyrat janë deleguar.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Bashkia Sarandë e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 34 datë 05.06.2008 ó*Rregullore e funksionimit të brendshëm administrativ të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në varësi*ô. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.

Bashkia Sarandë disponon disa përshkrime pune, por këto nuk kanë datë se kur janë bërë, gjithashtu edhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ó*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*ô në të cilin përcaktohet se óProcesi i vlerësimit të punës ndjek këto faza: a) krijimi i komitetit të vlerësimit; b) identifikimi i pozicionit/pozicioneve të punës që do të vlerësohen; c) vlerësimi me faktorë dhe pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit të pozicionit të punës; ç) klasifikimi i pozicionit të punës në kategorinë, klasën dhe grupin përkatësô. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga

DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ôDepartamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore: a) miraton propozimin për klasifikim të pozicionit/pozicioneve të punës; b) kthen për rivlerësim pozicionin/pozicionet e punës dhe vendos një afat të arsyeshëm për plotësimin e rivlerësimitô.

Titullari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet shkresës nr. 3004 prot, datë 23.07.2020, ka njoftuar Drejtorinë e Harmonizimit të kontollit të brendshëm financiar mbi miratimin e Z. R Ç si Nëpunës Autorizues i Bashkisë Sarandë. Deri më këtë datë, kompetencat e NA janë kryer nga vetë Kryetari.

Kompetencat e nëpunësit zbatues aktualisht kryhen nga znj. T S , Drejtore në Drejtorinë Ekonomike në Bashkinë Sarandë, ku nëpërmjet shkresës nr.1367 prot, datë 07.06.2012, është autorizuar për të drejtë firme të dytë për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për institucionin, nga ish Kryetari i Bashkisë Sarandë Z. S Ç . Në këtë shkresë nuk përcaktohet se znj. S miratohet si nëpunës zbatues, si dhe nuk është njoftuar Drejtoria e Harmonizimit të kontollit të brendshëm financiar. Gjithashtu, nëpunësi zbatues ka një sërë detyrash dhe përgjegjësish dhe jo vetëm firmën e dytë për llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve për institucionin.

ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, sikurse përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 ó*Për nëpunësin civil'* ó*Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. Vlerësimi i rezultateve në punë synon përmirësimin e aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit'.* Gjithashtu, Bashkia Sarandë nuk disponon një program trajnimi për punonjësit.

2. Menaxhimi i riskut
Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Për t'i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*ô Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296.

Gjithashtu, ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuarô ku përcaktohet se ó*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë*ô.

Bashkia Sarandë nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.

Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eleminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

3. Veprimtaritë e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Bashkinë Sarandë, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësieve.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi'*. Për sa më sipër, rezulton se Titullari i Bashkisë Sarandë për vitet 2019 dhe 2020 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

4. Informacioni dhe komunikimi

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.
Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Sarandë, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.

Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Sarandë ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 óPër të drejtën e informimitô ku në nenin 4 përcaktohet se ó*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni'*. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim me këtë ligj ku në nenin 8 përcaktohet se ó*Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj*

*dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër*ô.

5. Monitorimi

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësive të varësisë janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike, për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave, ose risqe, të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë*ô. Për sa më sipër, nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të instucioneve të varësisë në Bashkinë Sarandë mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se Bashkia Sarandë nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, përcaktohet se ó*Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual'*. Për sa më sipër, për vitin 2019 dhe 2020 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Sarandë nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.

Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezulton se strukturat drejtuese të Bashkisë Sarandë nuk e zbatojnë kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 0296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim tij.

Titulli i gjetjes nr. 1	**Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit**
Situata:	Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se: 1. Bashkia Sarandë nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuara të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të

interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullin III, pika 3.1 tëManualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

2. Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
3. Për vitin 2019 dhe 2020 titullari i Bashkisë Sarandë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.
4. Për periudhën 2019 dhe 2020 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 óPër përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeô
5. Titullari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet Urdhrit nr. 139, datë 30.09.2020 ka caktuar kordinatorin e riskut për Bashkinë Sarandë, Znj. L Q .Në këtë rast, përgjegjësinë e koordinatorit të MFK dhe të riskut, e ka nëpunësi autorizues, i cili është Z. R Ç i caktuar nëpërmjet shkresës nr. 3004 prot, datë 23.07.2020 dhe është ai që duhet të delegojë disa prej detyrave, dhe jo Titullari. Për më tepër, nuk mund të delegohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë, por sikurse përcakton ligji, disa prej tyre. Në urdhrin e caktimin të koordinatorit të riskut, nuk përcaktohen se cilat nga detyrat janë deleguar.
6. Bashkia Sarandë kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 34 datë 05.06.2008. Kjo rregullore është e vjetër dhe e papërditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.
7. Bashkia Sarandë disponon disa përshkrime pune, por këto nuk kanë datë se kur janë bërë, gjithashtu edhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ó*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*ô. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të këtij Vendimi.
8. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve. Gjithashtu Bashkia Sarandë nuk disponon një program trajnimi për punonjësit.
9. Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.
10. Ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296 për MFK.Bashkia Sarandë nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.
11. Titullari i Bashkisë Sarandë për vitet 2019 dhe 2020 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
12. Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Sarandë, është e paqartë

	dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komuniukimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit. 13. Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Sarandë ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 óPër të drejtën e informimitô. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim nenin 8 të këtij ligji. 14. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të instuitucioneve të varësisë në Bashkinë Sarandë mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK. 15. Bashkia Sarandë nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK. 16. Për vitin 2019 dhe 2020 rezulton se nënpunësi autorizues i Bashkisë Sarandë nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.
Kriteri:	- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27. - Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1. - Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ó*Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike'*. - Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, ñ*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*ò, i ndryshuar. - Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, ñ*Për rregullat e etikës në administratën publike*ò. - Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ó*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*ô, neni 24; neni 35. - Ligji nr. 152/2013 ó*Për nëpunësin civil',* neni 62. - Ligji nr. 119/2014 ó*Për të drejtën e informimit'* neni 4; neni 8.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjëllë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve financiare publike. Gjithashtu ka ndikuar negativisht në performancën institucionale për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë.
Shkaku:	-Mos zbatimi i kuardit ligjor dhe nënligjor nga titullari i institucionit, nëpunësi autorizues dhe personat e tjerë përgjegjës për MFK
Rëndësia:	E lartë

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, A G , R Ç dhe T S .

Drejtimi 2: ***Auditim mbi Njësinë e Auditit të Brendshëm.***

- Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditit të brendshëm:
Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, ñPër miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publikò, Bashkia Sarandë e ka të ngritur Njësinë e Auditit të Brendshëm.

Në vitin 2019, Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Bashkisë me vendim Nr. 79, datë 29.12.2018, ñPër miratimin e buxhetit të Sarandës për vitin 2019ò dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 9, datë 30.01.2019, të ndryshuar në Urdhërin Nr. 9/1, datë 23.09.2019 ñPër detajimin e strukturës dhe nivelin e pagave të institucionit të Bashkisë Sarandë dhe Insticioneve në varësiò.

Drejtoria e Auditimit në Bashkinë Sarandë nuk është ngritur dhe organizuar sipas ñRregullores së Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Bashkisë Sarandë dhe Institucioneve të varësisëò në nivelin e Drejtorisë të Auditimit, në strukturën organizative të miratuar me VKB Sarandë nr. 34, datë 05.06.2008. Përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të NJAB paraqitet në strukturën organizative të miratuar me VKB Sarandë nr. 34, datë 05.06.2008 për drejtorin dhe specialistin.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 06.05.2021, nr. 2105 Prot., Bashkia Sarandë ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se: "Në akt-konstatim ju thoni së struktura e AB në Bashkinë Sarandë nuk është ngritur sipas VKM nr.83, datë 03.02.2016, ku Njësia e AB përbehët nga tre specialist dhe i referoheni periudhës Janar - Mars 2019, periudhë e cila nuk është në periudhën e auditimit nga ana juaj, sipas programit të miratuar.Për periudhen për auditim nga ana juaj, Njësia e AB është ngritur dhe funksionon sipas VKM-së së mesipërm".

Përgjigje- Grupi i auditimit shqyrtoi observacionin duke ritheksuar se duke filluar nga data 21 gusht 2019 struktura ka në përbërje të saj drejtorin Z. M si dhe dy specialistët: Znj. K dhe Znj. S . Z. M është emëruar "Drejtor i Auditit të Brendshëm", në Drejtorinë e Programimit, Zhvillimit dhe Turizmit, me aktin nr. 88, datë 21.08.2019.

Në vitin 2020, Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon sipas strukturës së miratuar nga Këshilli i Bashkisë me Vendimin Nr. 43, datë 23.12.2019, ñPër miratimin e buxhetit të Sarandës për vitin 2020ò dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13, datë 27.02.2020, të ndryshuar në Urdhërin Nr. 81/1, datë 03.07.2020, ñPër detajimin e strukturës dhe nivelin e pagave të institucionit të Bashkisë Sarandë dhe Insticioneve në varësiò. Në vitin 2020, kjo strukturë organizative përbëhet nga 3 punonjës: 1 (një) Drejtor dhe 2 (dy) Specialist. Drejtori z. M M dhe specialistja znj. K H janë të çertifikuar, ndërkohë specialistja znj. S P është në proçes çertifikimi, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikñ, Nenit 11, Punësimi i audituesit të brendshëm, pika 2ç.

- Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm

- **Bazuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, planifikimi i nevojave të stafit për trajnim për vitin 2019 është planifikuar dhe identifikuar për 2 punonjës të NJAB**, janë përcaktuar temat e interesuara dhe mundësitë e tyre për ndjekje. Por në atë çfarë na është paraqitur në Raportin e veprimtarisë së NJAB, Bashkia Sarandë për vitin 2020, datë 04.02.2020 specialistja K H dhe S P nuk kanë kryer trajnime, në

kundërshtim me **Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" , Neni 20.**

- **Bazuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, planifikimi i nevojave të stafit për trajnim për vitin 2020 është planifikuar dhe identifikuar për 3 punonjës të NJAB**, janë përcaktuar temat e interesuara dhe mundësitë e tyre për ndjekje. Por në atë çfarë na është paraqitur në Raportin e veprimtarisë së NJAB, Bashkia Sarandë për vitin 2020, datë 03.02.2021 specialistja S P nuk ka kryer trajnime, në kundërshtim me **Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" , Neni 20.**

- Struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit paraqitet si më poshtë:

Nr.	AUDITUESI	Arsimimi/ Niveli i Diplomës	Vjetërsi pune	Vitet e punës në Auditin e Brendshëm	Trajnime		Çertifikatë audituesi
					2019	2020	
1	M M (Drejtor)	Fak Eko. Agra. Fin. (Master Shkencor)	42	8	Po	Po	Po, 2012
2	K H (Specialist)	Fak Eko. Statistikë (Master Shkencor)	31	3	Po	Po	Po, 2018
3	S P (Specialist)	Në Aplikime të Informatikës dhe në Ekonomi (4- Vjeçar Bachelor)	5	2	Jo	Jo	Pa çertifikuar (Në proçes)

Në shkresën e datës 06.05.2021, nr. 2105 Prot., Bashkia Sarandë ka nisur observacionet mbi akt-konstatimet e mbajtura ku thuhet se:
"Në akt-konstatim thoni së specialistja K H për vitin 2019, nuk ka kryer trajnime. Në dosjen personale që ndodhet në Drejtorinë e Personelit ndodhet i arshivuar vërtetimi me nr.20351 prot, datë 08.11.2019, firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm znj. K H , ku vërteton së specialistja K.H ka kryer Trajnimin e Vijueshëm Profesional të AB, në respektim të ligjit 114/2015 "Për auditim e brendshëm në sektorin publik", neni 20. Gjithashtu për specialisten S P nuk ka kryer trajnime. Kjo specialiste, në bazë të dokumentacionit të duhur që kërkon procesi i çertifikimit për auditues të brendshëm, sipas kërkesave të Urdhërit nr.65, datë 06.03.2020, të Ministrit të Financave, është rregjistruar dhe ka filluar procesin e çertifikimit me datë 03.12.2020 dhe nuk kryen trajnime deri sa të çertifikohet. Është planifikuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të AB për trajnim për vitin 2021".

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pasi shqyrtimit të obseravcioneve të paraqitura konstatohet se, pranohet observimi i bërë nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në lidhje me trajnimin e specialistes K H për vitin 2019. Përsa i takon specialistes S P në Ligjin Nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikò, Neni 20- Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm specifikohet në pikën 3 se: Audituesit të brendshëm në detyrë i njihet si trajnim i vijueshëm profesional pjesëmarrja në trajnime për auditimin e brendshëm, të organizuara nga institucione kombëtare ose ndërkombëtare, si dhe publikime në fusha që lidhen me auditimin e brendshëm, të cilat raportohen dhe njihen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e nxjerrë sipas pikës 1 të këtij neni. Për sa më sipër observimi merret pjesërisht në konsideratë.

Specialistja S P , me Urdhër Nr. 23, Datë 15.03.2019, është emëruar me kontratë 3-mujore Specialiste Auditi, pranë Bashkisë Sarandë dhe në aktin nr. 23/1, të datës 21.06.2019 është emëruar si ñSpecialist i Auditit të Brendshëmò. ***Specialistja znj. S P , është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Nenit 11, Punësimi i audituesit të brendshëm, pika 2a, specialistja duhet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë.*** Dhe siç paraqitur në tabelën më lart në zbatim të Ligjit Nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikñ, Nenit 11, Punësimi i audituesit të brendshëm, pika 2ç, specialistja është në proçes çertifikimi brenda afatit ligjor.

- Mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm

-Planet Strategjike dhe Vjetore:
Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik jane hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Për vitin 2019, në shkresën nr. 2618, datë 08.10.2018 është miratuar plani strategjik për vitet 2019 ï 2021, dhe plani vjetor i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2019. Plani Strategjik për periudhën 2019- 2021 dhe plani vjetor 2019 është firmosur nga drejtori dhe specialisti i Njësisë së Auditit të Brendshëm, miratuar nga kryetari në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm.Raporti i veprimtarisë së NJAB, Bashkia Sarandë, për vitin 2019, nr. 4018/1, dt. 04.02.2020, është firmosur nga M M .

Për vitin 2020, në shkresën nr.17175/1, datë 18.10.2019 është miratuar plani strategjik për vitet 2020 ï 2022 dhe plani vjetor i veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2020. Plani Strategjik për periudhën 2019- 2021 dhe plani vjetor 2019 është firmosur vetëm nga drejtori i Njësisë së Auditit të Brendshëm, duke specifikuar se specialisti i NJAB është i çertifikuar, miratuar nga kryetari në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm. Raporti i veprimtarisë së NJAB, Bashkia Sarandë, për vitin 2020, nr. 561, dt. 03.02.2021, është firmosur nga M M .

Këto plane janë miratuar nga titullari i institucionit dhe dërguar brenda afateve të Manualit të Auditit të brendshëm, zyrtarisht (por edhe me postë elektronike) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, si dhe Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò, por pa dhënë mendimin Komiteti i Auditimit, i cili nuk është ngritur.

-Komiteti i Auditit të Brendshëm:
Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13 ñKomitetit të Auditimit të Brendshëmò i cili përcakton se *:"Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*
a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
d) duke monitoruar zbatimin e rekoman-dimeve të dhëna;

dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

-Konstatohet mungesa e dokumentimit dhe protokollimit të raportimeve periodike bordit (KAB) mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatet e aktivitetit të Auditit Brendshëm e cila përcaktohet në Standartet 2060 të auditimit.

Në lidhje sa më sipër në shkresën e datës 06.05.2021, nr. 2105 Prot., Bashkia Sarandë ka nisur observacionet mbi akt- konstatimet e mbajtura ku thuhet se:
"Dokumentacioni që ju kemi venë në dispozicion si raportet periodike dhe planet strategjike e vjetore, janë protokolluar dhe miratuar nga Menaxheri i lartë (Kryetari i Bashkisë)"

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi shqyrtoi observacionet konstaton se, pranon spjegimet e dhëna nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në lidhje me menaxhimin e lartë (Kryetari i Bashkisë) por thekson se, mungon raportimi në bordit. Sa më sipër observacioni i paraqitur merret pjesërisht në konsideratë.

-Kodi i Etikës
Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò Njësia e Auditit të Brendshëm ka hartuar ñKodin e Etikësò në Bashkinë Sarandë e cila eshte miratuar nga titullari në Urdhërin nr. 28, datë 05.04.2019.

-Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik
Referuar Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò ka hartuar ñKartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò në Bashkinë Sarandë e cila eshte miratuar nga titullari me Urdhërin nr. 28, datë 05.04.2019.

- Numri i subjekteve që i nënshtrohen auditimit. Kapaciteti auditues i njësisë së auditimit të brendshëm të institucionit, në raport me detyrimet për auditim.

- **Realizimi i Planeve Vjetore:**

Për vitin 2019 janë parashikuar gjithsej 8 (tetë) auditime. Realizimi i auditimeve për vitin 2019 është në masën 75 %, duke qënë se nga 8 auditime të planifikuara janë realizuar 6 auditime. Dëmi ekonomik i konstatuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm llogaritet në vlerën 1,546,000 për vitin 2019.
Për vitin 2020 janë parashikuar gjithsej 8 (tetë) auditime me një realizim të planit vjetor në masën 100%. Dëmi ekonomik i konstatuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm llogaritet në vlerën 2,637,000 për vitin 2020.

-Praktikat e përzgjedhura
Për vitin 2019, 3 dosje auditimi: Qëndra e Kulturës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Personelit.
Për vitin 2020, 3 dosje auditimi: Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike dhe Zyra Ekonomike e Arsimit.

Llojet e auditimeve:

Për vitin 2019, në Planin Strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, datë 08.10.2018, mbi Planin e Angazhimeve të NJAB për vitin 2019 është përcaktuar lloji i auditimit për subjektet e synuara për tu audituar.

Plani mbi llojin e auditimit të institucionit Qendra e Kulturës nga Auditim i Kombinuar është kryer Auditim Përputhshmërie, auditimi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nga planifikimi për Auditim Performance është realizuar Auditim Përputhshmërie.

Për vitin 2020, në Planin Strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm, datë 18.10.2019, mbi Planin e Angazhimeve të NJAB për vitin 2020 është përcaktuar lloji i auditimit për subjektet e synuara për tu audituar. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur lloji i auditimit të përcaktuar tek plani i NJAB dhe tek programi i angazhimit të auditimit (pjesë e dosjes se auditimit)

Plani mbi llojin e auditimit nga planifikimi në realizim nuk ka pësuar ndryshim.

- Vlerësimi i proçedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.

Nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra hapat e një misioni angazhimi që nga proçesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Pasqyra e praktikave të zgjedhura të realizuara në vitet 2019- 2020

Subjekti i audituar	Periudha e audituar	Afati i auditimit	Grupi i auditimit	Shënime
Drejtoria e Burimeve Njerëzore	01.01.2017-31.12.2018	21.05.2019-21.06.2019	M K S	Përfunduar
Qendra e Kulturës	01.01.2017-31.12.2018	15.08.2019-30.09.2019	M K S	Përfunduar
Drejtoria Juridike	01.01.2018-31.10.2019	05.12.2019-31.12.2019	M K S	Përfunduar
Drejtoria e Shërbimeve	01.01.2018-31.12.2019	13.05.2020-10.06.2020	M K S	Përfunduar
Drejtoria Ekonomike	01.07.2019-30.06.2020	08.07.2020-10.08.2020	M K S	Përfunduar
ZyraEkonomike e Arsimit	01.09.2018-31.12.2019	13.10.2020-30.11.2020	M K S	Përfunduar

Observacion i paraqitur nga Drejtori i Auditimit të Brendshëm, datë 09.08.2021 mbi Projektraportin e Auditimit, përcjell me shkresën nr. 3628/2 prot, datë 19.08.2021 regjistruar në KLSH me nr. 101/6 prot., datë 23.08.2021.

Pretendimi i subjektit:
-Te masat organizative, gjetje 4 ju thoni se për vitin 2019 dhe 2020, nga njësia e AB nuk është realizuar asnjë mision auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna. Ku sqarojmë se..... Njësia e AB në Bashkinë Sarandë me Program Angazhimi nr. 891 datë 04.03.2021, ka audituar zbatimin e rekomandimeve të lëna në të gjitha subjektet e audituara për vitin 2020. Me shkresën nr. 1484 prot, datë 08.04.2021 është dërguar Raporti Vjetor i Nivelit të Zbatimit të Rekomandimeve të Auditit të Brendshëm, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë...
-Sqarojmë se inventari i dosjes është plotësuar sipas dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe se njoftimi dhe takimi fillestar ndodh në një datë sepse brenda institucionit të Bashkisë ku jemi ska pse të vemi dy herë....
-Sqarojmë se, Drejtori i Auditit përpara se të jetë drejtor është auditues dhe në një njësi me tre veta krahas punës së drejtorit punoj dhe si auditues, sipas ndarjes së detyrave dhe programit të angazhimit.
-Sqarojmë se, kundrejt dokumentacionit të plotësuar kjo specialiste është regjistruar dhe ka filluar procesin e çertifikimit dhe është në pritje të marrjes së çertifikatës...

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
-Gjetjet i referohen aktivitetit të NJAB për periudhën deri më datë 31.12.2020. Vlen të theksojmë se vlerësohet angazhimi marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2020 nga kjo strukturë.
-Inventari i sugjeruar në dosjet e auditimit, nuk është kryer pasi në shumicën e rasteve dokumentit i mungojnë të dhënat në lidhje me atë çfarë gjendet në dosje. Sa i përket afateve të njoftimit afati 10 ditë pune është një detyrim i përcaktuar në Manualine DAB dhe është i detyrueshëm për zbatim me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara.
-Përfshirja e drejtuesit të njësisë në procesin auditues ndërkohë që ka kryer planifikimin e subjektit, caktimin e grupit, ndarjen e detyrave, kryerjen e auditimit dhe miratimin e tij janë disa procese të cilat në mënyrë të pashmangshme, drejtpërdrejt apo në dukje e cënojnë cilësinë audituese.
-Lidhur me punonjësen e NJAB, S P sqarojmë se, konstatimi ynë ka të bëj me mosplotësimin e kushteve të posaçme për të qenë auditues i brendshëm në sektorin publik referuar nenit 11 pika 2/a të ligjit nr.114/2015.
Sa më sipër observacioni merret pjesërisht në konsideratë.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Mungesë dokumentacioni, gjurmimi në dosjet e audituara si dhe cënim i cilësisë së auditimeve
Situata:	Nga Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkia Sarandë, nuk është bërë i mundur realizimi i kontrolleve për verifikimin e detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pavarësisht se një nga drejtimet e auditimit në angazhimet e kryera është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga kjo NJAB për vitet 2019 dhe 2020 nuk është realizuar një mision auditimi apo evidentim nga një punonjës i zbatimit rekomandimeve për subjektet e audituara, duke bërë që si NJAB ashtu dhe titullari i njësisë të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera. Njoftimi i njësisë publike ndodh në të njëjtën ditë me takimin fillestar (prezantues). Inventari i sugjeruar në dosjet koherente të auditimit, nuk është kryer si duhet duke qënë se në të shumtat e rasteve mungojnë të dhënat në lidhje me atë çfarë gjendet në dosje. Në dosjet e përzgjedhura ka mungesa të dokumentave si: Plan Veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve te lena dhe në dosjet e vitit 2019 mungon

	Vetëvlerësimi periodik nga njësia e auditimit të brendshëm, observacionet e subjekteve janë pa datë. Nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim). Nuk dokumentohet që Drejtoria e Auditit të Brendshëm që pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar, për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara. Drejtori i Auditit, pranë Bashkisë Sarandë edhe pse është emëruar në pozicionin drejtor, është njëkohësisht edhe auditues duke qënë se është pjesë e programeve të angazhimeve të auditimit.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò.
Ndikimi/Efekti:	Mos thellimi në problematikat e trajtuara sipas fushave në auditimet e kryera, inventari jo i plotë në dosjet e subjekteve të audituara si dhe kryerja e punës në kushtet e konfliktit të interesit, çojnë njësinë e auditimit të brendshëm në kushtet e konfliktit të interesit dhe në cënim të cilësisë së auditimeve.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.
Rëndësia:	E Lartë

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Mungesë dokumentacioni e specialistet së auditit.
Situata:	Specialistja S P , me Urdhër Nr. 23, Datë 15.03.2019, është emëruar me kontratë 3- mujore Specialiste Auditi, pranë Bashkisë Sarandë dhe në aktin nr. 23/1, të datës 21.06.2019 është emëruar si ñSpecialist i Auditit të Brendshëmò. Emërimi i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikñ, Nenit 11, Punësimi i audituesit të brendshëm, pika 2a, specialistja duhet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë të cilën kjo punonjëse nuk e disponon.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, të Manualit të Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò
Ndikimi/Efekti:	Emërim jo në përputhje me dispozitat ligjore i cili cënon veprimtarinë e kësaj strukture.
Shkaku:	Veprime jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
Rëndësia:	E mesme

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimin nr. 11 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1667/4 prot, datë 16.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, A G a dhe M M)

- **Drejtimi 3:** ***Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.***

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit: Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008ò nga grupi i auditimit u analizuan:

Programi buxhetor afatmesëm
Programimi i PBA-së 2020- 2022
Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, Raporti i Vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhuraveò në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 34
Urdhëri ñPër ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit buxhetor të vitit 2020ò bazuar në programin buxhetor afatmesëm 2020- 2022 miratuar me VKB për vitin 2019, nr. Prot. 35/1, datë 11.09.2019 është miratuar, firmosur dhe vulosur nga kryetari brenda afateve.
Miratimi i kalendarit te programit buxhetor afatmesëm 2020- 2022 dhe menaxhimi i shpenzimeve vendore 2019, Vendim nr. 80, 29.12.2018, është kryer brenda datës 31 Dhjetor 2018, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33. (13.02.2019 hedhur ne vendime.al)
Nuk janë miratuar në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (Të vitit paraardhës) në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.

Programimi i PBA-së 2021- 2023
Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, Raporti i Vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhuraveò në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 34, e cila në Udhëzimin nr. 10, të datës 28.02.2020 ñPër përgatitjen e programit buxhetor Afatmesëm Vendor 2021- 2023ò duhet të miratohet jo më vonë se data 1 mars 2020.
VKB nr.25 date 24.04.2020 "Per miratimin e Buxhetit Afatmesem 2021-2023"
Urdhëri nr. 101, datë 04.08.2020, ñPër ngritjen e punës së hartimit të programit buxhetor të vitit 2021ò, bazuar në programin buxhetor afatmesëm 2021- 2023 miratuar me VKB për vitin 2020, është miratuar, firmosur dhe vulosur nga kryetari brenda afateve (puna për përgatitjen e programit buxhetor 2021 duhet të përfundojë brenda datës 30 Nëntor 2020)
Miratimi i kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe menaxhimi i shpenzimeve vendore 2020, Vendim nr. 44 datë 23.12.2019, nga Këshilli i Bashkisë Sarandë është kryer brenda datës 31 Dhjetor 2019, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33.
Vendimi nr. 97 date 30.09.2020 ñPër miratimin e t'ardhurave dhe te tavaneve te shpenzimeve ne nivel programi, te buxhetit afatmesem 2021-2023ò, nuk janë miratuar brenda afatit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Plan/ Fakt, viti 2019- Buxheti i Bashkisë Sarandë për vitin 2019 është miratuar nga Këshilli Bashkiak i Sarandës me Vendim nr. 79, datë 29.12.2018. Buxheti për vitin 2019 është miratuar disa ditë me vonesë. *Eshtë publikuar në Vendime.al por jo brenda afateve.* Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti.

Plan/ Fakt, viti 2020- Buxheti i Bashkise Sarandë per vitin 2020 është miratuar nga Këshilli Bashkiak, me vendim nr. 43, 23.12.2019, i konfirmuar me nr. Prot. 74/1, datë 23.01.2019 në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 51. *Buxheti nuk është publikuar brenda 15 ditëve nga miratimi në vendime.al.* Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti.

Për vitin 2021, Buxheti i Bashkise Sarandë nga Këshilli Bashkiak, vendim nr. 204, 24.12.2020, i konfirmuar me nr. Prot. 2/1, datë 16.01.2020 në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 51. Buxheti nuk është publikuar brenda 15 ditëve nga miratimi në vendime.al. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti.

- Monitorimi i buxhetit

Në zbatim të Urdhërit nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendoreò, Bashkia Sarandë ka nisur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë raportet e monitorimit për vitet 2019 dhe 2020, çdo 4 muaj.

<u>Për vitin 2019</u>

Raporti i Monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor për katër mujorin e parë 2019, datë 10.06.2019, me nr. prot. 1465.

Raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor per tetëmujorin 2019, datë 27.09.2019, nr. prot. 2532.

Raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor për vitin 2019. datë 12.06.2020, me nr. Prot. 2201.

<u>Për vitin 2020</u>

Raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor për 4 mujorin 2020, datë 02.06.2020, nr. prot. 1963.

Raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor për 8 mujorin 2020, datë 23.09.2020, nr. Prot. 3908.

Raporti i monitorimit per zbatimin e buxhetit vendor per 12 mujorin 2020, datë 12.02.2021, nr. Prot. 686.

Në raportet e monitorimit për vitet 2019 dhe 2020 Ekipi i Menaxhimit të Programit nuk ka firmosur, në kundërshtim me Urdhërin nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendoreò. *Raportet e monitorimit për katër mujorin e parë 2019 dhe 2020 janë jashtë afatit të vendosur në pikën 48, të Urdhërit nr. 22, datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raporti i monitorimit për zbatimin e buxhetit vendor për vitin 2019 është dorëzuar disa muaj me vonesë në kundërshtim me pikën 48, të Urdhërit nr. 22, datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Nënpunësi autorizues nuk i ka publikuar raportet e monitorimit në faqen zyrtare të njësisë vendore në kundërshtim me Urdhërin nr. 22, datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore".*

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.
Situata:	Në lidhje me procedurën e diskutimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve: nuk ka asnjë proçes verbal, e cila të dokumentojë mbledhjen e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme. Publikimi i dokumentave në faqen zyrtare të bashkisë Sarandë apo në vendime.al ka mungesa dhe vonesa në afatet e publikimit. Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. **Për vitin 2019**, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (ng granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 79% ose ng 1,242,506 mijë lekë të planifikuara në 986,868 mijë lekë të realizuara. Përsa i përk programit Menaxhim, Administrim, Planifikim (aparatit të bashkisë) rezulton s është realizuar në masën 82 % ose nga 573,529 mijë lekë të planifikuara në 468,83 mijë lekë të realizuara. **Për vitin 2020**, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 68% ose nga 1,294,726 mijë lekë të planifikuara në 883,078 mijë lekë të realizuara. Përsa i përket programit Menaxhim, Administrim, Planifikim (aparatit të bashkisë) rezulton se është realizuar në masën 70 % ose nga 285,127 mijë lekë të planifikuara në 199,319 mijë lekë të realizuara.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27 dhe 32, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016; - Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; - Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; - Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, neni 9 pika 1.3 germa ñcò dhe ñçò; - Ligji nr. 48/2014 datë 24.04.2014, ñPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregëtareò, i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015; - Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò; - UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëmò - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendoreò, - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014
Ndikimi/Efekti:	Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur të njësisë vendore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, më së shumti për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.
Shkaku:	Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkuzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Pagesa për largime të padrejta nga puna.
Situata:	Në vitin 2019 rezulton të jenë paguar **4,391,882 lekë** për vendimet gjyqësore dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna. Pjesa më e madhe e këtyre vendimeve gjyqësore i përkasin viteve të mëparshme dhe vlera prej 1,331,350 lekë i përket vitit 2019. Pagesa e dëmshpërblimeve paraqitet në vlerën prej 2,964,509 lekë dhe pjesa tjetër paraqet pagesën e tarifës përmbarimore prej 1,427,373 lekë, të cilat kanë rënduar buxhetin e njësisë vendore. Në vitin 2020 vlera e dëmshpërblimeve të paguara për largim nga puna është **950,000 lekë** dhe pa pagesë e tarifës përmbarimore, ndërsa për periudhën janar-mars 2021 është **381,350 lekë**.
Kriteri:	Pika nr.62, e udhëzimin nr. 2, datë 06.02. 2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò.
Ndikimi/Efekti:	Efekte negative në buxhet si rezultat i zbatimeve të vendimeve gjyqësore për largime nga puna të cilat në total kapin vlerën prej **5,723,232 lekë.**
Shkaku:	Largime të padrejta nga puna të punonjësve.
Rëndësia:	E Lartë

Titulli i Gjetjes nr. 3:	Risqet buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara
Situata:	Vlerat nga viti 2019 në 2020 vlen të thekësohet se janë vlera progresive. Detyrimet e prapambetura në vitin 2019 dhe 2020 janë vlera të mbartura edhe nga vitet e mëparshme të cilat vijojnë të jenë të palikujduara. Në vitin 2020, vlerat më të larta të palikujduara rezultojnë OSHEE 27,943,041 (të mbartura ndër vite) dhe K Shpk Korçë për pastrim e qytetit 17ô678ô509 lekë (fatura të vitit 2020). Për OSHEE, energjinë elektrike nuk është bërë asnjë planifikim për shlyerjen duke çuar në rritjen e kësaj vlere nga vitit në vit. Nga administrata e bashkisë Sarandë nuk është paraqitur në të gjitha rastet në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Një pjesë e kontratave janë regjistruar me vonesë në thesar.

Detyrime të prapambetura		
Emërtimi/Viti	**2019**	**2020**
Mallra dhe shërbime	34,667,074	47,809,153
Vendime gjyqësore të ndryshme	11,027,581	8,455,483
Investime	21,969,209	936,000
Totali	**67,663,864**	**57,200,636**

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Sarandë

Kriteri:	- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme.
Shkaku:	Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
Rëndësia:	E lartë

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimin nr. 12 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1667/5 prot, datë 16.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, A G dhe T S)

Drejtimi 4: ***Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.***
4.1 Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator, ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre;
4.2 Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor

1. **Probleme në procedurat e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, në llogaritjen e gjobave për mos pagim në afat të detyrimit tatimor, në krijimin e regjistrave të subjekteve, dhe në kontabilizimin e të gjitha detyrimeve te paarkëtuara**

Nga auditimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat, rezulton se për vitin 2019 dhe 2020 për disa nga llojet e taksave dhe tarifave ka tejkalim të të ardhuarave të planifikuara, ndërsa për disa lloje të tjera ka realizim shumë të ulët. Mos realizimi i të ardhurave sipas planifikimit, përveç rastit kur parashikimi nuk është bërë siç duhet, vjen edhe nga fakti i mos pagesës së taksave dhe tarifave nga bizneset dhe familjarët, duke shkaktuar debi. Për vitin 2019 numri i bizneseve debitore është 1,996 dhe vlera e debisë është 240,293,817 lekë, ndërsa për vitin 2020 numri i bizneseve debitore është 2,313 dhe vlera e debisë është 286,286,480 lekë. Debitorët e tatim taksave janë rritur gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019.

Tabela 1. Gjendja e Debitorëve në fund të vitit për Bashkinë Sarandë

Debitorët	Progresive deri më 31.12.2018	Datë 31.12.2019		Datë 31.12.2020	
	Vlera	Numri	Vlera	Numri	Vlera
Familjarë	39,151,609	36,982	94,541,346	64,446	89,808,218
Biznese	199,849,996	1,996	240,293,817	2,313	286,286,480
TOTALI	**239,001,605**	**207,931**	**334,835,163**	**206,999**	**376,094,698**

Burimi: Bashkia Sarandë

Vlera e Debitorëve nga bizneset më datë 31.12.2020 paraqitet rreth 286,286,480 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Problematika megjithëse është evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH në Bashkinë Sarandë rezulton se nga ana e institucionit nuk rezulton të jenë marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës. Nga vlera totale më sipër, vlera e detyrimeve shtesë për periudhën **vitet 2019** dhe **2020** llogaritet në rreth **86,436,484 lekë.**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë, **për periudhën nën auditim nuk ka llogaritur në asnjë rast gjoba për mospagimin në afat të taksave dhe tarifave nga subjektet**, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar dhe në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018 ó*Për miratimin e paketës fiskale 2019'*. Kjo Drejtori nuk disponon një databazë analitike të debitorëve, në mënyrë që të llogarisë saktësisht vlerën e kamatëvonesave dhe gjobave për secilin debitor, dhe më pas të ndërmarrë hapat e mëtejshëm veprues për arkëtimin e tyre.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk disponon një regjistër analitik të subjekteve debitore, në të cilin të pasqyrohen vertikalisht të dhënat e subjektit si emër, NIPT, aktivitet dhe horizontalisht vlera e debisë së secilit subjekt për secilën nga taksat dhe tarifat. Ky format do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Gjithashtu, edhe regjistri i tatimpaguesve nuk paraqet informacion të plotë, pasi nuk paraqet debinë e mëparshme të secilit tatimpagues, por

vetëm debinë e vitit ushtrimor. Të dhënat e mbajtuara në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, lidhur me mospagimin në afat të detyrimit tatimor, tatimpaguesit duhet të paguajnë gjobë, sikurse përcaktohet në nenin 114 të këtij ligji ó*Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike'.* Vlera e penaliteteve të pazbatuara nga institucioni llogaritet në rreth **62,696,739 lekë** nga të cilat penalitett e pazbatuara për vitet 2019 dhe 2020 llogariten rreth **18,929,590 lekë**, e cila përbëhet nga gjobat për pagesë të vonuar e llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit, por jo më tepër se 365 ditë, për taksat dhe tarifat vendore të papaguara e cila **përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Për llogaritjen e gjobave për pagesë të vonuar është marrë vlera e debisë së vitit 2020, duke qenë se vlera e debisë është progresive dhe e mbartur nga vitit në vit. Është përdorur kjo metodë pasi Bashkia Sarandë nuk disponon një databazë të plotë me të gjithë debitorët për të gjitha vitet.

Tabela 2. Vlera e debisë shtesë për nga kamatëvonesat e pallogaritura në Bashkinë Sarandë

Gjoba për pagesë të vonuar për totalin e detyrimit	**(0,06x365)**
Detyrimi Tatimor	286,286,480
Vlera totale	**62,696,739**

Burimi: Bashkia Sarandë

Gjoba për pagesë të vonuar vitet 2019-2020	**(0,06x365)**
Detyrimi Tatimor	86,436,484
Vlera totale	**18,929,590**

Burimi: Bashkia Sarandë

Shënim: Vlera e gjobave për pagesë të vonuar të taksave dhe tarifave nuk është e plotë dhe ka qëllime referuese, pasi një pjesë e debitorëve të vitit 2020 mund tô paguajë detyrimet më përpara se plotësimi i vitit dhe rrjedhimisht, për këto raste gjobat duhet të llogariten deri në momentin e pagesës. Gjithashtu, edhe për debitorët që e kanë të mbartur vlerën e debisë nga vitet e mëparshme, gjoba duhet të llogaritet vetëm për 1 vit.

Në paketën fiskale të vitit 2019 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018, në pikën B.8, përcaktohet se ó*Për moslikuidimin në afatin e përcaktuar të detyrimit për taksat e tarifat, subjektet që ushtrojnë biznes, paguajnë kamatëvonesa, në shumën 0,05 % të detyrimit për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 25% të detyrimit të vitit ushtrimor. Afati i fundit për pagesën e detyrimeve të vitit ushtrimor, për efekt të llogaritjes së kamatëvonesave, është data 31 Dhjetor. Pas kësaj datë, fillon llogaritja e kamatëvonesave për ditë kalendarike*ô. Ky përcaktim i paketës fiskale lidhur me moslikuidimin në afat të taksave dhe tarifave, bie në kundërshtim me përcaktimin e nenit 114 ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet vlera e gjobës për pagesat e vonuara 0,06%. Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë të përcaktojë vlera të ndryshme nga ato që janë përcaktuar

në ligj. Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ó*Për sistemin e taksave vendore'* i ndryshuar, në nenin 5 pika ç të tij lidhur me taksat dhe administrimin e tyre, përcaktohet se ó*Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë ose i komunës përcakton:i) detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave; ii) mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta; iii) rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake e të komunës, në mbështetje të administrimit të taksave vendore; iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore; v kriteret dhe procedurat e mardhenieve me taksapaguesit, perfshire te drejten e tyre te ankimimit; vi) mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative*. Në nenin 35 pika 2 e këtij ligji lidhur me tarifat dhe administrimin e tyre *përcaktohet se ó Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent'.* Sipas këtij përcaktimi ligjor, Këshilli Bashkiak vendos mbi tarifat dhe mbledhjen e tyre vetëm në ato raste kur nuk ka përcaktime në këtë ligj apo në ligje të tjera. Për sa më sipër, në ktë ligj, në nenin 34 lidhur me kundërvajtjet administrative dhe sanksionet përcaktohet se ó*Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ô. Në rastin gjobës për pagesë të vonuar, e cila është e përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò si rrjedhojë Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë për ta ndryshuar.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve debitore dhe nuk ka zbatuar asnjë masë shtrënguese. Deri më tani nuk është dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò.

2. **Bashkëpunim jo efektiv me agjentët tatimorë që vjelin të ardhura për Bashkinë Sarandë**

Mbledhjen e disa taksave, Bashkia Sarandë e kryen nëpërmjet agjentëve tatimore, sikurse janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Sarandë

(në mijë lek)

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2019	2020
Drejtoria rajonale e tatimeve	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	12,614	11,212
D.R.SH.T rrugor	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	22,547	23,584
Z.V.R.P.P (AKSH)	Taksa e kalimit të pronësisë	7,845	5,466
DPT & DPD	Renta Minerare		
Ujësjellës-Kanalizime	Taksë ndërtese	31,707	32,766
	Tarifë shërbimi	53,720	54,690
TOTALI		**128,433**	**127,718**

Burimi: Bashkia Sarandë

Agjenti i cili bën mbledhjen e pjesës më të konsiderueshme të taksave, është UKT, marrëdhëniet me të cilin rregullohen nëpërmjet akt-marrëveshjeve. Pavarësisht kësaj, bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe UKT nuk është efektiv, pasi nuk bëhen rakordime mujore mbi numrin e

faturave të lëshuara, numrin e faturave të arkëtuara dhe debitorët, sikurse përcaktohet në akt-marrëveshjet nr.390 prot, datë 12.02.2019 dhe nr.678 prot, datë 21.02.2020. Bashkia Sarandë informohet vetëm mbi pagesat, të cilat i merr vazhdimisht në mënyrë manuale nga bankat. Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk ka kërkuar nga UKT të dhëna periodike të detajuara, por merr nga bankat vetëm vlerën e arkëtimeve, gjë e cila ka shkaktuar gabime në mbajtjen e të dhënave dhe në pasqyrimin e saktë të situatës lidhur me arkëtimet dhe debitorë e taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit. Vetëm pasi grupi i auditimit kërkoi sqarim për të dhënat e debitorëve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit, Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë kërkoi nga UKT të dhëna të detajura, nga e cila rezultoi se të dhënat e mëparshme janë raportuar gabim.

Tabela 4. Debitorët familjarë për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit

Emërtimi	Debitorë familjarë për taksën e ndërtesës				Debitorë familjarë për tarifën e shërbimit			
	2015- 2018	2019	2020	Total	2015- 2018	2019	2020	Total
Sarandë	16,620,745	6,814,986	11,144,314	**34,580,045**	18,815,182	9,104,846	16,716,387	**44,636,415**
Ksamil	1,964,343	1,063,174	1,776,718	**4,804,235**	1,751,339	1,388,805	2,645,380	**5,785,524**
Totali	**18,585,088**	**7,878,160**	**12,921,032**	**39,384,280**	**20,566,521**	**10,493,651**	**19,361,767**	**50,421,939**

Burimi: Bashkia Sarandë

Vlera e debisë progresive nga familjarët për taksën e ndërtesës deri në vitin 2020 është 39,384,280 lekë ndërsa për tarifën e shërbimit deri në vitin 2020 është 50,421,939 lekë, në total **89,806,219 lekë** të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë të cilat nuk janë mbledhur nga agjenti tatimor UKT. Kjo vlerë është e pakontabilizuar. Problematika megjithëse është evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH në Bashkinë Sarandë. Për vitet 2019 dhe 2020 objekt auditimi kjo vlerë është rritur në shumën rreth **50,654,610 lekë.**

Gjithashtu, konstatohet se për këta debitorë nuk është aplikuar gjobë për pagesë të vonuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, ku në nenin 114 të këtij ligji përcaktohet se ó*Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike'.* **Vlera prej rreth 19,667,562 lekë** (89,806,219 lekë x 0.06% x 365=19,667,562 lekë) e pallogaritur dhe e paarkëtuar për pagesë të vonuar, **përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë nga e cila rreth 11,093,360 lekë** përfaqëson penalitetet për detyrimet shtesë të **viteve 2019** dhe **2020.**

Shënim: Vlera e gjobave pagesë të vonuar të taksave dhe tarifave nuk është e plotë dhe ka qëllime referuese, pasi një pjesë e debitorëve të vitit 2020 mund tô paguajë detyrimet më përpara se plotësimi i vitit dhe rrjedhimisht, për këto raste kamatëvonesat/gjobat duhet të llogariten deri në momentin e pagesës. Gjithashtu, edhe për debitorët që e kanë të mbartur vlerën e debisë nga vitet e mëparshme, kamatvonesa duhet të llogaritet vetëm për 1 vit.

Përveç agjentëve tatimor të jashtëm, Bashkia Sarandë aplikon mbledhjen e taksës mbi tokën bujqësore nëpërmjet agjentëve të brendshëm, të cilët i punëson me kontratë pune 3-mujore. Nga shqyrtimi i procedurës së mbledhjes së kësaj takse, rezulton se kjo mënyrë veprimi lë vend për

abuzime dhe gabime operacionale, pasi pagesa ju mblidhet zotëruesve të tokës bujqësore nëpërmjet mandat arkëtimeve të bëra dorazi, dhe më pas paratë derdhen në bankë nga agjenti tatimor.

Tabela 5: Debitorë të taksës mbi tokën bujqësore

NR	FSHATI	Periudha			Debi Totale
		2011-2018	2019	2020	
1	Çuke	3,705,269	1,015,560	1,576,222	6,297,051
2	Gjashte	6,715,286	1,420,761	1,645,179	9,781,226
3	Metoq	3,558,333	840,188	1,157,961	5,556,482
4	Shelegar	574,445	145,447	161,265	881,157
5	Specilaistet	330,462	84,990	116,640	532,092
Bashkia			**3,506,946**	**4,657,267**	**23,048,008**

Burimi: Bashkia Sarandë

Nga sa më sipër, rezulton se vlera e debisë nga taksa mbi tokën bujqësore është 23,048,008 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë**. Kjo vlerë është e pakontabilizuar nga të cilat detyrimi shtesë për vitet **2019** dhe **2020** paraqitet **8,164,213 lekë.**

3. Kontrata të plazheve të lidhura jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore

Nga Bashkia Sarandë administrohen mbi 60,000 m^2 plazhe, të cilat gjatë sezonit turistik jepen në përdorim të subjekteve të ndryshme. **Për vitin 2019**, nga auditimi u konstatua se janë lidhur 130 kontrata, për një sipërfaqe totale të shfrytëzueshme prej **29,685 m^2**. Sipërfaqja totale e plazhit të trajtuar në vitin 2019 është 61,791 m^2, nga e cila sipërfaqe për publikun 8,491 m^2 dhe ñBrez sigurieò 23,244 m^2. **Për vitin 2020**, nga auditimi u konstatua se janë lidhur 135 kontrata, për një sipërfaqe totale prej **67,108 m^2** e cila është konsideruar e gjitha sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe nuk janë bërë ndarje në sipërfaqe për publikun dhe brez sigurie.

Nga auditimi i kontratave të plazhit për vitin 2019 dhe 2020, në të gjitha rastet konstatohet se kontratat janë lidhur jashtë afatit të përcaktuar në nenin 4 pika 4 të VKM nr. 171, datë 27.3.2019 për miratimin e rregullores ñPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, ku përcaktohet se ó*Njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në datën 31 mars, të çdo viti, duhet të kenë lidhur të gjitha kontratat e qirasë për përdorimin e plazheve. Plazhet për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në këtë datë, do të funksionojnë si plazhe publike*ô. Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, në 21 kontrata plazhi hapësira e plazhit të dhënë në përdorim për stacion plazhi, është më e vogël se 200 m, në kundërshtim me kërkesat e pikës 7 të VKM nr.171, datë 27.3.2019, ku përcaktohet se ó*Përveçse kur zbatohen kritere të tjera, të përcaktuara në legjislacionin për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investuese në zonat me përparësi turizmin, hapësirat e plazhit të dhënë në përdorim për stacione plazhi, nuk mund të jenë më të vogla se 200 (dyqind) m2 dhe më të mëdha se 5000 (pesë mijë) m2'.*

Nga auditimi është konstatuar se paketa fiskale e vitit 2019 nuk është përditësuar me ndryshimet që kërkon VKM-ja nr. 171, datë 27.3.2019 ñ*Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò. Në kontratat e vitit 2019, sasia e ditëve për të cilat subjektet duhet të paguajnë qera është llogaritur 135 ditë, në kundërshtim kjo me VKM nr.171, datë 27.3.2019, ku në nenin 11 përcaktohet se ó*Stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data 1 maj deri më 30 shtator të çdo viti*

dhe gjatë kësaj periudhe duhet të ofrojë të gjitha shërbimet e të përmbushë të gjitha kushtet minimale të përcaktuara në bazë të tipologjisë së plazhit ku do të ushtrohet aktiviteti'. Sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je, subjektet duhet të paguanin 153 ditë qera plazhi dhe jo 135 ditë. Ky gabim në llogaritje, ka shkaktuar efekte financiare të cilat janë trajtuar në auditimin e mëparshëm të KLSH.

Tabela 6. Sipërfaqet e kontraktuara dhe vlerat e paguara

Viti	Sip. Totale	Brez Sigurie	20% H. Publike	Sip. e paguar	Ditët	Tarifa	Vlera e paguar
2020	67,108	0	0	67,108	Sezon	750 lekë/m² në sezon	54,300,305

Burimi: Bashkia Sarandë

Kontratat e vitit 2020, janë lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjekteve, me përfitues Bashkinë Sarandë, në zbatim të kërkesave të VKM nr.424, datë 27.5.2020 *Për një shtesë në vendimin nr.171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò. Nga një kampion i përzgjedhur rastësor për 10 kontrata, u konstatua se kontratat nuk përmbanin bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për plotësimin e aplikimit, sikurse përcaktohet në nenin 9 të VKM nr.424, datë 27.5.2020. Gjithashtu, databaza e kontratave të plazheve e mbajtur në format elektronik, ka pasaktësi në përcaktimin e sipërfaqeve për disa subjekte dhe gabime në llogaritje, duke mos dhënë informacion të plotë dhe të besueshëm.
Përveç sa më sipër, në një kontratë është konstatuar pasaktësi në llogaritjen e sipërfaqes. Në kontratën e lidhur me datë 16.07.2020 ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe E D person fizik, më përfitues Bashkinë Sarandë, është konfirmuar marrja në përdorim e hapësirës së plazhit prej 200 m2. Gjithashtu në anekset e kontratës është paraqitur harta e plazhit me të njëjtën sipërfaqe. Ndërkohë, në llogaritjen e vlerës që do të paguhet, të bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Sarandë, sipërfaqja e llogaritur është 144 m2. Gjithashtu edhe harta treguese e plazhit bashkëlidhur fletës së llogaritjes, edhe pse është e njëjtë me atë të anekseve të kontratës, në këtë rast ka të shënuar sipërfaqen 144 m2. Llogaritja e pagesës duhet të bëhej në bazë të kontratës, dhe si rrjedhojë e llogaritjes për tu paguar të një sipërfaqe prej 56m2 më pak sesa përcaktimi në kontratë, është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 42,000 lekë**.

4. Mos aplikim i tarifave për subjektet me veprimtari tregtare speciale dhe mos evidentimi i saktë i tyre

Në zbatim të VKM nr.970, datë 2.12.2015, Bashkia Sarandë arkëton të ardhura edhe nga tarifa e licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, të cilat operojnë brenda territorit nën administrim të saj.

Nga lista e mëposhtme që disponon Bashkia Sarandë mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure brenda territorit të saj, rezulton se janë 15 subjekte që e ushtrojnë këtë aktivitet dhe të gjithëve iu ka përfunduar licenca para vitit 2020. Në nenin 14 të VKM nr.970, datë 2.12.2015, përcaktohet se ó*Përsëritja e licencave bëhet nga organi që ka dhënë licencën, kundrejt një kërkese të personit juridik, e cila shqyrtohet njësoj si një kërkesë e re'.* Për sa më sipër, nga 15 subjekte, vetëm 1 subjekt, óO shpkô ka bërë rinovim të licencës, ndërkohë pjesa tjetër e subjekteve operojnë pa licencë.

Për sa më sipër, Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin e subjekteve

që operojnë pa licencë dhe për arkëtimin e tarifave, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15.1 të VKM në të cilën përcaktohet se ó*Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë'.* Gjithashtu, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh. Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për evidentimin e të gjitha subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti si dhe të subjekteve të reja që mund të jenë shtuar, si dhe ka treguar një neglizhencë totale në kontrollin e këtyre subjekteve lidhur me detyrimet tatimore. Kjo problematikë është evidentuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH por nga ana e institucionit nuk evdientohen veprime konkrete për përmirësimin e situates dhe arkëtimin e vlerave përkatëse të munguara në buxhet.

Tabela 7. Subjektet që tregtojnë hidrokarbure

Nr	Subjekti	Fillimi i Autorizimit	Përfundimi i Autorizimit	Vlera që duhet arkëtuar
1	E	01.12.2011	01.12.2016	1,000,000
2	2a	27.04.2014	26.04.2019	1,000,000
3	D	01.12.2011	30.11.2016	1,000,000
4	S	14.07.2015	13.07.2020	1,000,000
5	O	01.12.2011	30.11.2016	
6	T	14.07.2015	13.07.2020	1,000,000
7	K	14.06.2012	13.06.2017	1,000,000
8	V	11.02.2015	10.02.2020	1,000,000
9	I	28.07.2015	27.07.2020	1,000,000
10	T	09.08.2014	08.08.2019	1,000,000
11	A	24.08.2015	23.08.2020	1,000,000
12	Z	20.02.2015	19.02.2020	1,000,000
13	E			1,000,000
14	C	14.02.2015	13.02.2020	1,000,000
15	S	04.05.2010	03.05.2015	1,000,000
TOTALI				**14,000,000**

Burimi: Bashkia Sarandë

Në nenin 9 të VKM nr. 344, datë 19.4.2017 *Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò përcaktohet se ó*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.*ò Si rrjedhojë, **vlera prej 14,000,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që disponon Bashkia Sarandë. Megjithatë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të verifikojë nëse ka subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimi apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë.

Në lidhje me problematikat e konstatuara dhe paraqitura më lart, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr. 10 datë 16.04.2021, dhe Bashkia Sarandë ka observuar me shkresën nr.101/4 prot, datë 10.05.2021.
Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit: Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në observimin e paraqitur me shkresën nr.101/4 prot, datë 10.05.2021 pretendon:

1-Nuk shprehim dakortësi për tabelën Nr.2 e akt konstatimit ku llogarisni kamatvonesa për detyrime të papaguara për 365 ditë me 00.6% në ditë . Ligjit të cilit ju i referoheni ,thekson në mënyrë eksplicide, kjo mënyrë penaliteti përdoret për detyrim tatimor (nënkupton tatim fitimin dhe tvsh) dhe kontributi i sig shoqërore, dhe jo për tarifa shërbimi apo taksa vendore.
2-Ju vëmë në vëmendje edhe faktin se mbështetur në ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore i ndryshuar, neni 5,pika V dhe VI,është Këshilli Bashkiak që vendos për " kriteret dhe proçedurat e marrëdhënieve me taksapaguesit " dhe " për mënyrën e zbatimit të sanksioneve".
3-Për sa më sipër, fakti që Këshilli Bashkiak me vendim Nr 5,date 05.12.2017,kapitulli B-10 ka vendosur formën e penaliteteve për " pagesë të vonuar të detyrimit të vitit ushtrimor" është në përputhje me ligjin dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak.
4-Mos llogaritja e kamatvonesave për vitin 2020 ndodhën edhe për shkak të situates të krijuar nga COVID-19 , kur Këshilli Bashkiak mori disa vendime si: Për shtyrje të pagesës së detyrimeve për taksen dhe tarifat vendore si dhe lehtësitë e tjera në zbritjen e tyre.
Për arsyet e mësipëme kërkojmë që në projektraportin tuaj ky problem të mos përfshihet.
***5-** Ne lidhje me Akt-MareveshjenNr.390 Prot,date 12.02.2019dhe Akt-Marreveshjen Nr.678 Prot.dt.21.02.2020 ku shprehen te drejtat dhe detyrimet e paleve jane zbatuar te gjitha pikat e perfshira ne to. Kemi paraqitur me shkrim çdo muaj shoqerise se U.k.Sh.a detyrimiet mujore per taksen e baneses sipas metodollogjise se re te llogaritjes mbi ndertesat e banimit ,tarifen e sherbimeve publike,si dhe listat per kategorite e perjashtimeve.Eshte bere pagesa e 5 % te vleres se arketuar nga taksa e baneses dhe tarifave te sherbimit afatet e pageses dy here ne vit pasi kemi rene dakort me mareveshje. E kemi saktesuar perfundimisht vleren e debise nepermjet raporteve te nxjera nga programi ,kemi kerkuar te na vihen ne dispozicion te gjithe debitoret ne menyre analitike. Do te permiresojme punen ne vijim duke I kerkuar Ndermarjes se Ujesjelles Kanalizime sh.a,te na informoje çdo muaj per numrin e faturave familjare te leshuara,per nivelin e faturave te arketuara si dhe debitoret. Me perjashtim te kesaj pike te gjitha pikat e tjera te nenshkruara ne Akt Marreveshje jane zbatuar.*
Në lidhje me vërejtjet tuaja për mënyrën e mbajtjes së debitorëve dhe regjistrin e taksa paguesve sqarojme si më poshtë :
6-Debitorët mbahen ne formatin i cili na shërben më mire për ndjekjen dhe arkëtimin e tyre , të ndara sipas lagjeve dhe zonave që mbulojnë inspektorët e terrenit . Lista është e pasqyruar në programin T i cili mirëmban sistemin e kësaj drejtorie . Debitoret jane ne formatin - vertikalisht emer subjekti debitor , llojet e taksave dhe tarifave per të cilen eshte debitor , - horizontalisht përballë llojit të taksës dhe tarifes perkatese është vlera e secilës taksë ose tarifë dhe në fund është përsëri emër subjekti debitor dhe vlera totale e debisë . Duke qenë se nuk ka një format ligjor ku ju referoheni , ndryshimet i shohim të panevojshme.Ndërsa rregjistri i tatimpaguesve permban të dhenat e subjektit si emer mbiemer , emer tregetar lloj aktiviteti dhe adresën e kryerjes se aktivitetit . Debitorët janë në list më vete dhe ngarkohen automatikisht nga sistemi në faturën e gjeneruar të subjekteve në momentin e printimit të njoftim vlerësimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit.

- Lidhur me pretendimin tuaj paraqitur në pikën 2 dhe 3 se mbështetur në ligjin 9632 datë 30.10.2006 ñPër sistemimin e taksave dhe tarifave vendore i ndryshuar, neni 5,pika V dhe VI, është Këshilli Bashkiak që vendos për ñ kriteret dhe proçedurat e marrëdhënieve me taksapaguesit

ñ dhe ñ për mënyrën e zbatimit të sanksioneveò, siç e kemi shpjeguar detajisht në project raport, ju bëjmë me dije se: Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ó*Për sistemin e taksave vendore'* i ndryshuar, në nenin 5 pika ç të tij lidhur me taksat dhe administrimin e tyre, përcaktohet se ó*Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, këshilli i bashkisë ose i komunës përcakton:i) detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës së taksave; ii) mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta; iii) rastet e ndërhyrjes së policisë bashkiake e të komunës, në mbështetje të administrimit të taksave vendore; iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore; v kriteret dhe procedurat e mardhenieve me taksapaguesit, perfshire te drejten e tyre te ankimimit; vi) mënyrat e zbatimit të sanksioneve për kundërvajtje administrative*. Në nenin 35 pika 2 e këtij ligji lidhur me tarifat dhe administrimin e tyre *përcaktohet se ó'Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe përcaktojnë nëse tarifat do të mblidhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent'.*Sipas këtij përcaktimi ligjor, Këshilli Bashkiak vendos mbi tarifat dhe mbledhjen e tyre vetëm në ato raste kur nuk ka përcaktime në këtë ligj apo në ligje të tjera. Për sa më sipër, në ktë ligj, në nenin 34 lidhur me kundërvajtjet administrative dhe sanksionet përcaktohet se ó*Shkeljet e dispozitave për taksat e tjera vendore, që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënimet përkatëse përcaktohen në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 'Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë'*ô. Në rastin gjobës për pagesë të vonuar, e cila është e përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò si rrjedhojë Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë për ta ndryshuar.

- Lidhur me pretendimin tuaj paraqitur në pikën 1 se neni 114 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar nuk aplikohet për taksat dhe tarifat vendore, por vetëm për tatimin mbi fitimin dhe tvsh dhe kontributiin e sigurimeve shoqërore, ju bëjmë me dije se në nenin 2/ç të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, lidhur me fushën e veprimit të këtij ligji përcaktohet se ó*'Ky ligj zbatohet për sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore*'ò, të ndryshuarô.
- Mungesa e llogaritjes së kamatvonesave nuk evidentohet vetëm në vitin 2020, i cili ishte vit pandemie, por kamatvonesat dhe gjobat për pagesë të vonuar nuk janë llogaritur asnjëherë nga Bashkia Sarandë.
- Lidhur me zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me UKT, grupit të auditimit nuk i është paraqitur asnjë evidencë mujore rakordimi sipas kritereve të përcaktuara në akt marrëveshje. Për më tepër, është pohuar nga vetë punonjësit që rakordimet bëhen vetëm për vlerën e paguar dhe jo për debitorët. Gjithashtu, për shkak të mos zbatimit të kushteve të akt marrëveshjes dhe mos rakordimeve mujore sipas kërkesave të saj, ju keni mbajtur gabim listën e debitorëve të taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit, të cilën e keni saktësuar vetëm pasi është kërkuar sqarim nga grupi i auditimit.
- Mënyra e mbajtjes së debitorëve, duhet të lejojë nxjerrjen e analizave.Si rrjedhojë e mbajtjes në formatin që ju e gjykoni të përshtatshëm, grupit të auditimit nuk i keni vënë në dispozicion asnjë nga analizat mbi debitorët të cilat u janë kërkuar vazhdimisht.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Observacion i paraqitur nga Drejtori i Taksave dhe Tarifave Vendor, datë 11.08.2021 mbi Projektraportin e Auditimit, përcjell me shkresën nr. 3628/2 prot, datë 19.08.2021 regjistruar në KLSH me nr. 101/6 prot., datë 23.08.2021.

Pretendimi i subjektit: Komentet e përcjella nga ana e DTTV e Bashkisë Sarandë janë të njëjta me observimet e paraqitura në fazën e mëparëshme për të cilat është bërë trajtimi përkatës në

Projektraportin e Auditimit (pasqyruar më sipër).
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Pretendimet e përcjella nuk përmbajnë argumenta ligjorë të cilat ndryshojnë qëndrimin mbi çështjet e trajtuara në Projektraportin e Auditimit. Sa më sipër observacioni nuk merren në konsideratë.

Titulli i gjetjes nr. 1	**Probleme në procedurat e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, në llogaritjen e gjobave për mos pagim në afat të detyrimit tatimor, në krijimin e regjistrave të subjekteve, dhe në kontabilizimin e detyrimeve te paarkëtuara**
Situata:	**1.**Nga auditimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat, rezulton se për vitin 2019 numri i bizneseve debitore është 1,996 dhe vlera e debisë është 240,293,817 lekë, ndërsa për vitin 2020 numri i bizneseve debitore është 2,313 dhe vlera e debisë është 286,286,480 lekë. Debitorët e tatim taksave janë rritur gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019.Vlera prej **286,286,480 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Nga vlera totale më sipër, vlera e detyrimeve shtesë për periudhën **vitet 2019** dhe **2020** llogaritet në rreth **86,436,484 lekë.** **2.**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë, për periudhën nën auditim nuk ka llogaritur në asnjë rast gjoba për mospagimin në afat të taksave dhe tarifave nga subjektet, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar dhe në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018 ó*Për miratimin e paketës fiskale 2019'*. Kjo Drejtori nuk disponon një databazë analitike të debitorëve, në mënyrë që të llogarisë saktësisht vlerën e kamatëvonesave dhe gjobave për secilin debitor, dhe më pas të ndërmarrë hapat e mëtejshëm veprues për arkëtimin e tyre. **3.**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk disponon një regjistër analitik të subjekteve debitore. Gjithashtu, edhe regjistri i tatimpaguesve nuk paraqet informacion të plotë, pasi nuk paraqet debinë e mëparshme të secilit tatimpagues, por vetëm debinë e vitit ushtrimor. Të dhënat e mbajtuara në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar. **4.**Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, lidhur me mospagimin në afat të detyrimit tatimor, tatimpaguesit duhet të paguajnë gjobë, sikurse përcaktohet në nenin 114 të këtij ligji. Vlera prej **62,696,739 lekë**, nga e cila vlera prej **18,929,590 lekë** i përket shtesave për vitet 2019 dhe 2020 që përbëhen nga gjobat për pagesë të vonuar e llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit, por jo më tepër se 365 ditë, për taksat dhe tarifat vendore të papaguara, përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. **5.**Në paketën fiskale të vitit 2019 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018, në pikën B.8, përcaktohet se vlera e gjobës për pagesat e vonuara do të jetë 0,05 % të detyrimit për çdo ditë vonesë. Ky përcaktim i paketës fiskale lidhur me moslikuidimin në afat të taksave dhe tarifave, bie në kundërshtim me përcaktimin e nenit 114 ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet vlera e gjobës për pagesat e vonuara 0,06%. Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë të përcaktojë vlera të ndryshme nga ato që janë përcaktuar në ligj. **6.**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve debitore dhe nuk ka zbatuar

	asnjë masë shtrënguese. Deri më tani nuk është dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò.
Kriteri:	Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, neni 91, neni 114. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018 ó*Për miratimin e paketës fiskale 2019'*. Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ó*Për sistemin e taksave vendore'* i ndryshuar, neni 5/ç, neni 34, neni 35/2.
Ndikimi/Efekti:	-Mos marrja e masave për mbledhjen e nga taksave dhe tarifave vendore të papaguara nga bizneset, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën prej 286,286,480 lekë. -Mos llogaritja e gjobave për pagesë të vonuar nga bizneset dhe mosmarrja e masave për arkëtimin e tyre, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 58,754,739 lekë. -Mos pasqyrim i drejtë i situatës financiare të Bashkisë Sarandë sjell mangësi në realizimin e të ardhurave të programuara sipas paketës fiskale dhe rrjedhimisht mos përmbushje e programeve buxhetore në lidhje me realizimin e tyre, duke mos ofruar të gjitha shërbimet e nevojshme për popullatën.
Shkaku:	Mos ndjekja dhe mos arkëtimi i detyrimeve të debitorëve nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 2	**Bashkëpunim jo efektiv me agjentët tatimorë që vjelin të ardhura për Bashkinë Sarandë**
Situata:	**1.**Nga auditimi i mbledhjes së të ardhurave nga agjentët tatimorë, rezulton se bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe UKT nuk është efektiv, pasi nuk bëhen rakordime mujore mbi numrin e faturave të lëshuara, numrin e faturave të arkëtuara dhe debitorët, sikurse përcaktohet në akt-marrëveshjet nr.390 prot, datë 12.02.2019 dhe nr.678 prot, datë 21.02.2020. Bashkia Sarandë informohet vetëm mbi pagesat, të cilat i merr vazhdimisht në mënyrë manuale nga bankat. Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk ka kërkuar nga UKT të dhëna periodike të detajuara, por merr nga bankat vetëm vlerën e arkëtimeve, gjë e cila ka shkaktuar gabime në mbajtjen e të dhënave dhe në pasqyrimin e saktë të situatës lidhur me arkëtimet dhe debitorë e taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit. **2.**Vlera e debisë nga familjarët për taksën e ndërtesës deri në vitin 2020 është 39,384,280 lekë ndërsa për tarifën e shërbimit deri në vitin 2020 është 50,421,939 lekë, në total **89,806,219 lekë** të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë të cilat nuk janë mbledhur nga agjenti tatimor UKT. Nga kjo vlerë për vitet 2019 dhe 2020 rritja ka qenë në shumën rreth **50,654,610 lekë.** Kjo vlerë është e pakontabilizuar. Gjithashtu, konstatohet se për këta debitorë nuk është aplikuar gjobë për pagesë të vonuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar. **Vlera 19,667,562 lekë** (89,806,219 lekë x 0.06% x 365=19,667,562 lekë) **e pallogaritur dhe e paarkëtuar për pagesë të vonuar, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Nga kjo vlera e cila i përket viteve **2019** dhe **2020** paraqitet **11,093,360 lekë.** **3.**Përveç agjentëve tatimor të jashtëm, Bashkia Sarandë aplikon mbledhjen e taksës mbi tokën bujqësore nëpërmjet agjentëve të brendshëm, të cilët i punëson me kontratë pune 3-mujore. Nga shqyrtimi i procedurës së mbledhjes së kësaj

	takse, rezulton se lë vend për abuzime dhe gabime operacionale, pasi pagesa ju mblidhet zotëruesve të tokës bujqësore nëpërmjet mandat arkëtimeve të bëra dorazi, dhe më pas paratë derdhen në bankë nga agjenti tatimor. Nga sa më sipër, rezulton se vlera e debisë nga taksa mbi tokën bujqësore është **23,048,008 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë. Kjo vlerë është e pakontabilizuar nga e cila shtesa për vitet 2019 dhe 2020 paraqitet **8,164,213 lekë**.
Kriteri:	-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, neni 114. -Akt-marrëveshjet nr.390 prot, datë 12.02.2019 dhe nr.678 prot, datë 21.02.2020 lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe UKT.
Ndikimi/Efekti:	-Mos marrja e masave për mbledhjen taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit nga familjarët, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën prej 89,806,219 lekë. -Mos llogaritja e gjobave për pagesë të vonuar dhe mosmarrja e masave për arkëtimin e tyre për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 19,667,562 lekë. -Mos marrja e masave për mbledhjen taksës mbi tokën bujqësore, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën prej 23,048,008 lekë lekë.
Shkaku:	-Zbatim jo efektiv i marrëveshjes së bashkëpunimit me agjentin tatimor UKT
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 3	**Kontrata të plazheve të lidhura jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore**
Situata:	**1**.Nga auditimi i kontratave të plazhit për vitin 2019 dhe 2020, në të gjitha rastet konstatohet se kontratat janë lidhur jashtë afatit të përcaktuar në nenin 4 pika 4 të VKM nr. 171, datë 27.3.2019 për miratimin e rregullores ñPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, ku përcaktohet se njësitë e qeverisjes vendore duhet të lidhin kontratat e qirasë së plazheve deri me datën 31 mars. Gjithashtu, është konstatuar se në vitin 2019, në 21 kontrata plazhi hapësira e plazhit të dhënë në përdorim për stacion plazhi, është më e vogël se 200 m, në kundërshtim me kërkesat e pikës 7 të VKM-së së mësipërme. **2.**Nga auditimi është konstatuar se paketa fiskale e vitit 2019 nuk është përditësuar me ndryshimet që kërkon VKM nr. 171, datë 27.3.2019. Në kontratat e vitit 2019, sasia e ditëve për të cilat subjektet duhet të paguajnë qera është llogaritur 135 ditë. Sipas përcaktimeve të VKM nr.171, datë 27.3.2019, subjektet duhet të paguanin 153 ditë qera plazhi dhe jo 135 ditë. Problematikë e cila është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH. **3.**Nga një kampion i përzgjedhur rastësor për 10 kontrata, u konstatua se kontratat nuk përmbanin bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për plotësimin e aplikimit, sikurse përcaktohet në nenin 9 të VKM nr.424, datë 27.5.2020. Gjithashtu, databaza e kontratave të plazheve e mbajtur në format elektronik, ka pasaktësi në përcaktimin e sipërfaqeve për disa subjekte dhe gabime në llogaritje, duke mos dhënë informacion të plotë dhe të besueshëm. Përveç sa më sipër, në një kontratë është konstatuar pasaktësi në llogaritjen e sipërfaqes. Në kontratën e lidhur me datë 16.07.2020 ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe E D person fizik, më përfitues Bashkinë Sarandë, është konfirmuar marrja në përdorim e hapësirës së plazhit prej 200 m2. Ndërkohë, në llogaritjen e vlerës që do të paguhet, të bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Sarandë, sipërfaqja e llogaritur është 144 m2.

	Llogaritja e pagesës duhet të bëhej në bazë të kontratës, dhe si rrjedhojë e llogaritjes për tu paguar të një sipërfaqe prej 56 m2 më pak sesa përcaktimi në kontratë, është shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 42,000 lekë**.
Kriteri:	-VKM nr. 171, datë 27.3.2019 për miratimin e rregullores ñ*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò, neni 4/4; neni 7; neni 11. -VKM nr.424, datë 27.5.2020 *Për një shtesë në vendimin nr.171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò, neni 9.
Ndikimi/Efekti:	Mos llogaritja e saktë e ditëve për të cilat subjektet duhet të paguanin qira plazhi, ka shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 44,800 lekë.
Shkaku:	-Mos zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 4	**Mos aplikim i tarifave për subjektet me veprimtari tregtare speciale dhe mos evidentimi i saktë i tyre**
Situata:	**1.**Nga lista që disponon Bashkia Sarandë mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure brenda territorit të saj, rezulton se janë 15 subjekte që e ushtrojnë këtë aktivitet dhe të gjithëve iu ka përfunduar licenca para vitit 2020. Nga sa më sipër, vetëm 1 subjekt, óO shpkô ka bërë rinovim të licencës, ndërkohë pjesa tjetër e subjekteve operojnë pa licencë që nga viti 2015, në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr.970, datë 2.12.2015 dhe në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 344, datë 19.4.2017. Si rrjedhojë, **vlera prej 14,000,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që disponon Bashkia Sarandë. Megjithatë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të verifikojë nëse ka subjekte që e kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimi apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë. **2.**Për sa më sipër, Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin e subjekteve që operojnë pa licencë dhe për arkëtimin e tarifave, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15.1 të VKM nr.970, datë 2.12.2015. Gjithashtu, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh. Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për evidentimin e të gjitha subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti si dhe të subjekteve të reja që mund të jenë shtuar, si dhe ka treguar një neglizhencë totale në kontrollin e këtyre subjekteve lidhur me detyrimet tatimore.
Kriteri:	-VKM nr.970, datë 2.12.2015 *Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò, neni 14; neni 15.1. -VKM nr. 344, datë 19.4.2017 ó*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò neni 9.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e kontrollit ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë pa licencë dhe mos rinovimi i licencave, ka shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 14,000,000 lekë**.**

Shkaku:	-Mos evidentimi i të gjitha subjekteve që tregtojnë hidrokarbure në territorin e Bashkisë Sarandë; -Mungesa e kontrollit ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë pa licencë.
Rëndësia:	E lartë

(Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. A G Kryetar i Bashkisë, J M ish Drejtor i DTTV, L B Drejtor i DTTV).

- **Drejtimi 5:** ***Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.***

<u>Titulli i gjetjes nr. 1</u>: Mbi kontabilizimin e Aktiveve aftagjata materiale, pa titull pronësie.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 1,132,520,369 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

- llog 210 ñToka troje terreneò, 29 elementë në vlerën neto 115,397,833 lekë
-llog. 211 ñPyje plantacioneò, 2 elementë në vlerën neto 31,804,000 lekë,
-llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò, 14 objekte me vlerën neto 985,318,536 lekë
-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dukumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri: - VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshmeò, Kreu VI ñTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò, ku cilësohet:

"1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtrin të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen".

Impakti: Mungesa e titullit të pronësisë:

- është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
- është pengesë për menaxhimin e rsiqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
- ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku: -Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë:

-dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;
-vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
-kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Specialisti i buxhetit dhe menaxhimit të Aseteve zj. M I dhe Drejtoresha Zhvillimit Financiar dhe Kujdesit Social znj. T S .

<u>Titulli i gjetjes nr. 2</u>: Mbi kontabilizimin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*".

Situata: Duhet theksuar se jo cdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet ne aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, dhe në rastin tonë janë rrugët dhe veprat ujore. Vetëm shpenzimet kapitale të cilat janë situacione përfundimtare dhe janë marrë në dorëzim objekti, atëherë kapitalizohet e gjithë vlera e tij të llogaria e aktivit.Shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale(kosto historike) për llogarinë 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, ka qenë në vlerën 78,717,784 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqërues në urdhërshpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, disa prej faturave të sipërcituara nuk përbëjnë rritje aktivi sepse projekti përkatës në fund të vitit 2019 nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Më poshtë paraqesim në forëm tabelare shpenzimet kapitale të cilat duhet të ishin rregjistruar si 231 dhe jo të kapitalizoheshin në 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò për vitin 2019. Shtesa e shpenzimit kapital prej 1,451,340 lekë për investimin e ñShkallëve lidhese ndërmjet rrugëve në lagjen 2 dhe sistemime ne ambjentet publikeò e vitit 2019, është marrë në dorëzim në vitin 2020, kështu që është nuk duhej të kapitalizohej në llogarinë 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò por duhej të debitonte llogarinë 231 ñShpenzime për Rritjen e AQTò.
Pra investimi duhet të rregjistrohej
-Për vitin 2019: në llogarinë 231 ñShpenzime për rritjen e AAGJMò për shumën 1,451,340 lekë dhe jo në llogarinë e aktivit 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò.

Kriteri: - Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Impakti: Paraqitja e aktivit 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò në vlerën **1,451,340** lekë më shumë në vitin 2019 sjell pasqyrim jo të saktë të AQT-ve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivit në njësi

Rëndësia: **E lartë**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtoresha e Zhvillmit Financiar dhe Kujdesit Social znj. T S .

<u>Titulli i gjetjes nr. 3</u>: Mbi inventarizimin e aktiveve për vitin 2019".

Situata: Nga relacionin e mbajtur nga komisioni i inventarizimit, më datën 19.12.2019, është evidentuar mosrakordim ndërmjet gjendjes kontabël dhe gjendjës fizike, pas kontrollit në terren. Ky mosrakordim konsiston në kontenierët e mbeturinave të cilët i janë dhënë në dorëzim operatorit ekonomik ñK ñSHPK, i cili ka lidhur kontratën e pastrimit të qytetit të Sarandës për vitin 2018. Sasia e kontenierëve të munguar, dhe që kanë qenë nën përgjegjësi të operatorit ekonomik ñK ò SHPK është 155 kontenierë metalikë dhe 13 kontenierë plastic.

Për këtë arsye, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur dhe një procesverbal në datën 25.11.2019 ku specifikohet mungesa e kontenierëve të sipërcituar dhe bashkalidhur paraqitet dhe kartela inventariale me sasitë dhe cmimet përkatëse të kontenierëve, të cilën po e paraqesim më poshtë;

Nr	Emërtimi	Data e vënies	Njësia	Gjendja kontabile			Gjendja fizike			Diferencat	
				Sasi	Cmim	Vlerë	Sasi	Cmim	Vlerë	Sasi	Vlerë
1	Kontenierë metalik	2001	copë	32	27,540	881,280		27,540	-	32	881,280
2	Kontenier	2016	copë	95	49,884	4,738,980	95	49,884	4,738,980	-	
3	Kazan mbeturinash metalik	2002	copë	34	51,600	1,754,400		51,600	-	34	1,754,400
4	Kazan metalik	2001	copë	70	41,820	2,927,400	20	41,820	836,400	50	2,091,000
5	Kazan plastik	2001	copë	50	16,380	819,000	11	16,380	180,180	39	638,820
6	Kosh mbeturinash	2011	copë	15	14,544	218,160	15	14,544	218,160	-	
7	Kazan mbeturinash	2012	copë	77	57,840	4,453,680	77	57,840	4,453,680	-	
8	Kazan metalik 1100 littra	2018	copë	100	45,348	4,534,800	100	45,348	4,534,800	-	
9	Kontenier pastrimi	2017	copë	20	44,340	886,800	20	44,340	886,800	-	
10	Kazan metalik	2019	copë	50	43,200	2,160,000	50	43,200	2,160,000	-	
11	Kazan plastik	2019	copë	95	31,800	3,021,000	95	31,800	3,021,000	-	
12	Kazan metalik 1100 litra	2014	copë	40	49,788	1,991,520	40	49,788	1,991,520	-	
	Shuma			678	474,084	28,387,020	523	474,084	23,021,520	***155***	***5,365,500***

Përgjegjësit material të kontenierëve dhënë në përdorim operatorit ñK ò SHPK, janë z. I L dhe z. A H me detyrë Specialist të Sektorit të Pastrimit.

Për shkaktimin e humbjes së inventarëve kontenierë mbeturinash ngarkohen me përpgjegjësi përgjegjësit material si më sipër, pra z.I L dhe z. A H me detyrë Specialist të Sektorit të Pastrimit.

Referuar kontratës që autoriteti ontraktor Bashkia Sarandë ka me operatorin ekonomik ñK ñ SHPK me nipt J G, në nenin 26.1 pika citohet ñ Mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga sipërmarrësiò.

Për këtë arsye, për humbjen e inventarëve kontenierë mbeturinash me vlerë kontabël **5,365,918 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë,** *ngarkohet me përgjegjësi Operatori Ekonomik 'K l" SHPK me NIPT J G.*

Kriteri: - Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 43*

Impakti: Humbja e aktiveve të cilat janë në pronësi të Bashkisë Sarandë shkakton dëm ekonomik, referuar ligjit dhe kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të aktiveve si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivit në njësi.

Rëndësia: **E lartë**

Për humbjen e inventarëve kontenierë mbeturinash ngarkohet me përgjegjësi Operatori Ekonomik 'K " SHPK me NIPT J G. Për shkaktimin e humbjes së inventarëve kontenierë mbeturinash ngarkohen me përgjegjësi përgjegjësit material si më sipër, pra z.I L dhe z. A H me detyrë Specialist të Sektorit të Pastrimit si dhe Kryetari i Bashkisë si Titullar per ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashte perdorimit te aktiveve te njesise publike ne perputhje me kerkesat e udhezimit nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 5.

<u>Titulli i gjetjes nr. 4</u>: Mbi kontabilizimin e llogarisë AAGJJM 202 "*Studime e kërkime*".

Situata: Llogaria 202 ñStudime dhe Kërkimeò paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 14,433,919 lekë, dhe në fund të vitit 2019 në vlerën neto 23,441,536 lekë, Diferenca në rritje vjen për shkak të një projekti për hartimin e polaneve të detajuara vendore me vlerë 14,868,000 lekë.

Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën historike prej 119,561,177 lekë dhe përbëhet nga 113 projekte për investime të kryera të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò **Pika 2. Klasa 2,** ñAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 202 ñStudime e kërkimeò.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Aneksi 1 ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në

sektorin publikò **Pika 2. Klasa 2,** ñAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël).

Rëndësia: **E lartë**

<u>Titulli i gjetjes nr. 5</u>: Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 "*Aktivet Afatgjata Financiare*".

Situata: Bashkia Sarandë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Butrinti, një sh.a. me NUIS ñL14717801Vò e cila është shoqëri aksionere me objekt ñ"Organizimi i aktiviteteve sportive ne fushen e futbollit...që lidhet drejtperdrejteose terthorazi me objektin e sajò. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 2.000.000 lekë

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesmarrje të Bashkisë Sarandë në ñKF Butrrinti ñ Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 ,më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomaterialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesmarrjeò

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 2,000,000 lekë dhe investori është Bashkia Sarandë.

Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne pjesmarrje me vlerë kontabël 2,000,000 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò, gjendje kjo e nën vlerësuar me 2,000,000 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 ñInvestime në Pjesëmarrjeò.

Rëndësia: **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtoresha e Zhvillimit Financiar dhe Kujdesit Social znj. T S ..

<u>Titulli i gjetjes nr. 6</u>: Mbi kontabilizimin e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

Situata: - **Llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*"** paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqesore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2019 paraqiten në shumën 67,663,864 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2019 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2019	36,705,596
Shtesa gjatë vitit 2019 (D)	34,221,865
Pakësime gjatë vitit 2019 (K)	3,263,597
Gjendja në 31.12.2019	**67,663,864**

Siç shihet edhe nga tabela llogaria 467 paraqitet në vlerën **67,663,864** lekë e përbërë nga:

- shpenzime të kryera por të pafinacuara per mallra dhe sherbime ne masen 34,667,074 dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën 67,663,864 lekë;
- shpenzimet për vendime gjyqesore në shumën 11,027,581 lekë;

shpenzime per investime por të pa likuiduara në shumën 21,969,209 lekë.

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Sarandë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likujduara në 2020 por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019. Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2019 dhe 2018 por të parregjistruara në dhe të likuduara në 2020, paraqiten si më poshtë;

Ec Account	Ec Account Description	Kodi Project	Project Description	Furnitori	Shuma	Data Furnitorit	Data USH	Gl Dtae	Data Rregjistrimit	Data Ekzekutimit
2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrjeteve	1380121	Instalimi i kamerave te sigurise ne qytet	ELEKTROSEK	870,000	12-Dec-19	24-Apr-20	24-Apr-20	4/24/2020	4/28/2020
2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	1380122	Shtrim me beton rruga Baba Sherifi,rruga Ismail Qemali rruga Ibrahim	ED KONSTRUKSION	7,800,000	14-Dec-19	14-Feb-20	14-Feb-20	2/14/2020	2/18/2020
2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrjeteve	1380121	Instalimi i kamerave te sigurise ne qytet	ELEKTROSEK	9,551,771	12-Dec-19	30-Jan-20	30-Jan-20	1/30/2020	1/31/2020
2313300	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrjeteve	1380119	Riparim sistemim KUZ Sarande Ksamil	EREDA	2,338,578	10-Dec-19	28-Jan-20	28-Jan-20	1/28/2020	1/29/2020
2312103	Shpenz. per rritjen e AQT - ndertesa shkollore	M112606	EKO Kampus Saranda	BEAN	11,782,645	6-Dec-18	30-Mar-20	30-Mar-20	3/30/2020	4/9/2020
2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	1380122	Shtrim me beton rruga Baba Sherifi,rruga Ismail Qemali rruga Ibrahim	ED KONSTRUKSION	3,000,000	30-Nov-19	30-Jan-20	30-Jan-20	1/30/2020	1/31/2020
2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	1380116	Sistemim betonizim rruga te Bugovilja	ARTI	3,481,957	27-Dec-19	29-Jul-20	29-Jul-20	7/29/2020	7/30/2020
2313100	Shpenz. per rritjen e AQT - konstruksione te rrugeve	1380118	Ndertim sistemim rruga Dea Ksamil	JODY-KOMPANY	85,135	1-Nov-19	4-Feb-20	4-Feb-20	2/4/2020	2/5/2020
	Totali				38,910,086					

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2019, ka nënvlerësuar llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëmò me **38,910,086 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëmò të detyrimeve për faturat e likujduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019 përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave ***<u>janë nënvlerësuar me 38,910,086 lekë</u>***.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji *9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò neni

5, 6, 7, 9 dhe 10, *ligjin 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 " Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*ò dhe *Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*ò

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 467 ñ**Kreditorë të ndryshëm**ò, gjendje kjo e nën vlerësuar me **38,910,086** për vitin 2019.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 ñKuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareò

Rëndësia: **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtoresha e Zhvillmit Financiar dhe Kujdesit Social znj. T S .

- **Drejtimi 6:** ***Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".***

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.
-Regjistri i Prokurimeve për periudhën Korrik-Dhjetor 2019;
-Regjistri i Prokurimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020;
-Të dhëna elektronike nga sistemi elektronik i APP;
-Dosje të procedurave të përzgjedhura për trajtim;
-Të tjera informacione dhe dokumentacione:

Procedurat e prokurimit publik për mallra, punë dhe shërbime
Gjatë periudhës nën auditim Korrik 2019 - Dhjetor 2020 procedurat e prokurimit të zhvilluara paraqiten si më poshtë vijon:

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
Buxheti vjetor i Bashkisë Sarandë është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 79 datë 29.12.2018 ndërsa për vitin 2020 me VKB nr. 43 datë 23.12.2020. Në relacionet shoqëruese të këtyre buxheteve të miratuar paraqiten zërat e shpenzimeve të cilat do të kryhen për blerje mallrash, shërbimeve si dhe investimet e parashikuara për tu kryer gjatë vitit ushtrimor sipas emërtimeve.
Institucioni ka hartuar regjistrat e parashikimit në sistemin elektronik të APP të cilët janë publikuar prej saj. Konsatohet se, regjistrat e parashikimit nuk janë dërguar pranë degës së thesarit në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për pokurimin publikò, i ndryshuar, nenit 5 pikat 1 dhe 4 të saj, ñRegjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publikò ku përcaktohet se,

1).....Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.
***4)** Autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara. .....*
Një kopje e këtyre ndryshimeve, pas publikimit të tyre nga APP-ja duhet t'u dërgohet degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë

si dhe në kundërshtim me Udhëzimi nr. 1, datë 05.01.2018 ñPër hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik dhe krijimi i tyre në sistemin elektronikò.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Sipas të dhënave të subjektit të audituar rezulton se për periudhën nën auditim janë kryer gjithsej 34 procedura prokurimi dhe 103 procdura me vlerë të vogël. Ecuria e tyre paraqitet si më poshtë vijon:

	Procedura prokurimi me vlerë të vogël < 800,000 lekë		Porcedura prokurimi		Gjithsej procedura të zhvilluara	
Periudha	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlera në Lekë (pa tvsh)
Korrik-Dhjetor 2019	47	7,778,457	5	71,131,222	52	78,909,679
Viti 2020	56	9,797,739	29	303,764,536	85	313,562,275

Burimi: Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit

	Procedura Prokurimi/ Në numër			Prokurime /Në Lekë sipas Fondit Limit		
Periudha	Parashikuar	Realizuar	Realizuar Në %	Parashikuar	Realizuar	Realizuar Në %
Korrik-Dhjetor 2019	6	5	83%	80,089,202	71,131,222	89%
Viti 2020	50	29	58%	324,105,867	303,764,536	94%

Burimi: Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit

Në tabelën më sipër paraqitet niveli i realizimit të procedurave në numër referuar parashikimeve fillestare të tyre si dhe niveli i fondeve sipas kontratave të lidhura krahasuar me fondin limit të prokuruar.

Sipas natyrës procedurat paraqiten si më poshtë vijon:

	6 mujori II-të/2019		Viti 2020	
Emërtimi	Procedura të ralizuara në numër	Vlerë e kontraktuar (PA TVSH)	Procedura të ralizuara në numër	Vlerë e Realizuar/kontraktuar (pa tvsh)
Mallra të ndryshëm	1	5,000,000	4	11,613,200
Punë publike	3	17,665,134	23	288,945,077
Shërbime	1	48,466,088	2	3,206,259
Shuma	**5**	**71,131,222**	**29**	**303,764,536**

Burimi: Bashkia Sarandë, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga ana e grupit të auditimit më poshtë trajtohen procedura të cilat zënë rreth 53% të fondeve të prokuruara si më poshtë vijon:

-Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit *(vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit);*

REF-75592-10-15-2020 Procedurë e Hapur

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *"Rikonstruksion i ujesjellesit Ksamil (Depo+Rrjeti shperndares-lagja nr.3 dhe nr.4", viti 2020"*		
1. Urdhër Prokurimi Nr.24 datë 12.10.2020	**3. Njësia e prokurimit** Nr.24 datë 12.10.2020 1. E 2. R 3. L	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr.24 /1 datë 12.10.2020 1. E 2. R 3. K
2. Lloji i Procedurës "E hapurò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 131,208,333 lekë	**6. Oferta fituese (pa TVSh)** **OE "C " SHPK** me ofertë **131,133,986** lekë pa TVSH, me kontratë me afat 365 ditë kalendarike.	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** **74,347** lekë ose **0.06 %**
8. Data e hapjes së tenderit Datë 17.11.2020	**9. Burimi Financimit** Buxheti i i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE b) Skualifikuar **2** OE/BOE, c) Kualifikuar **2** OE/BOE
11. Ankimime **AK**: Sôka---; **KPP:** Sôka **APP:** Sôka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr. ------	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP Shkresa nr. ----, dt. ----

Data e caktuar për hapjen e ofertave është data 17.11.2020.
Për këtë procedurë kanë ofertuar Brenda afateve:

C	SHPK	131,133,986 lekë pa tvsh
B	SH.P.K	131,179,690 lekë pa tvsh
K		ska ofertë
E		ska ofertë

Nga komisioni janë kualifikuar 2 ofertat e para si në përputhje me kriteret e vendosura dhe fitues është shpallur C SHPK me NIPT J . Ankimime në këtë procedurë nuk ka.

Lidhur me këtë procedurë konstatohet se,
Me urdhrin e prokurimit nr. 24 datë 12.10.2020, protokoll ska, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar një shoqëri private R S shpk për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt. Kjo shoqëri ka hartuar projektin përkatës të këtij investimi i cili është përcjell nga Ujësjellës Kanalizimet SHA, Sarandë me shkresën nr. 396/4 prot, datë 16.09.2020. Baza ligjore e përdorur në urdhër është VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për pokurimin publikò, i ndryshuar, neni 59 dhe 61 pika 2 e tij. Nga ana e R S shpk nuk është hartuar një procesverbal apo akt të mbajtur i cili të përcaktojë fondin limit por në dosje gjendet vetëm një preventiv zbatimi punimesh i ndërtuar bazuar në manualin e punimeve të ndërtimit/2015 me një vlerë Fondi Limit 131,206,085 lekë.

Nëse do ti referohemi relacionit teknik të paraqitur nga R S shpk, (në faqen e tij të parë i referohet vitit 2018 ndërsa firma dixhitale në fund të materialit mban datën 13.10.2020), në të përshkruhen llogaritjet e volumeve të projektit të cilat janë dukshëm më të vogla se preventivi i hartuar. Nga ana jonë u evidentua ndryshimi në volume lidhur me Zërin **Gërmime** i cili në relacion paraqitet 8,553.5 m3 (7,553.5+1,000) nga të cilat 1,000 m3 paraqitet volumi i depos së ujit, ndërsa

në preventiv ky zë punimi paraqitet 11,032 m3 ose 2,478.5 m3 më tëpër ose **2,974,200 lekë pa tvsh më tepër.**

Emertimi punimit në PREVENTIV	Volumi në M3
Germim dheu shkemb I forte me ekavator me zinxhir	6,651
Germimkanalesh shemb I forte me matraik dhe pastrim me krahe	535
Germim shkemb I but eskavtor me zinxhir	8
Germim shkemb I but me eskavator me zinxhir	3,486
Germim shkemb I but me eskavator me zinxhir	320
Germim shkemb I but me eskavator me zinxhir PER KANAL	32
Shuma	**11,032**

Zëri **Mbushje me material të gërmuar** paraqitet në relacionin teknik në volumin 5,257.3 m3 ndërsa në preventiv paraqitet 12,230 m3 ose 6,972.7 m3 më tepër **ose në vlerën 3,486,350 lekë pa tvsh llogaritur më tepër.**

Emertimi punimit në PREVENTIV	Volumi në M3
Transport material te germuar 10 km	4,456
Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	5699
Mbushje me material te germuar	2,075
Shuma	**12,230**

Lidhur me procedurën, nëse i referohemi vendosjes së kritereve të veçanta evidentohet se, disa kritere paraqiten jo të qarta të cilat në vlerësimin tonë kanë krijuar kufizime në pjesëmarrjen e operatorëve ku përmendim si më poshtë vijon:

Kriteri: 2.2.d. Operatori ekonomik nuk duhet të figurojë (-jne në rast bashkimi OE) debitor ne institucioin e Bashkise Sarande. Kjo eshte e vlefshme me nje vetedeklarime nga OE pjesemarese.
Referuar rekomandimeve të APP drejtuar AK, me shkresën nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018, për aq kohë sa ky informacion zotërohet nga institucioni ky kriter nuk është i nevojshëm të vendosej.

Kriteri: 4- Operatori/et ekonomike ofertues duhet te kete **DrejtuesTeknik i Shoqerisë:**
Ne rast te ofertimit si Bashkim i Operatoreve Ekonomike, secili anetar i Bashkimit te Operatoreve Ekonimike duhet te zoteroje Stafin teknik te mesiperm ne Liçencen e shoqerise si drejtues teknik.
Vendosja e këtij kriteri është i padrejtë pasi BOE krijohen pikërisht për përmbushjen e kritereve të cilat OE më vete nuk arrijnë ti përmbushin. Ndërkohë ky kriter krijon kufizim për këto bashkime.
Kriteri:
a) Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në Liçencën e Shoqërisë dhe Listëpagesat te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, te punesuar me kohe te plote ne Shoqeri. Detyrimisht te paraqiten Kontrate pune e vlefshme dhe diplome.

Vendosja si kriter e punësimit pranë shoqërisë të paktën për 6 muaj krijon kufizim pasi fokusimi tek periudha e punësimit në shoqëri dhe jo tek vjetërsia e punës së drejtuesve teknikë krijon kufizim në pjesëmarrje.

Kriteri:
b) Inxhinieri Mjedisit, pjese e stafit teknik duhet te jete i pajisir me Çertifikate te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis te leshuar nga Ministria e Mjedisit.
Ne rast te ofertimit si Bashkim i Operatoreve Ekonomike, secili anetar i Bashkimit te Operatoreve Ekonimike duhet te zoteroje çertifikatat e mesiperme. Neni 56-72 i VKM

Aplikimi i këtij kriteri njëlloj si më lartë, është mjaft kufizues pasi këto kritere duhet të pëmbushen së bashku nga operatorët dhe jo më vete nga secili prej tyre më vete.

5- *Krahas stafit te mesiperm per te realizuar punimet perkatese, operatori ekonomik te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*
Operatori ekonomik te paraqes per stafin e mesiperm kontratat e punes, diplome, CV.
Stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht 6 muajt e fundit.

Sa më sipër edhe kriteri 6-mujor është kufizues dhe nuk stimulon pjesëmarrje.

Kriteri:
6- Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të certifikuar me deshmi te sigurimit teknik lëshuar nga DPA ose Trupa çertifikuese ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Brenda kesaj liste duhet te deshmoje, dhe te figuroje ne listepagesa per 6 muajt e fundit:
Sa më sipër edhe kriteri 6-mujor është kufizues dhe nuk stimulon pjesëmarrje.

Kriteri:
8- Operatori ekonomik ofertues, duhet te kete nje prej inxhinireve te stafit teknik te çertifikuar si Auditues Energjie ne ndertesa (per kete te paraqitet Diploma ose çertifikata. *Ne rast te ofertimitsi Bashkim i Operatoreve Ekonomike, secili anetar i Bashkimit te Operatoreve Ekonimik duhet te zoteroje çertifikaten e mesiperme.*
9- Operatori ekonomik te kete Liçense per Mbrojtjen nga Zjarri te leshuar nga QKL.Kodi 1.2.A.
10- Operatori ekonomik te kete Licençe per Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis (Auditim mjedisor ndikim ne mjedis) Kodi III.2.A (1+2).
11- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesitme Kod III.2.B. per Grumbullim dhe Transport te mbetje jo te rrezikshme.
Ne rast te ofertimit si Bashkim i Operatoreve Ekonomike, secili anetar i Bashkimit te Operatoreve Ekonimik duhet te zoteroje Liçenca te mesiperme ne pikat 9, 10, dhe 11.

Edhe në këtë rast në kriteret 8-11, përcaktimi i zotërimi i licencave nga secili anëtar më vete përbën kufizim për OE, pasi secila nga shoqëritë duhet të zotërojë licencat në përputhje me pjesën e punimeve që ajo do të marrë përsipër referuar akt-marrëveshjes.
Kriteri:
12- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- *ISO 39001: 2012 (Certifikate per sistemin menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor).*
- *ISO/IEC: 27001:2013: Çertifikate per menaxhimin se sigurise se informacionit*

Të dy këto certifikata vlerësohen jo në përputhje me natyrën e punës që do të kryhet dhe e kufizojnë pjesëmarrjen në garë në kundërshtim me nenin 30 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, e ndryshuar ku përcaktohet se, *Certifikatat e kërkuara do të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.*

Në procedurën e ndjekur nga AK janë konstatuar shkelje të **nenin 46**, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **neni 26** "Kontrata për punë publike" pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*.
Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 61, pika 2 ñhartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò ku citohet se *"Në çdo rast, hartimi i tyre **duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht**, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre"*.
Për këtë procedurë është shpallur fituese është shpallur oferta me vlerën më të ulët dhe nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë dhe nuk ka patur ankime mbi procedurën.
Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi R S shpk.

REF-67355-07-29-2020 Procedurë e Hapur

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *"Pastrimi i qytetit dhe largimi i mbetjeve"*		
1. Urdhër Prokurimi Nr.25 datë 27.07.2020 **2. Lloji i Procedurës** "E hapurò	**3. Njësia e prokurimit** Nr.25/2 datë 27.07.2020 1. E 2. R 3. L	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr.25 /3 datë 27.07.2020 1. E 2. J 3. K
5. Fondi Limit (pa TVSH) 55,833,333 lekë	**6. Oferta fituese (pa TVSh)** **OE "A Construcion" SHPK** me ofertë 54,642,891 lekë pa TVSH, me kontratë, me afat 365 ditë kalendarike.	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** **1,3190,442** lekë ose **2.1 %**
8. Data e hapjes së tenderit Datë 17.11.2020	**9. Burimi Financimit** Buxheti i i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **4** OE/BOE b) Skualifikuar **3** OE/BOE, c) Kualifikuar **1** OE/BOE
11. Ankimime **AK**: nr. 3866 prot, datë 21.09.2020 nr. 3872 prot, datë 21.09.2020 nr. 4009 prot, datë 29.09.2020 **KPP:** nr. 4129 prot, datë 05.10.2020 **APP:** Sõka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Shkresa nr.3866/1 prot, datë 23.09.2020 nr. 3872/1 prot, datë 23.09.2020 nr. 4009/1 prot, datë 05.10.2020	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP KPP nr. 506/1 prot, datë 06.11.2020 APP nr. 7230/3 prot, datë 16.12.2020

OE Ofertues

P	54,642,891.4 Lekë pa tvsh
K	54,777,541.5 Lekë pa tvsh
A	48,466,088.05 Lekë pa tvsh
C	Ska ofertë

Me shkresën datë 16.09.2020 KVO ka bërë klasifikimin përkatës duke kualifikuar tre ofertuesit e parë dhe duke skualifikuar C SHPK..

Mbi procedurën e ndjekur ka paraqitur ankesë Shoqëria A Construcion me shkresën nr. 3872 prot, datë 21.09.2020 dhe K SHPK me shkresën nr. 3866 prot, datë 21.09.2020.
Me Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 25/5 datë 21.09.2020 është ngritur Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës i përbërë nga z. R C , E M dhe B L të cilët me Vendimet e datës 21.09.2020 ka vendosur:
Lidhur me kërkesën e shoqërisë A Construcion, KSHA ka vendosur pranimin e ankesës dhe shfuqizimin e vendimit të KVO mbi kualifikimin e OE P dhe K SHPK. Ndërsa lidhur me kërkesën e shoqërisë K SHPK, KSHA ka vendosur mospranimin e saj.
Vendimet janë përcjell ankuesve me shkresat nr. 3872/1 prot datë 23.09.2020 dhe nr. 3866/1 prot, datë 23.09.2020.
Me formularin e ankesës nr. 4009 prot, datë 29.09.2020 K SHPK ka kërkuar skualifikimin e ofertës të dy operatorëve të tjerë si dhe rivlerësimin e procedurës.
Me Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 25/6 viti 2020 është ngritur **Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës** i përbërë nga z. R C , E M dhe B L të cilët me Vendimin e datës 29.09.2020 ka vendosur mospranimin e ankesës, përcjell OE me shkresën nr. 4009/1 prot datë 05.10.2020.
Me ankesën administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 4129 prot datë 05.10.2020 OE K SHPK i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar skualifikimin e dy operatorëve të tjerë.
Me vendimin nr. 1215/1 prot, datë 08.10.2020 KPP ka vendosur të kalojë për shqyrtim ankesën e bërë nga ky OE dhe ka urdhëruar pezullimin e praktikës.
Me shkresën nr. 4241/1 prot, datë 13.10.2020 Bashkia Sarandë ka përcjell informacionet përkatëse pranë KPP.
Me vendimin nr. 1280/1 prot, datë 19.10.2020 KPP ka vendosur të kalojë për shqyrtim në themel ankesën e bërë nga K SHPK.
Me shkresën nr. 4427 prot, datë 21.10.2020 Bashkia Sarandë ka depozituar pranë KPP informacion shtesë lidhur me skualifikimin e K SHPK duke vënë në dispozicion të këtij komisioni shkresën e ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë në të cilën vërteton që ambienti i marrë me qera për mirëmbajtjen e mjeteve dhe kontenierëve për gjithë afatin e kontratës nuk ndodhet në territorin e Bashkisë Sarandë por asaj Konispol.
Me vendimin nr. 506/2020 **KPP ka vendosur të mos pranoj ankesën e paraqitur** nga OE K SHPK duke urdhëruar AK të vijoj me hapat e mëtejshëm si dhe ka vendosur ti kërkojë Agjencise së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ lidhur me publikimin e disa të dhënave konfidenciale mbi disponimin e kapaciteteve teknike të konkurentëve.
Me shkresën e APP Kthim Përgjigje nr. 7230/3 prot, datë 16.12.2020 **drejtuar KPP** dhe Bashkisë Sarandë sqaron se, <u>KPP nuk ka cilësuar nëse dokumentacioni i operatorit ekonomik A Construcion është dhënë në rrugë zyrtare nga AK</u>.

-Ky pretendim i APP në vlerësimin tonë_nuk qëndron pasi, në faqen 2 të shkresës të përcjell citohet qartë shkresa nr. 4988/1 prot datë 04.12.2020 ku spjegohet që, AK informon se nuk ka bërë pubike dhe nuk ka vendosur në dispozicion të OE K SHPK informacionin/dokumentacionin e OE A Construcion. Pra ky proces është mbyllur adminstrativisht në mënyrë të padrejtë.
Theksojmë se procedura e pastrimit të qytetit është një procedurë **e ri-nisur** pas një procedure të mëparshme të anulluar me vendim të KPP nr. 176/2/2020 në të cilën vec të tjerave në pikën 5 të tij përcaktohej se APP duhet të niste hetimin administrativ për konstatimet e lidhur me disa të dhëna konfidenciale të cilat gjendeshin vetëm në sistemin elektronik të prokurimeve por të cilat janë disponuar nga OE K SHPK si dhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin adminsitrativ nr. 186 prot dtë 14.02.2020 si dhe sipas pikës 6 të tij një kopje e vendimit ti dërgohet APP. Me shkresën Kthim Përgjigje nr. 3237/7 prot, datë 03.09.2020 APP i ka kthyer përgjigje KPP dhe Bashkisë Sarandë ku megjithëse trajton se AK zyrtarisht nuk ka vënë në dispozicion të këtij subjekti informacione mbi OE të cilit i janë shfrytëzuar të dhënat konfidenciale nga ana tjetër trajton se KPP në vendim nuk ka cilësuar nëse dokumentacioni i OE është dhënë në rrugë zyrtare nga AK. Edhe në këtë rast APP rezulton të ketë arkivuar çështjen duke mos u thelluar por duke u justifikuar pas paragrafëve. Është vet APP e cila me shkresën nr. 3237/5 prot datë 20.07.2020 ka kërkuar informacion nga Bashkia Sarandë mbi publikimin e të dhënave konfidenciale dhe kjo e fundit me shkresën nr. 2943/1 prot, datë 22.07.2020 ka deklaruar zyrtarisht se nuk ka vënë në dispozicion këtë dokumentacion, **pra mungesa e qëndrimit të AK lidhur me disponueshmërinë ngritur nga APP nuk qëndron.**

-Pra shihet qartë që mungesa e veprimeve të mëtejshme nga APP jo vetëm nuk ka arritur të qartësoj rastin konkret por nga mosveprimet problematika është ri-kthyer sërisht në një hark prej disa muajsh nga i njëjti OE për herë të dytë radhazi dhe përsëri **është APP e cila në fund ka arkivuar pa veprim çështjen.**
Mungesa e veprimeve administrative konkrete në kohë dhe me efektivitetin e nevojshëm krijon risk të lartë në zbatimin e rregullave të prokurimit publik lidhur me konfidencialitetin e të dhënave dhe krijimin e një mjedisi konkurrues.
Theksojmë se operatori ankues ka një kontratë efektive shërbimi me institucionin për shërbimin e pastrimit, pas miratimit të shtesës së afatit të kontratës së mëparëshme referuar Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 e cila përfundon në lidhjen e kontratës së re.

Lidhur me procedurën e ndjekur sipër konstatohet se,
Kriteri:
*Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010 jo më pak se **1 (një) copë**.*
Ky kriter sipas specifikimeve teknike do të bëjë të mundur larjen speciale periodike me presion të rrugëve, si shërbim 122 dite ne periudhat e nevojshme në një sipërfaqe prej 199 142 m2 (132 142 m² në Sarandë dhe 30000 m² në Ksamil). Shërbimi i larjes speciale periodike me makineri teknollogjike dhe punëtorë ndihmës, konsiston në: Larjen e të gjithë sipërfaqes së rrugës dhe trotuarit duke përdorur tubin anësor për nxjerrjen e ujit me presion dhe bollshëm me një normë harxhimi të ujit gjatë larjes mesatarisht 3 litra/m2 rrugë.
Referuar të dhënave më sipër për larjen e gjithë sipërfaqes prej 199142 m2 duhen mesatarisht 597,426 litra ujë. Kjo sasi e konsiderueshme uji është e pamundur të aplikohet me një bot të vetëm, ndërkohë që në specifikime nuk është vendosur as kapaciteti mbajtës në volum/peshë i botit ça nuk garanton mbulimin me këtë kriter të shërbimit të prokuruar.

Kriteri:
Te mos figuroje (-jne ne rast bashkimi OE) debitor ne institucionin e Bashkise Sarande. Kjo eshte e vlefshme me nje vetedeklarime nga OE pjesemarese,
Referuar rekomandimeve të APP drejtuar AK, me shkresën nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018, për aq kohë sa ky informacion zotërohet nga institucioni ky kriter nuk ishte i nevojshëm të vendosej.
Marrja në dorëzim e shërbimit të pastrimit:
Kontrata e mëparshme e pastrimit ka përfunduar më datë 13.03.2020. Për shkak të situatës së pandemisë Covid-19 OE dhe në vijim të Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 Bashkia Sarandë ka kaluar në Këshillin Bashkiak miratimin e amendimit të kontratës për këtë shërbim me afat deri në lidhjen e kontratës së re, miratuar me Vendimin nr. 21 datë 26.03.2020. Vendimi është aprovuar edhe nga Prefektura me shkresën nr. 363/1 prot, datë 30.03.2020.
Në dokumentacionet justifikuese për marrjen e shërbimit të cilat i bashkëlidhen pagesave të kryera nga Bashkia Sarandë për periudhën 01.07.2019-31.12.2020 rezulton vetëm raporti teknik i cili shoqëron faturën tatimore të lëshuar nga OE por nuk gjenden raportet ditore mbi marrjen e shërbimit të cilat shoqërojnë këto pagesa të cilat janë të nevojshme për garantimin e përmbushjes së shërbimit të kontraktimit, zbatimin e grafikut të punimeve dhe proceseve të punës nga ana e OE, anagazhimin e stafit dhe mjeteve të parashikuara, etj.
Gjithashtu, për ditët ku shërbimi nuk kryhet si rrjedhojë e kushteve atmosferike me shira apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryej shërbimin dhe rrjedhimisht nuk do të paguhet por për ky fakt duhet të evidentohej me procesverbal.
Pra marrja në dorëzim e këtij shërbimi mjaft sensistiv nuk është vetëm një akt-konfirmimi i zakonshëm por një proces i përditshëm verifikimi dhe raportimi i shërbimit të kryer nga operatori, kjo për të garantuar, cilësinë e kërkuar të shërbimit, efektivitetin e vlerat financiare të shpenzuara, në dobi të komunitetit vendas, çka mungon në rastin konkret.

REF-40839-10-24-2019 Kërkesë për propozim

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : *"Instalim kamerave te sigurise ne qytet"*		
1. Urdhër Prokurimi Nr.22 datë 11.10.2019	**3. Njësia e prokurimit** Nr.22 datë 11.10.2019 1. E 2. R 3. L	**4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Nr.22/1 datë 11.10.2019 1. E 2. J 3. K
2. Lloji i Procedurës "Kërkesë për propozimò		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 11,049,999 lekë	**6. Oferta fituese (pa TVSh)** **OE "E " SHPK** me ofertë 10,909,909 lekë pa TVSH, me kontratë, me afat 40 ditë kalendarike.	**7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)** **140,090** lekë ose **1.2 %**
8. Data e hapjes së tenderit Datë 06.11.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i i Shtetit	**10. Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **1** OE/BOE b) Skualifikuar **0** OE/BOE, c) Kualifikuar **1** OE/BOE
11. Ankimime **AK**: Sôka **KPP:** Sôka **APP:** Sôka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Sôka	**13. Përgjigje** Sôka

Autoriteti kontraktor i ka drejtuar kërkesë 5 OE.
Në këtë procedurë konstatohet se, artikujt nga 17 deri 19 dhe 21-22, të preventivit nuk gjenden në specifikimet teknike mbi mallrat dhe shërbimin e kërkuar. Preventivi ka të përfshira 60 licenca për kamerat në vlerën 342,000 (Nr. 19) ndërkohë që kamerat nuk paraqesin nevojë për licencim të posaçëm. Po kështu evidentohet se shërbimi i lidhjes në rrjet për 1 vit (nr. 21) përkatësisht 17 lidhje të tilla në vlerën 2,584,000 lekë nuk duhet të ishte pjesë e kësaj procedure në afatgjatë pasi lidhja e rrjetit nëpërmjet internetit mund të ishte i nevojshëm vetëm në fazën e testimit por jo më

tej pasi ky shërbim nuk lidhet me investimin por është një shërbim i cili do të prokurohet i ndarë në vijimësi. Në zërin ñMirëmbajtje e kamerave dhe sistemit për një vitò, vlera për 60 kamera është llogaritur 1,849,980 lekë, ku cmimi për njësi është parashikuar 30,833 lekë ndërkohë që blerja e një nga 44 kamerat B 8MPX është 34,852 lekë pra thuajse sa vlera e mirëmbajtjes për një vit ku kamerat janë prokuruar me një garanci 2 vjecare. Për këto kamera norma efektive e shpenzimit llogaritet rreth 88% e cmimit të blerjes, vlerë e cila është disa herë më e lartë edhe se amortizimi vjetor i pranuar për pajisjet informatike.
Disa nga zërat e përmendur më sipër të cilët kanë qenë të papërshkruar qartë mund të kenë patur ndikim në mungesën e ofertuesve në këtë procedurë.

-Evidentohet se Bashkia Sarandë në prokurimet e zhvilluara ka përdorur gjerësisht procedurën ñKërkesë për propozimò e cila ka rezultuar në mjaft raste me vetëm një ofertues, dhe nuk garantuar një pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomik.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Procedurat e prokurimit sa i përket kryesisht për vendosjen e kritereve të vecanta paraqitet me të meta dhe mangësi.

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimin nr. 13 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1667/6 prot, datë 16.04.2021 me përfaqësuesit e institucionit, R S shpk, K A , R H , R H , E L , A P)

Titulli i gjetjes nr. 1	**Përllogaritje e gabuar e fondit limit në procedurën *"Rikonstruksion i ujesjellesit Ksamil (Depo+Rrjeti shperndares-lagja nr.3 dhe nr.4", viti 2020"***
Situata:	Me urdhrin e prokurimit nr. 24 datë 12.10.2020, protokoll ska, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka përcaktuar një shoqëri private R S shpk për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë objekt. Kjo shoqëri ka hartuar projektin përkatës të këtij investimi i cili është përcjell nga Ujësjellës Kanalizimet SHA, Sarandë me shkresën nr. 396/4 prot, datë 16.09.2020. Baza ligjore e përdorur në urdhër është VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për pokurimin publikò, i ndryshuar, neni 59 dhe 61 pika 2 e tij. Nga ana e R S shpk nuk është hartuar një procesverbal apo akt të mbajtur i cili të përcaktojë fondin limit por në dosje gjendet vetëm një preventiv zbatimi punimesh i ndërtuar bazuar në manualin e punimeve të ndërtimit/2015 me një vlerë Fondi Limit 131,206,085 lekë. Nëse do ti referohemi relacionit teknik të paraqitur nga R S shpk, (në faqen e tij të parë i referohet vitit 2018 ndërsa firma dixhitale në fund të materialit mban datën 13.10.2020), në të përshkruhen llogaritjet e volumeve të projektit të cilat janë dukshëm më të vogla se preventivi i hartuar. Nga ana jonë u evidentua ndryshimi në volume lidhur me Zërin **Gërmime** i cili në relacion paraqitet 8,553.5 m3 (7,553.5+1,000) nga të cilat 1,000 m3 paraqitet volumi i depos së ujit, ndërsa në preventiv ky zë punimi paraqitet 11,032 m3 ose 2,478.5 m3 në vlerën **2,974,200 lekë pa tvsh.** Zëri **Mbushje me material të gërmuar** paraqitet në relacionin teknik në volumin 5,257.3 m3 ndërsa në preventiv paraqitet 12,230 m3 ose 6,972.7 m3 më tepër **ose në vlerën 3,486,350 lekë pa tvsh.**
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar
Ndikimi/Efekti:	Efekt financiar negativ në dëm të bxhetit të NJQV në shumën 6,460,550 Lekë

Shkaku:	-Mosllogaritje e saktë e fondit limit.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 2	**Parregullsi në procedurat e prokurimit të ndjekura nga institucioni.**
Situata:	**1.** Institucioni ka hartuar regjistrat e parashikimit në sistemin elektronik të APP të cilët janë publikuar prej saj. Konsatohet se, regjistrat e parashikimit nuk janë dërguar pranë degës së thesarit në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për pokurimin publikò, i ndryshuar, nenit 5 pikat 1 dhe 4 të saj, ñRegjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publikòNë procedurate prokurimit të audituara dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar teknikisht dhe ligjërisht vendosjen e çdo kriteri. **2.** Nga auditimi evidentohen parregullsi në vendosjen e kritereve për tu përmbushur individualisht nga çdo OE pjesë e BOE, përcaktimi i stafit me afat të përcaktuar punësimi pa u fokusuar tek vjetërsia në punë, vendosjen si kriter e dëshmive profesionale të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, vërtetimet mbi detyrimet nga Bashkia Sarandë, etj, të cilat e kanë kufizuar garën midis OE dhe nuk kanë siguruar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në këto procedura.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 46 pika 3; -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26 pika 5, neni 61 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Kufizim i pjesëmarrjes dhe mos stimulim i pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.
Shkaku:	-Mangësi në procedurat e ndjekura.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 3	**Parregullsi në marrjen në dorëzim të shërbimeve *"Pastrimi i qytetit dhe largimi i mbetjeve".***
Situata:	Nga auditimi mbi marrjen e shërbimit të pastrimit të qytetit rezultoi se, kontrata e mëparshme e pastrimit ka përfunduar më datë 13.03.2020. Për shkak të situatës së pandemisë Covid-19 OE dhe në vijim të Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 Bashkia Sarandë ka kaluar në Këshillin Bashkiak miratimin e amendimit të kontratës për këtë shërbim me afat deri në lidhjen e kontratës së re, miratuar me Vendimin nr. 21 datë 26.03.2020. Vendimi është aprovuar edhe nga Prefektura me shkresën nr. 363/1 prot, datë 30.03.2020. Në dokumentacionet justifikuese për marrjen e shërbimit të cilat i bashkëlidhen pagesave të kryera nga Bashkia Sarandë për periudhën 01.07.2019-31.12.2020 rezulton vetëm raporti teknik i cili shoqëron faturën tatimore të lëshuar nga OE por nuk gjenden raportet ditore mbi marrjen e shërbimit të cilat shoqërojnë këto pagesa të cilat janë të nevojshme për garantimin e përmbushjes së shërbimit të kontraktimit, zbatimin e grafikut të punimeve dhe proceseve të punës nga ana e OE, anagazhimin e stafit dhe mjeteve të parashikuara, etj. Gjithashtu, për ditët ku shërbimi nuk kryhet si rrjedhojë e kushteve atmosferike me shira apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryej shërbimin dhe rrjedhimisht nuk do të paguhet por për ky fakt duhet të evidentohejnë çdo rast me

	procesverbal. Pra marrja në dorëzim e këtij shërbimi mjaft sensistiv nuk është vetëm një akt-konfirmimi i zakonshëm por një proces i përditshëm verifikimi dhe raportimi i shërbimit të kryer nga operatori, kjo për të garantuar, cilësinë e kërkuar të shërbimit, efektivitetin e vlerat financiare të shpenzuara, në dobi të komunitetit vendas, çka mungon në rastin konkret.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, ; -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar. -Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik..
Ndikimi/Efekti:	Risk për pagesa shërbimi të pakryer.
Shkaku:	-Mangësi në marrjen në dorëzim të shërbimit.
Rëndësia:	E lartë

Titulli i gjetjes nr. 4	**Parregullsi në marrjen në në procedurën e prokurimit *"Instalim kamerave te sigurise ne qytet".***
Situata:	Në këtë procedurë konstatohet se, artikujt nga 17 deri 19 dhe 21-22, të preventivit nuk gjenden në specifikimet teknike mbi mallrat dhe shërbimin e kërkuar. Preventivi ka të përfshira 60 licenca për kamerat në vlerën **342,000 lekë** (Nr. 19) ndërkohë që kamerat nuk paraqesin nevojë për licencim të posaçëm. Po kështu evidentohet se shërbimi i lidhjes në rrjet për 1 vit (nr. 21) përkatësisht 17 lidhje të tilla në vlerën **2,584,000 lekë** nuk duhet të ishte pjesë e kësaj procedure në afatgjatë pasi lidhja e rrjetit nëpërmjet internetit mund të ishte i nevojshëm vetëm në fazën e testimit por jo më tej pasi ky shërbim nuk lidhet me investimin por është një shërbim i cili do të prokurohet i ndarë në vijimësi. Në zërin ñMirëmbajtje e kamerave dhe sistemit për një vitò, vlera për 60 kamera është llogaritur **1,849,980 lekë**, ku cmimi për njësi është parashikuar 30,833 lekë ndërkohë që blerja e një nga 44 kamerat B 8MPX është 34,852 lekë pra thuajse sa vlera e mirëmbajtjes për një vit ku kamerat janë prokuruar me një garanci 2 vjecare. Për këto kamera norma efektive e shpenzimit llogaritet rreth 88% e cmimit të blerjes, vlerë e cila është disa herë më e lartë edhe se amortizimi vjetor i pranuar për pajisjet informatike. Disa nga zërat e përmendur më sipër të cilët kanë qenë të papërshkruar qartë mund të kenë patur ndikim në mungesën e ofertuesve në këtë procedurë.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, ; -VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar. -Kontrata e lidhur me operatorin ekonomik..
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në hartimin e fondit limit në shumën **4,775,980 lekë** dhe kufizim i pjesëmarrjes dhe mos stimulim i pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm**.**
Shkaku:	-Mangësi në procedurat e ndjekura.
Rëndësia:	E lartë

-Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.
Në zbatim të pikës 6.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Sarandë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 2019-2020. Për periudhën e auditimit, janë realizuar **34** investime publike në vlerën **355,356,713.6 lekë pa TVSH ose 426,428,056.4 lekë me TVSH**, respektivisht:

- **Për vitin 2019**: Janë realizuar 11 investime për punë publike në vlerën **65,155,631 lekë pa TVSH ose 78,186,757 lekë me TVSH.**
- **Për vitin 2020**: Janë realizuar 23 investime për punë publike në vlerën **290,201,083 lekë pa TVSH ose 348,241,299.40 lekë me TVSH,** nga këto 4 kontrata për punë publike në vlerën **153,829,580 lekë pa TVSH ose 184,595,496 lekë me TVSH,** rezulton të jenë kontrata në proces për vitin 2021 të cilat nuk u planifikuan për auditim, pasi realizimi i punimeve të ndërtimit është në përqindje të vogël.

Nga analiza e bërë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve të realizuara 100 %, të cilat janë kërkuar për tâu audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të lartë në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqituara në tabelë (2019+2020): Më gjerësisht mbi kontratat për punë publike të realizuara për periudhën e auditimit paraqiten **Aneksin Nr. 2.4.4**. Zbatimi i kontratave për punë publike, Tabela nr. 2.4.1 dhe tabela nr. 2.4.4.2:

Për periudhën e auditimit 2019 + 2020, u audituan **4 (dhjetë)** objekte të prokuruara (tabela nr. 3), në vlerën totale **42,915,916 lekë pa TVSH ose 51,499,099 lekë me TVSH,** respektivisht**:**

- **Për vitin 2019**: U audituan 3 (tre) investime/kontrata për punë publike në vlerën **16,540,891.20 lekë me TVSH.**
- **Për vitin 2020**: U auditua1(një) kontratë për punë në vlerën **14,125,728 lekë me TVSH.**

Tabela nr. 4.4.1. Kontrata për punë publike të audituara nga KLSH

Nr	Objekti prokuruar	Fondi limit pa TVSH në leke	Kontrata me OE fitues		Operatori fitues	Vlera e plote sipas kontrates	Real i kontratës
			Nr/ datë	Vlera pa TVSH në lekë			
Kontrata të zbatuara për 2019							
1	Rehabilitim rrugesh dhe rikualifikim pjesor rrugesh ne Sarande dhe Ksamil	5,557,550	01.07.2019	5,557,550	**A SHPK**	6,669,060	100%
2	Investime ne kende lojrash dhe sistemime me beton ne lagjet 1,2,3,4	11,802,850	10.06.2019	11,802,850	**M**	14,163,420	100%
3	Shtrim me beton rruga Baba sherif, i.Qemali, Adria dhe rruge te brendshme	13,784,076	10.06.2020	13,784,076	**E**	16,540,891.2	100%
							Procedurat e vitit 2020
1	ñRiparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bank - Kopështi -Kështjella Ksamilò	12,000,000	06.07.2020	11,771,440	**E**	14,125,728.0	100%
4	**Shuma**	**43,144,476**		**42,915,916**		**51,499,099**	

Nga auditimi i dosjeve teknike si dhe auditimit në objekte mbi verifikimin e punimeve të ndërtimit për zërat e punëve të realizuara, në vijim, po paraqesim mangësitë si vijon:

1. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **"Rehabilitim rrugësh dhe rikualifikim pjesor me asfalt në Sarandë dhe Ksamilò, me të dhënat si vijon:**

Të dhëna për :			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Kontratë Nr. 10 Prot, datë 01.07.2019	Afati zbatimit të kontratës 30 ditë	kontrata nr. 10/1 prot, datë 01.07.2019	kontrata nr.10/2 prot, datë 01.07.2019
Vlera e kontratës 6,429,060 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve - 12 muaj	Mbikëqyrësi ñPFò me licence nr. MK. 2928/1 z. K K	ñPFò Z. A K , me licence nr. MK. 1011
Financimi i bashkisë Sarandë	Punimet kanë filluar me datë 01.07.2019	vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 25,000 lekë pa TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është 10,000 lekë pa TVSH.
Kontraktori ñA ò shpk me administrator Z. A P	Punimet kanë përfunduar, brenda afatit të kontratës më 30.07.2019		

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñRehabilitim rrugësh dhe rikualifikim pjesor me asfalt në Sarandë dhe Ksamilò Bashkia Sarandë, me vlerë 6,429,060 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñA ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve ñSpërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2ò në Rrugët ñTeutaò; ñSelim Islami, lagjia nr. 4, Sarandëò; ñIsadora Dunkan, Ksamilò, në vlerën **417,600 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10 prot datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe sipërmarrësit ñ A ò SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I	**Rruga Teuta**							
2	Spërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2.	m^2	160	330	330	-	330	52,800
II	**Rruga Selim Islami. lagjia nr. 4, Sarandë**							
2	Spërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2.	m^2	160	180	180	-	180	28,800
III	**Rruga Isadora Dunkan, Ksamil**							
2	Spërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2.	m^2	160	1200	1200	-	1200	192,000
IV	**Mbushje gropash në Ksamil dhe Sarandë**							
2	Spërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2.	m^2	160	900	900	-	900	144,000
	Totali ne lekë pa TVSH							**417,600**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe

kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 10 prot, datë 01.07.2019.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve dhe autoritetit kontraktor në verifikimin e ndryshimit të projekt- preventivit. Vlera prej **417,600 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia : **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. K K , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 02, datë 02.04.2021, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Sarandë)

2. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **"*Investime në lagjet e qytetit, kënde lojrash, rrugë betoni, sistemim ndriçimi lagjia nr. 1,2,3,4 dhe periferia Sarandë*ò, me të dhënat si vijon:**

Të dhëna për :			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Kontratë Nr. 5 Prot, datë 10.06.2019	Afati zbatimit të kontratës 40 ditë	Kontrata nr. 5/1prot, datë 10.06.2019	Kontrata nr.5/2 prot, datë 10.06.2019
Vlera e kontratës 14,163,420 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve - 12 muaj	**Mbikëqyrësi** ñPFò me licence nr. MK. 0453/3 z. K K	ñPFò Z. A K , me licence nr. MK. 1011
Financimi i bashkisë Sarandë	Punimet kanë filluar me datë 26.11.2019	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 25,000 lekë pa TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është 40,000 lekë pa TVSH.
Kontraktori BOE ñM ò shpk & ñB ò SHPK me administrator Z. M M	Punimet kanë përfunduar, më 17.06.2020 pas një shtese të afatit të përfundimit të punimeve		

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Investime në lagjet e qytetit, kënde lojrash, rrugë betoni, sistemim ndriçimi lagjia nr. 1,2,3,4 dhe periferia Sarandë*ò Bashkia Sarandë, me vlerë 14,163,420 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm të shoqërive ñM ò SHPK & ñB ò SHPK, përfaqësuar nga shoqëria ñM ò SHPK me administrator Z. M M , rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve ñF.V Hekur betoni periodik Ø 4 mm.ò, në vlerën **455,850 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe BPSH ñM ò SHPK & ñB ò SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Preventivi bazë	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Betonim dhe mure mbajtës rruga e Teqesë lagjia B. Rexhepi							
Zëri 4	F.V Hekur betoni periodik Ø 4 mm.	ton	90,000	9	9	3.934	5.065	455,850

(An)								
	Totali në lekë pa TVSH							**455,850**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 5 prot, datë 10.06.2019; Kontratën e mbikëqyrjes me nr. 5/1 prot, datë 10.06.2019.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve dhe autoritetit kontraktor në verifikimin e ndryshimit të projekt- preventivit. Vlera prej **455,850 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia : **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. K K , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.
(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 03, datë 02.04.2021, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Sarandë)

3. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **"*Riparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bank kopështi – Kështjella Ksamil*ò, me të dhënat si vijon:**

Të dhëna për :			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Kontratë Nr. 9 Prot, datë 06.07.2020	Afati zbatimit të kontratës 30 ditë	Kontrata nr. 9/1prot, datë 06.07.2020	Kontrata nr.9/2 prot, datë 06.07.2020
Vlera e kontratës 14,163,420 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve - 12 muaj	Mbikëqyrësi ñPFò me licence nr. MK. 1011/1 z. A K	ñPFò Z. K K , me licence nr. MK. 0453
Financimi i bashkisë Sarandë	Punimet kanë filluar me datë 08.07.2020	vlera e kontratës së mbikëqyrjes është -- lekë pa TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është -- lekë pa TVSH.
Kontraktori ñE ò SHPK me administrator Z.B M .	Punimet kanë përfunduar, më 30.07.2020 brenda afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës		

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Riparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bank kopështi – Kështjella Ksamil*ò Bashkia Sarandë, me vlerë 14,125,728 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve ñE ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve ñShtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 1-1^2-2^5-5; Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 19-19^20-20 S-1; Skarifikim shtresë asfalti me makineri. Rr. Kështjellë-Pemë e thatë. Seksioni 1-1^2-2^5-5; Skarifikim shtresë asfalti me makineri. Seksioni 19-19^20-20ò, në vlerën **509,625 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9 prot datë

06.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe sipërmarrësit ñE ò SHPK.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Sit përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
3.225/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. **Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 1-1^2-2^5-5**	M2	1200	546	546 (2*50*5.46)	273 (1*50*5.46)	273	327,600
3.225/1	Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. **Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 19-19^20-20 S-1**	M2	1,200	194.75	194.75 (20.5*9.5)	90.25 (9.5*9.5)	104.5	125,400
An	Skarifikim shtresë asfalti me makineri. **Rr. Kështjellë-Pemë e thatë. Seksioni 1-1^2-2^5-5**	M2	150	546	546 (2*50*5.46)	273 (1*50*5.46)	273	40,950
An	Skarifikim shtresë asfalti me makineri. **Seksioni 19-19^20-20**	M2	150	194.75	194.75 (20.5*9.5)	90.25 (9.5*9.5)	104.5	15,675
	Totali në lekë pa TVSH				**253,640**			**509,625**

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 9 prot, datë 06.07.2020; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 9/1 prot, datë 06.07.2020.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve dhe autoritetit kontraktor në verifikimin e ndryshimit të projekt- preventivit. Vlera prej **509,625 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia : **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. A L , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të zbatimit të punimeve, janë trajtuar në akt-konstatimi nr. 04, datë 02.04.2021, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Sarandë)

4. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **"*Shtrim me beton rruga "Baba Sherifi", rruga "Ismail Qemali", rruga "Ibrahim Rrugova", rruga "Adria" dhe rrugë të brendëshme*ò, me të dhënat si vijon:**

Të dhëna për :			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Kontratë Nr. 4 Prot, datë 10.06.2019	Afati zbatimit të kontratës 40 ditë	kontrata nr. 4/1prot, datë 10.06.2019	kontrata nr.4/2 prot, datë 10.06.2019
Vlera e kontratës 16,540,788 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve - 12 muaj	**Mbikëqyrësi** ñPFò me licence nr. MK. 0453 z. K K	ñPFò Z. A K , me licence nr. MK. 0453
Financimi i bashkisë Sarandë	Punimet kanë filluar me datë 22.11.2019	vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 25,000 lekë pa TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është 15,000 lekë pa TVSH.
Kontraktori ñE ò shpk me administrator Z. A I	Punimet kanë përfunduar, më 29.12.2019 brenda afatit të përfundimit të punimeve sipas kontratës		

Nga auditimi mbi realizimin e punimeve, u konstatua:

1. Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin ñShtrim me beton rruga ñBaba Sherifiò, rruga ñIsmail Qemaliò, rruga ñIbrahim Rrugovaò, rruga ñAdriaò dhe rrugë të brendshmeò në datën 04.03.2021 në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve Ing. K K , lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezulton se:

- Nuk ka shmangie nga projekti i zbatimit i ripunuar, në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë përsa i përket zbatimit të paketës së trupit të rrugës dhe paketës së bankinës së rrugës
- Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuara në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Sarandë.

2. Nga auditimi i situacioneve pjesore dhe përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe të ndryshuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në datën 04.03.2021 në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve Ing. K K , lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Punime të kryera dhe të situacionuara rezultojnë në shumën 16,540,788 lekë me TVSH ose në masën 100 % dhe janë realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Nga auditimi në rrugën ñIbrahim Rrugovaò u konstatua se po bëhen ndërhyrje për zbatimin e projektit të ujësjellësit nga sipërmarrësi shoqëria ñC ò SHPK dhe për pasojë rruga ka pësuar dëmtime nga hapja e kanalit për vendosjen e tubacionit të ujit. Dëmtimet vërehen kryesisht në bankinën e djathtë të rrugës si dhe në disa segmente ndërhyrja është bërë në trupin e rrugës, dukë dëmtuar shtresën e betonit t=12 cm dhe zgarën e hekurit me Ø 4 mm. Dëmtimet duken qartë në fotografitë bashkëngjitur akt verifikimi nr. 2 në aneksin 1 (Fotografi nga faqe 5 deri 7).

4. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me: (Kontrata e sipërmarrjes me nr. 4 prot, datë 10.06.2019 ñ*Shtrim me beton rruga "Baba Sherifi", rruga "Ismail Qemali", rruga "Ibrahim Rrugova", rruga "Adria" dhe rrugë të brendshme"* Sarandë; Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve me 10.06.2019; VKM nr. 354, datë 11.05.2016 ñPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò, i ndryshuar dhe UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar).

(Gjerësisht trajtuar në akt-verifikimin nr. 02, datë 02.04.2021, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Sarandë)

6. "Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9643 datë 20.11.2016 "për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" të ndryshuar" – Blerjet e vogla

Titulli i gjetjes nr. 1: **Moszbatimi i akteve ligjore e nenligjore në drejtim të zbatimit të procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël**

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit me blerje me vlerë të vogël, sa më poshtë vijon:

Objekti i Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës
Materiale Kancelarie	666,667	420,000
Shpenzime mirëmbajtje mjetesh për ujitjen dhe kullimin	800,000	745,300
Shpenzime per blerje dizinfektantesh per kopshtet dhe shkollat	800,000	650,000
Materjale per fuksionimin e pajisjeve te zyrave	700,000	78,800
Riparim mjeti tip eskavator me goma	800,000	750,000

Rezultuan mangësi sa vijon:

- Kërkesa për materiale është bërë nga magazinieria znj.S F , pasi ajo ka marrë kërkesat nga zyrat përkatëse.Theksojmë se bazuar në detyrat e përcaktuara sipas rregullores se brendeshme te funksionit të kësaj Bashkie të miratuar me VKB nr. 34 datë 05.06.2008, **nuk është detyrë e magazinieres të hartojë kërkesat për materiale apo të hartojë përmbledhësen e kërkesave nga zyrat përkatëse**. Gjithashtu ky veprim është ***në kundërshtim edhe me përcaktimet e UMF nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", në përgjithësi.***
- Mos caktimi i një personi apo strukture të posaçme, **në të cilin të ngarkohet dhe kërkohet pregatitja e kërkesave** bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, Neni 40, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, pika 4, ku është përcaktuar se: ñKur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre, **ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK i cili nuk ka nxjerrë urdhër në të cilin të ngarkohet dhe kërkohet pregatitja e kërkesave,** është në kundërshtim me pikën 35.a dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, nenin 6, germa (e) dalë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò .
- Jo në të gjitha rastet e audituara është vepruar sipas VKM nr. **914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, n**eni 40, ku është përcaktuar se: **"Procedura e prokurimit me vlerë të vogël", në pikën 2 të tij është përcaktuar se:** ñNë rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik», pasi në tre prej tyre janë ftuar vetëm 2- 3

nga 5 OE të kërkuar.

- Në ftesën për ofertë objekti i prokurimit është sa vijon: **"Shpenzime mirëmbajtje mjetesh për ujitjen dhe kullimin", duke mos përcaktuar llojin e mjetit/eve** dhe sa mjete të bordit janë për tu mirëmbajtur. Mos përcaktimi i llojit të mjeteve, është në kundërshtim me nenin 40, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, pika 1, ku është përcaktuar se: ñAutoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përllogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor **planifikon natyrën, sasitë** dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Gjithashtu për këtë procedurë **rezulton se nuk ka akt konsatim /kerkesë nga personat përgjegjës për kryerjen e shërbimit.**
- Në procedurën bvv me objekt ñShpenzime për blerje dizinfektantesh për kopshtet dhe shkollatò me fond limit 800,000 lekë, në specifikimet teknike në fotot e vendosura në ftesën për ofertë, rezulton markë e vendosur në kundërshtim me nenin 23 ñSpecifikimet teknikeò, të LPP.
- **Në procedurën bvv "Riparim mjeti tip eskavator me goma", me fond limit 800,000 lekë** mungon Proces Verbali per perllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. **914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,** 40, **"Procedura e prokurimit me vlerë të vogël"**. Në lidhje me realizimin e këtij shërbimi rezulton se nuk ka urdhër ngritje grupi për akt marrje në dorëzim si dhe nuk ka akt marrje në dorëzim , veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, ñMarrja në dorëzim e aktiveve të furnizuaraò. Mos nxjerrja e urdhrave është në kundërshtim me pikën 35.a dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, nenin 6, germa (e) dalë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò

Kriteri: VKB nr. 34 datë 05.06.2008 VKB nr. 34 datë 05.06.2008;
VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar
Udhëzimi i Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò
LPP

Impakti: Kryerja e procedurave bvv jo sipas procedurave te caktuara për këtë qëllim

Shkaku: Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjoreò

Rëndësia: **E lartë**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Nëpunësi zbatues dhe autorizues, përkatësisht Drejtoresha e Zhvillimit Financiar dhe Kujdesit Social znj. T S . dhe Kryetarin e Bashkisë z. A G si dhe anëtarët e komisionit z. R H , zj. L H dhe znj. E S .

- **Drejtimi 7:** ***Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.***

Objekti i këtij akt verifikimi është:
Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna (statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre), nga auditimet e mëparshme, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standarteve të auditimit.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit*ò, ñ*Rregulloren e Procedurave të Auditimit*ò miratuar me Vendimin nr. 107 datë 08.08.2017 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016*"Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës,në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò.

Nga verifikimi rezultoi që:
Auditimi i mëparshëm në subjektin ñBashkia Sarandëò është kryer sipas programit të auditimit nr. 365/1 datë 28.05.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2019. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 365/7 prot. datë 27.09.2019.
-Në vijim, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna pranë ñBashkisë Sarandëò, është kryer me auditimin tematik të KLSH-^{së}, referuar programit të auditimit nr. 610 prot, datë 25.06.2020 me objekt *"Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna , të avaduara në periudhën 23.09.2019-31.12.2019"*, autorizimit për Bashkinë Sarandë nr. 610/2 prot, datë 26.06.2020. Në vijim është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-^{së} nr. 128 datë 24.11.2020 dhe konkluzionet përkatëse janë përcjell subjektit të audituar me shkresën nr. 610/65 prot. datë 04.12.2020, ku është ri-kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve e gjetura me status i pazbatuar apo në proces zbatimi. Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna dhe shkresa përcjellëse, janë administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 5229 prot datë 07.12.2020.

-Bashkia Sarandë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 5229/1 prot, datë 24.12.2020 e cila është dorëzuar në shërbimin postar më datë 31.12.2020, e rrjedhimisht përgjigja është kryer ***në tejkalim të afatit 20 ditor të parashikuar*** nga neni 15, shkronja ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë:

a. *Janë rekomanduar* ***15****(pesëmbëdhjetë)* ***masa organizative****, nga të cilat* ***pa zbatuar 10****(dhjetë),* ***në proces zbatimi 4****(katër) dhe* ***zbatuar pjesërisht 1*** *(një) masë.*
b. *Janë rekomanduar* ***13****(trembëdhjetë)* ***masa për shpërblim dëmi****, nga të cilat janë* ***pa zbatuar 13****(trembëdhjetë) masa.*
c. *Janë rekomanduar* ***5****(pesë)* ***masa për uljen e borxhit tatimor****, nga të cilat janë* ***pa zbatuar 5****(pesë) masa.*
d. *Janë rekomanduar* ***4****(katër)* ***masa për elimimin e efekteve negative****, nga të cilat janë* ***zbatuar pjesërisht 4****(katër) masa..*
e. *Janë rekomanduar* ***18****(tetëmbëdhjetë)* ***masa administrative****, nga të cilat janë* ***pa zbatuar 3****(tre),* ***15*** *(pesëmbëdhjetë) masa janë* ***në proces zbatimi.***

f. *Janë rekomanduar **9**(nëntë) **masa disiplinore**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 9**(nëntë) masa.*

g. *Është rekomanduar **1**(një) **masë për njoftimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**, e cila gjendet **e pa zbatuar**.*

-*Konstatohet se*, nga Bashkia Sarandë kanë munguar veprime të mjaftueshme administrative në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të lëna pavarësisht pranimit të tyre dhe angazhimeve institucionale të marra. Rekomandimet e lëna në auditimet e mëparëshme në vijimësi nuk janë zbatuar megjithëse ka kaluar një periudhë prej 4 vitesh nga përcjellja e tyre, ose janë zbatuar në afate tepër të gjata dhe jo në masën e rekomanduar. Mungojnë veprimet konkrete në rastet e kontabilizimit të detyrimeve apo dhe analizat e raportime në Këshillin Bashkiak të raporteve të KLSH. Evidentohet numër i lartë lëvizjesh në disa prej pozicioneve kyçe ku veçojmë emërimet/komandimet e shpeshta të Kryeinspektorit në një hark të shkurtër kohër vetëm disa muaj. Problematikat dhe mangësitë e vërejtura si dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vijimësi nga KLSH, evidentojnë nevojën për rishikimin e mënyrës së qasjes institucionale për shqyrtimin dhe marrjen e masave të përshtatshme për përmbushjen e tyre, paraqitjen e tyre në diskutimet e Këshillit Bashkiak si dhe marrjen e masave të nevojshme për përmbushjen e tyre në afate të shkurtra kohore, me cilësi të lartë vendimmarrëse në kuadër të detyrave të caktuara nga ligjvënësi dhe garantimin e interesit publik.

Më hollësisht ecuria e ndjekjes së rekomandimeve paraqitet në **Aneksin nr. 6** pjesë e këtij materiali auditimi.

Titulli i Gjetjes nr.1:	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nag KLSH në auditimin e mëparshëm.
Situata:	Auditimi i mëparshëm në subjektin ñBashkia Sarandëò është kryer sipas programit të auditimit nr. 365/1 datë 28.05.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2019. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 365/7 prot. datë 27.09.2019. - Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna dhe shkresa përcjellëse, janë administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 5229 prot datë 07.12.2020. -Bashkia Sarandë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 5229/1 prot, datë 24.12.2020 e cila është dorëzuar në shërbimin postar më datë 31.12.2020, e rrjedhimisht përgjigja është kryer ***në tejkalim të afatit 20 ditor të parashikuar*** nga neni 15, shkronja ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë: 1. *Janë rekomanduar **15**(pesëmbëdhjetë) **masa organizative**, nga të cilat **pa zbatuar 10**(dhjetë), **në proces zbatimi 4**(katër) dhe **zbatuar pjesërisht 1** (një) masë.* 2. *Janë rekomanduar **13**(trembëdhjetë) **masa për shpërblim dëmi**, nga të cilat janë **pa zbatuar 13**(trembëdhjetë) masa.* 3. *Janë rekomanduar **5**(pesë) **masa për uljen e borxhit tatimor**, nga të cilat janë **pa zbatuar 5**(pesë) masa.* 4. *Janë rekomanduar **4**(katër) **masa për elimimin e efekteve negative**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 4**(katër) masa..*

	5. *Janë rekomanduar **18**(tetëmbëdhjetë) **masa administrative**, nga të cilat janë **pa zbatuar 3**(tre), **15** (pesëmbëdhjetë) masa janë **në proces zbatimi.*** 6. *Janë rekomanduar **9**(nëntë) **masa disiplinore**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 9**(nëntë) masa.* 7. *Është rekomanduar **1**(një) **masë për njoftimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil**, e cila gjendet **e pa zbatuar**.*
Kriteri:	-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, -ñRregulloren e Procedurave të Auditimitò miratuar me Vendimin nr. 107 datë 08.08.2017 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, e ndryshuar; -Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016*"Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës,në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim negativ në ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike.
Shkaku:	Mosmarrje e masave të nevojshme nga Bashkia Sarandë për zbatimin e tyre.
Rëndësia:	E lartë

(Sa më sipër është mbajtur Akt-Verifikimi nr. 1 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1667 prot, datë 16.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, z. A G , J M , L B , T S , E Br , G D , A K , A D , G i M)

- **Drejtimi 8:** ***Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".***

<u>Titulli i gjetjes nr. 1</u>: Miratimi i lejes së zhvillimit nr.prot.214, datë 05.08.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. 268 datë 19.12.2019 me objekt ñ*Strukturë banimi dhe shërbimi 5 kate me 1 kate parkim të hapur mbi tokë" në kundërshtim me treguesit parametrik.*

Situata: *I/I - Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë dhe afati i pagesës*

Brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, për miratimin e kërkesës për leje ndërtimi, aplikuesi ka ngarkuar në sistem aktet që provojnë pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (mandat pagesa nga banka në vlerën 6,021,120lekë). Pagesa e TNI-së është kryer më 05.12.2019. Pasi është ngakruar në sistem, ka dalë vendimi me nr. 268 datë 19.12.2019 për dhënien e lejes së ndërtimit zhvilluesit ñP 2020ò SHPK, me subjekt ndërtues ñM ò SHPK..

-Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Bazuar në neni 46 të ligjit Nr.28/2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014ñPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, të ndryshuar , ku citohet ñ1.*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*.ò
Pra llogaritja e saj do të bëhet sipas ligjit për sistemin e taksave vendore.

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*òò me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1 e tij citon:
ñ*Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet* ***sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror*** *të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit."*
Nga ana tjetër neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 ñPër disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò citon;
"Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.
Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi*. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.*ò

Llogaritja sipas çmimit të shitjes për metër katror;
Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, bazuar në treguesit e zhvillimit të propozuar, sipërfaqja e ndërtimore mbi tokë arrin 2658 m^2, (215 m^2 kati tip 5 kate për objektin 1 dhe 222 m^2 kati tip 5 kate për objekitn 2 si dhe 1 kat parkim 215 m^2 për parkim për objektin 1 dhe 222 m^2 për object 2).
Vlera e TNI-së llogaritur sipas legjislacionit të sipërpërmendur:
TNI= Cmim shitje/m2 sipas UKM nr.3 date 28.12.2016 x m2 x 4%= x 56,000 x 2658 m^2 x 4%=5,953,920 lekë.
Sipas pagesës së bërë nga zhvilluesi P Shpk në në bankën e nivelit të dytë B , për llogari të Bashkisë Sarandë, vlera ka qenë 6,021,120 lekë, së bashku me tarifat e aplikimit..
Pra nuk konstatohen diferenca në pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

I/II- Dhënia e Lejes së Ndërtimit, krahasimi si dhe zbatimi i treguesve parametrik
Në përfundim të shqyrtimit teknik të dosjes, raportit teknik dhe pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, është marrë vendimi dhe është bërë lajmërimi i aplikuesit për lejen e ndërtimit me nr. 268 datë 19.12.2019 dhe lejen e zhvillimit nr. *214, datë 05.08.2019* në njësinë strukturore SA.UB.8.448 për ñStrukturë banimi dhe shërbimi 5 kate me 1 kate parkim të hapur mbi tokëò, paraqitur nga zhvilluesi ñP 2020ò SHPK dhe ndërtuesi shoqëria " M "SHPK, projektuar nga arkitekti E M , miratuar nga Kryetari i Bashkisë Sarandë z. A G .
Të dhënat e Planvendosjes, Lejes së Zhvillimit dhe Lejes së Ndërtimit me elementët përbërës, të krahasuar me Psaportën e Njësisë Strukturore dhe

Rregullores paraqiten si më poshtë

Tabela 1. Krahasimi i Treguesve Parametrik ndërmjet Projektit të Zbatimit (Planit arkitektonik) dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore

Krahasimi Treguesve ndërmjet Projektit të Zbatimit (Planit arkitektonik) dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore	Sipas Projektit Arkitektonik		Sipas Rregullores dhe Pasaportës së Njësisë Strukturore	
Njësia Strukturore	SA.UB.8.448		SA.UB.8.448	
Nënkategoria	A.Banim		A.3_Zona banimi me përdorim miks	
Sipërfaqja e truallit që zhvillohet	896 m2			
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura (gjurma)	448 m2			
Sipërfaqja totale e ndertimit	2658 m2			
Numri i kateve mbi tokën natyrale	6		6	
Numri i kateve nën tokën natyrale	0		0	
Lartësia e Strukturës	20.5 m		21 m	
Distancat e Strukturës nga trupi i rrugës	4m Objekti 1, 5.4 m Objekti 2		3 m	
Koeficenti i Shfrytëzimit (KSHT)	50%		50%	
Intensiteti (sip totale e ndërtim/sip e truallit)	2.5		2.5	
Treguesit e përdorimit të propozuar				
Distancat e Strukturës nga kufijtë e prones per Objektin 1	V: 0 m	L: 30.4 m	V: kallkan me deklara	L: minimalisht 7 m
	J: 1 m	P: 5.6 m	J: kallkan pa deklarate	P: minimalisht 7 m
Distancat e Strukturës nga kufijtë e prones per Objektin 2	V: 0 m	L: 6.1 m	V: kallkan pa deklarat	L: minimalisht 7 m
	J: 0 m	P: 47.2 m	J: kallkan me deklarat	P: minimalisht 7 m
Nga strukturat e tjera	V: shesh i lire	L: Objekti 1- 23.4 meter nga objekti 5 katwsh; Per objektin 2, eshte objekti 1 ne largesi 10 meter	V: shesh i lire	L: d = nr. k obj.A + nr. k obj.B +2m
	J: shesh i lire	P: per objektin 1 eshte rruga, per objektin 2 eshte objekti 1 ne largesi 10 meter.	J: shesh i lire	P: d = nr. k obj.A + nr. k obj.B +2m
Nga trupi i rrugës	V: --	L: 5. 4 m per objektin 2	V: --	L: 3m
	J: --	P: 4 m per objektin 1	J: --	P: 3m
Nga servitutet publike	V	L	V	L
	J	P	J	P

Në Rregulloren e Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë të miratuar me Vendimit nr.3, datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit ñPër miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë sarandëò si dhe VKB nr.31 datë 24.08.2017, janë përcaktuar njësitë strukturore të qytetit të Sarandës me treguesit parametrik (lartësia maksimale e ndërtimit, numri i kateve, KSHT, KSHP, KSHR, Intesiteti etj) të aplikueshëm në secilën njësi. Në tabelën e mësipërme kemi hedhur të dhënat për në nnjësinë strukturore (pasaporta) SA.UB.8.448 si dhe të dhënat e planvendosjes dhe projektit arkitektonik të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit te Zhvillimit te Territorit si dhe arkitetki E M . Gjithashtu pasi është bërë vlerësimi i plan-vendosjes dhe janë matur distancat në Autocad Map, janë hasur kundërshti ligjore në respektimin distancave. Më konkretisht po i trajtojme më poshtë sipas orientimeve gjeografike

Fig.1. Plani i vendosjes së strukturave për lejen zhvillimi nr. 214, datë 05.08.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. 268 datë 19.12.2019 me objekt "Strukturë banimi dhe shërbimi 5 kate me 1 kate parkim të hapur mbi tokë", distancat nga kufiri i pronës dhe nga strukturat

a) Distanca e gjurmës së ndërtimit nga kufijtë e pronës

Siç mund të shihet dhe në Tabelën 1. të mësipërme, si dhe nga majtjet në programin Autocad MAP 3D të distancës së objektit nga kufiri i pronës, ka rezultuar;

Për Objektin 1 (6 kate me 1 kat parkimi të hapur)

-0 metër distancë nga kufiri verior i saj

- 1 metër nga kufiri jugor i saj

-30.4 metra nga kufiri lindor i saj

- 5.6 metër nga kufiri perëndimor i saj

Për kufirin verior prej zero metër, është bërë një deklaratë noteriale për kallkan nr.2107 rep/1037 kol. me pronarin e pasurisë me nr.18/40, pasuri kjo që e kufizon në anën veriore objektin 1, J M dhe zhvilluesit G P .

Gjithashtu nga zhvilluesi në projekt është lënë 1 metër distancë nga kufiri jugor i objektit 1, pa pasur një deklaratë noteriale për kallkan, bazuar në nenin 34 pika d të VKM Nr.408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*ò, me të gjitha ndryshimet.

Por shihet se nga kufiri perëndimor, distanca është 5.6 metër nga kufiri i pronës.

Distanca minimale sipas nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò me të gjitha ndryshimet dhe neni 46 pika 7 i Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë duhet të ishte : **d= nr. k +1m, përkatësisht**

- *Në perëndim= 6 kate +1 m= 7 metër*

kur ndërkohë kufiri faktik është 5.6 metër (sipas planvendosjes dhe projektit arkitektonik).

Për Objektin 2 (6 kate me 1 kat parkimi të hapur)
-0 metër distancë nga kufiri verior i saj
- 0 metër nga kufiri jugor i saj
- 6.1 metra nga kufiri lindor i saj
- 47.2 metër nga kufiri perëndimor i saj

Për kufirin jugor prej zero metër, është bërë një deklaratë noteriale për kallkan nr.2107 rep/1037 kol. me pronarin e pasurisë me nr.18/7, pasuri kjo që e kufizon në anën jugore objektin 2, B C dhe pronarit të pasurisë 18/401 z. J S i, pasuri kjo e fundit mbi të cilën do të zhvillohet Objekti 2 nga zhvilluesi G P .

Por shihet se nga kufiri verior, distanca është zero metër nga kufiri i pronës, dhe nuk disponohet asnjë deklaratë noteriale për kallkan me pronarët e pasurisë nr.18/398, pasuri kjo që kufizon objektin 2 në veri (referuar fragmentit të hartës treguese të pasurisë nr.18/401 vol.41 fq.221 në pronësi të J S). Në rast se mungon deklarata, atëherë referuar nenit 34 pika 4 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar*, distanca minimale duhet të ishte 1 metër nga kufiri pronës për faqet kallkan. Ndërkohë, ëdhë pse faqe kallkan, distanca e objektit 2 nga kufiri verior i pronës ka qenë zero metër.

Gjithashtu nga planvendosja e miratuar shihet se distanca e objektit nga kufiri lindor i pronës është 6.1 metër, ndërkohë referuar nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñ*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar*, neni 46 pika 7 i Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë duhet të ishte : **d= nr. k +1m= 6+1= 7 metër**.

Pra nuk janë respektuar distancat nga kufijtë e pronës përkatësiht në perëndim për objektin 1 dhe lindje e veri për objektin 2

Veprimet e mësipërme janë bërë në kundërshtim me nenin 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" të ndryshuar* si dhe në kundërshtim me nenin 46 pika 7 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë.

b)Distancat minimale midis ndërtimeve

Nisur dhe nga Fig.1 për sa i përket rrethimit të pronës nga objekte të tjera, si dhe nga matjet në Autocad, janë respektuar distancat minimale të objekteve nga objektet rrethuese. Por ajo që vihet re është mosresppektimi i distancës së objektit 1 dhe 2 ndaj njëri tjetrit.Sipas planvendosjes, distaca është 10 metër. Sipas përcaktimeve të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, neni 34 pika 2 ku citohet : Distanca minimale e lejuar midis dy ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2m, sipas formulës më poshtë:**d = nr. k obj.A + nr. k obj.B +2m**, ku:

d - distanca minimale midis dy ndërtimeve dhe

nr. k - numri i kateve

Sipas llogaritjeve distanca duhej të ishte **d= 6 kate + 6 kate + 2m = 14 metra, ndërkohë ajo është 10 metra.**

Mosrespektimi i distancës midis ndërtimeve bie në kundërshtim me nenin 34 pika 2 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së

Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 46 pika 7 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë.

Kriteri: Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 ñPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si dhe në kundërshtim me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë Sarandë

Impakti: Miratimi i kësaj leje në kundërshtim me ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 ñPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò të ndryshuar, nenet 34 dhe 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar nga Kryetari i Bashkisë Sarandë nuk ka siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, përdorimin racional të tokës dhe të burimeve natyrore, si dhe ka privuar mundësinë e drejtë të përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me dokumentet planifikuese duke mos krijuar kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale si dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Shkaku: Mos respektimi i përcaktimeve të Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 ñPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò të ndryshuar, të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar si dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë

Rëndësia: **E lartë**

Me shkresën nr.2105 datë 06.05.2021, nga subjekti Bashkia Sarandë janë paraqitur observimet në lidhje me lejen ndërtimit nr. *362, datë 22.09.2020 me objekt "Strukturë banimi dhe shërbimi 1,2,3,4,5 dhe 6 kate me 1 kate parkimi nën tokë",* ku sqarohet se:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

1- Për sa i përket distancës së objektit nga kufiri i pronës në perëndim (2m nga kufiri i pronësisë për volumin 6 kate), nuk ka qenë subjekt i shqyrtimit të distancës së gjurmës së ndërtimit nga kufiri i pronës, por i gjurmës së ndërtimit nga trupi i rrugës, sipas nenit 36 të vkm-së nr.408 datë 13.05.2015 ñPër miratimin e rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendorò ku për gjerësi rruge 7 deri 15 metër, distanca minimale nga trupi rrugës është 3 metër, dhe në planvendosjen e miratuar është respektuar duke qëndruar në distancën 4.1 metër.

2- Nga ana tjetër distanca e objektit me ndërtimin kufizues (distanca ndërtes nga ndërtes) është bazuar në nenin 34 të 408 datë 13.05.2015 ñPër miratimin e rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendorò, pasi objekti kufizues është bërë në kundërshtim me kondicionet urbane. Në këtë rast ndërtuesi ka detyrimin vetëm të respektoj distancën nga kufiri i pronës dhe jo nga objekti i ndërtuar në kundërshtim me kondicionet urbane.

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>

Për sa i përket pikës observimit më sipër, këto fakte janë trajtuar dhe reflektuar në projektraport nga grupi i auditimit.

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimi nr. 5 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1386/1 prot, datë 02.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, z. A G Kryetar i Bashkisë, P Z Drejtor i DPKT, H K ish-Drejtor i DPKT, E M Arkitekt. Lic.1018/1)

Drejtimi 9: ***Të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.***

1."Mbi emërimet e nëpunësve civil në Bashkinë Sarandë"

Në zbatim të programit të auditimit nr. 101/1 prot, datë 04.02.2021, ndryshuar me shkresën nr.101/2 prot, datë 04.03.2021, u përpunua dokumentacioni i mëposhtëm, prej nga rezultoi si vijon:

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.
- Vendim i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nr. 117 datë 05.11.2019 i përcjell për Bashkinë Sarandë me shkresën nr. 1523/2 prot, datë 05.11.2019.
-Listëpagesa e muajit Dhjetor 2020,
-Vendim nr. 6 datë 31.01.2020 ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020, në Bashkinë Sarandëò;
-ñShkresë Kujtesëò, e Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njerëzore nr. 1245 prot, datë 03.04.2020;
-ñShkrese Kujtesëò e e Drejtorisë së Personelit dhe Burimeve Njerëzore nr. 1531 prot, datë 08.05.2020;
-Urdhër nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakanteò.
-Të tjera informacione dhe dokumentacione:

Mbi zbatimin e dispozitave të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar:
Bashkia Sarandë për periudhën vitet 2019 dhe 2020 krahas miratimit të buxhetit vjetor ka përcaktuar dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të institucionit.

- ✓ Për vitin 2019 Këshilli i Bashkisë me vendimin nr. 79 datë 29.12.2018 ka miratuar një strukturë prej 404 punonjësish për Bashkinë Sarandë dhe njësitë e saj të varësisë. Më tej ky numër është detajuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 9 datë 30.01.2019 dhe nr.9/1 datë 23.09.2019.
- ✓ Për vitin 2020 Këshilli i Bashkisë me vendimin nr. 43 datë 23.12.2019 ka miratuar një strukturë prej 410 punonjësish për Bashkinë Sarandë dhe njësitë e saj të varësisë. Më tej ky numër është detajuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 13 datë 27.02.2020 dhe nr.81/1 datë 03.07.2020.

Bashkia Sarandë ka në strukturën e saj së bashku me njësitë administrative pjesë e saj 62 pozicione pune të cilat janë pjesë e shërbimit civil. Nga këto 17 pozicione rezultojnë të plotësuara me punonjës të punësuar me akt-emërimi apo kontrata të përkohshme dhe jo sipas një procedure të rregullt konkurrimi. Konkretisht në 15 raste specialistë dhe 2 raste niveli drejtues në institucion. Problematika rezulton e konstatuar nga ana e inspektimit të kryer nga ana e Komsionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (referuar auditimit paralel që KLSH po zhvillon pranë këtij të fundit), në përfundim të procesit inspektues është përcjell pranë institucionit vendimi nr. 117 datë 05.11.2019. Në këtë vendim Komisioneri evidenton se, aktet e emërimit të kryera kanë dalë në kundërshtim me ligjin pasi në çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *Për nëpunësin civil*, duhet detyrimisht të kryhet në bazë të një procedure të rregullt konkurrimi referuar neneve 22 pika1 ñPranimi në shërbimin civiò, ku përcaktohet se,

1. Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur.

Nenit 23 ñEmërimi në shërbimin civilò pikat 1, 2 dhe vijuese ku përcaktohet se,

1. Kandidatët fitues, të përcaktuar sipas pikës 5 të nenit 22 të këtij ligji, duke filluar nga ai me më shumë pikë, kanë të drejtën të zgjedhin të emërohen në çdo pozicion të grupit, për të cilin është zhvilluar konkurrimi, si dhe në çdo pozicion tjetër të lirë të të njëjtit grup, që krijohet i lirë gjatë kohës së vlefshmërisë së listës, në përputhje me pikën 3 të këtij neni.
2. Njësia përgjegjëse bën emërimin e kandidatit në pozicionin e zgjedhur, sipas pikës 1 të këtij neni.

Nenit 26, ñPlotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtueseò pika 1, 4 e vijuese ku përcaktohet se,

1. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët ose të mesme drejtuese bëhet, së pari, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe, në rast të mosplotësimit të vendit të lirë, me procedurën e ngritjes në detyrë.
4. Përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Referuar këtij ligji neni 23 pika 4 e këtij ligji, përcakton se,

4. Çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm.

Po kështu në bazë të nenit 108 ñAkti administrativ absolutisht i pavlefshëmò gërma a), pika i) dhe ii), gërma ç), të ligjit nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrativeò, i bën aktet e emërimit absolutisht të pavlefshme ku përcaktohet se,

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:
a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:
i) kompetencën e organit publik;
ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose
ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shpre-himisht në ligj.

Gjithashtu referuar nenit 110 ñPasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absoluteò pika 1 të po këtij ligji, veprimi absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht nëse është konstatuar apo jo pavlefshmëria e tij.
Nga ana e Bashkisë në vijim të këtij vendimi është hartuar Urdhër nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakanteò i cili nuk rezulton të jetë vënë në zbatim. Nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për rregullimin e pavlefshmërisë e akteve të mëparëshme por njëlloj punonjësit vijojnë punën në funksionet e mëparëshme.
Kryetari i Bashkisë Sarandë sipas rekomandimit të lënë duhet të konstatonte fillimisht pavlefshmërinë e këtyre veprimeve adminstrative referuar nenit 108 dhe 111 të KPA dhe të konstatonte pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve. Duke ndërprerë marrëdhëniet e punës të lidhura në kundërshtim me procedurë e parashikuar në ligj. Më tej nga ana e institucionit mund të vijohej me shpalljen e vendeve vakante. Aktualisht institucioni nuk rezulton të ketë riparuar këtë paligjshmëri të konstatuar prej rreth 17 muaj më parë. Punonjësit vijojnë funksionet publike duke kryer veprime administrative haptaz në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi dhe vendimet e organeve përkatëse të cilat mbikëqyrin veprimtarinë administrative.

Titulli i Gjetjes 1	**Mungesa e lejeve të ndërtimit në veprat infrastrukturore sjell ndikime të konsiderueshme në detyrimet fiskale për shoqëritë ndërtuese .**
Situata:	Bashkia Sarandë ka në strukturën e saj së bashku me njësitë administrative pjesë e saj **62 pozicione pune të cilat janë pjesë e shërbimit civil.** Nga këto **17 pozicione** rezultojnë të plotësuara me punonjës të punësuar me akt-emërimi apo kontrata të përkohshme dhe **jo sipas një procedure të rregullt konkurimi.** Konkretisht në 15 raste specialistë dhe 2 raste niveli drejtues në institucion. Problematika rezulton e konstatuar nga ana e inspektimit të kryer nga ana e Komsionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (referuar auditimit paralel që KLSH po zhvillon pranë këtij të fundit), në përfundim të procesit inspektues është përcjell pranë Bashkisë Sarandë vendimi nr. 117 datë 05.11.2019. Në këtë vendim Komisioneri evidenton se, aktet e emërimit të kryera kanë dalë në kundërshtim me ligjin pasi në çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *Për nëpunësin civil*, duhet detyrimisht të kryhet në bazë të një procedure të rregullt konkurrimi. Nga ana e Bashkisë në vijim të këtij vendimi është hartuar Urdhër nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakanteò i cili nuk rezulton të jetë vënë në zbatim. Nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për rregullimin e pavlefshmërisë e akteve të mëparëshme por njëlloj si më parë punonjësit e BS vijojnë punën në funksionet e mëparëshme. Aktualisht institucioni nuk rezulton të ketë riparuar këtë paligjshmëri të konstatuar prej rreth 17 muaj më parë. Punonjësit vijojnë funksionet publike duke kryer veprime administrative haptaz në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi dhe vendimet e organeve përkatëse të cilat mbikëqyrin veprimtarinë administrative.
Kriteri :	-Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, neni 22 pika 1 ñPranimi në shërbimin civilò. -Urdhër nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakanteò.
Ndikimi/Efekti	Zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punësimit.
Shkaku:	Mungesë veprimesh konkrete nga ana e institucionit.
Rëndësia	E Lartë

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimi nr. 1 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1365/1 prot, datë 02.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, z. A G Kryetar i Bashkisë dhe, G M ish Drejtor i DPBNJ).

2. "Mbi mungesat e lejeve të ndërtimit në investimet publike dhe efektet financiare që ato sjellin për zbatuesit e punimeve"

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;
-Regjistri i realizimit të prokurimeve publike për periudhën vitet 2019 dhe 2020, investimet në punë publike;
-Dokumentacion mbi lejet e ndërtimit të dhëna mbi investimet publike të paraqitura prej institucionit;
-Të tjera informacione dhe dokumentacione:

Titulli i Gjetjes 2	**Mungesa e lejeve të ndërtimit në veprat infrastrukturore sjell ndikime të konsiderueshme në detyrimet fiskale për shoqëritë ndërtuese .**
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Sarandë për investimet publike të prokuruara dhe të realizuara gjatë periudhës vitet 2019 dhe 2020 vetëm në 5 nga investimet e kryera në infrstrukturë ka pajisur këto punime me lejen

	përkatëse, ndërsa në të gjitha rastet e tjera kjo leje mungon. Mospajisja me lejet përkatëse për kryerjen e punimeve të ndërtimit krijon precedent të gabuar në veprimtarinë institucionale për aq kohë sa vet institucioni është financues i këtyre projekteve por gjithashtu dhe organi i cili kujdeset për garantimin e mbikëqyrjes dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore në fuqi. Evidentohet se, institucioni nuk ka arritur të garantojë një bashkëpunim të brendshëm efektiv midis drejtorive për aq kohë sa investimet e veta kanë mbetur të papajisura me leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit. Veç aspekteve që lidhen me procesin e mbikëqyrjes së territorit dhe mungesës së koordinimit të brendshëm, **kryerja e punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ndikon në mospërfitim të kreditimit të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera në funksion të punimeve të situacionuara nga subjekti ndërtues i cili nuk duhet të kishte filluar punimet në mungesë të saj.** Dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë që kryerja e punimeve pa lejet përkatëse ndikon në mospërfitimin e zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Kreditimi i padrejtë i TVSH-së ul padrejtësisht detyrimet e pagueshme në buxhetin e shtetit nga subjekti ndërtues, ku për këtë objekt vlera mund të shkoj deri në 93% të TVSH-së së vlerës së punimeve të cilat faturohen. *Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:* Institucioni evidenton mungesë të koordinimit mes drejtorive të cilat mbulojnë procedurat prej planifikimit të investimit, realizimit dhe lidhjes së kontratës, planifikimit dhe mbikëqyrjes së ndërtimit si dhe veprimtarisë inspektuese të cilat jo vetëm dëmtojnë imazhin e institucionit por krijojnë një sërë rrjedhojash ligjore ku shoqëritë zbatuese duhet të përballen me kosto shtesë rrjedhojë e kufizimeve nga legjislacioni i posaçëm fiskal.
Kriteri :	-Ligji nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar, -VKM nr. 408, datë 13.5.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, e ndryshuar. -Udhëzimi nr. 6 datë 30.01.2015 ñPër tatimin mbi vlerën e shtuarò, i ndryshuar, nenit 20 pika 8/a, dhe 8/d. **Pika 8/a** *Rastet e mësipërme janë ilustruese të situatave të ndryshme në ndërtim, por nuk janë shteruese.* ***Pika.*** *d)* ***Për çdo punim në ndërtim*** *të kryer në shkelje të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës,* ***ose çdo punim të kryer përpara se leja përkatëse e kërkuar nga legjislacioni i fushës, të jetë lëshuar****,* ***personi i tatueshëm ndërtues*** *është i detyruar të paguajë TVSH për pjesën e punimeve të kryera, por ndërkohë atij nuk i lejohet të zbresë TVSH-në për blerjet e kryera që i korrespondojnë situacioneve (pjesës së punimeve) në fjalë, përsa për kryerjen e punimeve nuk janë respektuar kërkesat dhe dispozitat ligjore të fushës përkatëse....*
Ndikimi/Efekti	Vlera e cila përllogaritet me humbjet të të drejtës së kreditimit të TVSH nga ana e shoqërive zbatuese të punimeve dhe rrjedhimisht me ndikim në rritje të pagesës së TVSH për llogari të administratës tatimore e cila llogaritet në vlerën prej rreth **55,515,463 lekë** (298,470,231 x 0.93 x 20%). Aneksi nr. 5 i këtij materiali auditimi.

Shkaku:	Mosrakordim dhe mungesë e vëmendjes nga hallkat përgjegjegjëse të Bashkisë Sarandë si dhe subjektit ndërtues.
Rëndësia	E Lartë

(Trajtuar më hollësisht në Akt-Konstatimi nr. 7 regjistruar në Bashkinë Sarandë me nr. 1386/3 prot, datë 02.04.2021 mbajtur me përfaqësuesit e institucionit, P Z Drejtor i DPKT dhe E B , G D , A K Kryeinspektor të IMTV sipas periudhës).

Observacion i paraqitur nga z. P Zh datë 29.04.2021 mbi Akt konstatimin nr. 7 regjistruar në KLSH me nr. 101/4 prot., datë 10.05.2021, në të cilin trajtohet se:

Pretendimi i Subjektit*: -Nuk shprehim dakordësi për mospajisjë më leje përkatëse për kryerjen e punimeve të ndërtimit për investimet publike për periudhën vitet 2019 dhe 2020 me arsyetimin se .....Pika 1. Çdo subjekt i cili kërkon të paiset me leje apo të paraqesë deklaratë paraprake për kryerje punimesh, është i detyruar të dorëzojë aplikimin për leje apo deklaratën dhe dokumentacionin shoqërues nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve....*
Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit ka pajisur me leje punimesh të gjitha punimet publike për të cilat është kryer aplikim elektronik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Pavarësisht pretendimeve, lejet e ndërtimit për punimet në infrastrukturë referuar Aneksit nr. 5 pjesë e këtij materiali auditimi mungojnë. Mungesa e tyre nuk justifikohet për aq kohë sa është vet Bashkia Sarandë e cila ka kryer planifikimin, procedurën e prokurimit, mbikëqyrjes së punimeve, zotëron pronën mbi të cilën do të kryhet investimi, siguron përjashtimin nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukture referuar nenit 46 pika 3 e tij si dhe disponon të gjitha projektet dhe planvendosjet e nevojshme për kryeren e këtyre investimeve.
Për sa më sipër pretendimi i ngritur nuk merret në konsideratë.

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si ***më poshtë***:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

1. Bashkia Sarandë nuk disponon një kod etike, në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuara të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje, në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullin III, pika 3.1 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
2. Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

3. Për vitin 2019 dhe 2020 titullari i Bashkisë Sarandë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në kundërshtim me nenin 8, pika 8/b të ligjit për MFK.
4. Për periudhën 2019 dhe 2020 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ó*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeô*
5. Titullari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet Urdhrit nr. 139, datë 30.09.2020 ka caktuar koordinatorin e riskut për Bashkinë Sarandë, Znj. L Q . Në këtë rast, përgjegjësinë e koordinatorit të MFK dhe të riskut, e ka nëpunësi autorizues, i cili është Z. R Ç i caktuar nëpërmjet shkresës nr. 3004 prot, datë 23.07.2020 dhe është ai që duhet të delegojë disa prej detyrave, dhe jo Titullari. Për më tepër, nuk mund të delegohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë, por si përcakton ligji, disa prej tyre. Në urdhrin e caktimin të koordinatorit të riskut, nuk përcaktohen se cilat nga detyrat janë deleguar.
6. Bashkia Sarandë kryen aktivitetin e saj në bazë të Rregullores së Brendshme, e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 34 datë 05.06.2008. Kjo rregullore është e vjetër dhe e pa përditësuar me ndryshimet në strukturën organizative. Kjo pengon kryerjen e punës me efektivitet nga punonjësit pasi ata nuk janë të njohur me punën që duhet të kryejnë, vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës si dhe nuk mund të bëhet një vlerësimi objektiv i rezultateve të tyre në punë.
7. Bashkia Sarandë disponon disa përshkrime pune, por këto nuk kanë datë se kur janë bërë, gjithashtu edhe procedura e ndjekur për hartimin e tyre nuk është bërë në përputhje me nenin 24 të Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 ó*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*ô. Gjithashtu, këto përshkrime pune nuk janë miratuar nga DAP, sikurse përcaktohet në nenin 35 të këtij Vendimi.
8. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve. Gjithashtu Bashkia Sarandë nuk disponon një program trajnimi për punonjësit.
9. Bashkia Sarandë nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.
10. Ky institucion për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296 për MFK. Bashkia Sarandë nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.
11. Titullari i Bashkisë Sarandë për vitet 2019 dhe 2020 nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
12. Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Sarandë, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.
13. Në lidhje me komunikimin e jashtëm, Bashkia Sarandë ka një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen web mungon programi i transparencës, në kundërshtim nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 ó*Për të drejtën e informimit*ô. Gjithashtu, mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim nenin 8 të këtij ligji.
14. Nuk ka asnjë dokumentim të raportimit të institucioneve të varësisë në Bashkinë Sarandë mbi statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit të MFK.

15. Bashkia Sarandë nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK.
16. Për vitin 2019 dhe 2020 rezulton se nëpunësi autorizues i Bashkisë Sarandë nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 16-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 <u>Rekomandimi:</u>
-Titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme që të njohë punonjësit me aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me MFK-në dhe të përcaktojë detyra të qarta mbi zbatimin e tyre.
-Titullari i institucionit të ngrejë një grup pune i cili të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e komponentëve të MFK-së dhe të hartojë një plan pune për zbatimin e menjëhershëm të tyre.
-Titullari i institucionit të ndjekë me rigorozitet aplikimin dhe zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH rezultoi se:
-Auditimi i mëparshëm i zhvilluar nga KLSH në Bashkinë Sarandë është kryer sipas programit të auditimit nr. 365/1 datë 28.05.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2019. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 365/7 prot, datë 27.09.2019. Në vijim, me auditimin tematik të KLSH-^{së} referuar programit të auditimit nr. 610 prot, datë 25.06.2020 është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna ku dhe është ri-kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve e konstatuara me status të pazbatuar, zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi. Raporti Përfundimtar i auditimit tematik mbi zbatimin e rekomandimeve dhe shkresa përcjellëse e KLSH, janë administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 5229 prot, datë 07.12.2020.
-Bashkia Sarandë referuar regjistrit të protokollit të saj, ka nisur përgjigjen mbi planin e masave të marra për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 5229/1 prot, datë 31.12.2020, pra ***në tejkalim të afatit 20 ditor të parashikuar*** nga neni 15, shkronja ñjò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se, niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes është si më poshtë:

h. *Janë rekomanduar **15**(pesëmbëdhjetë) **masa organizative**, nga të cilat **pa zbatuar 10**(dhjetë), **në proces zbatimi 4**(katër) dhe **zbatuar pjesërisht 1** (një) masë.*
i. *Janë rekomanduar **13**(trembëdhjetë) **masa për shpërblim dëmi**, nga të cilat janë **pa zbatuar 13**(trembëdhjetë) masa.*
j. *Janë rekomanduar **5**(pesë) **masa për uljen e borxhit tatimor**, nga të cilat janë **pa zbatuar 5**(pesë) masa.*
k. *Janë rekomanduar **4**(katër) **masa për eliminimin e efekteve negative**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 4**(katër) masa..*
l. *Janë rekomanduar **18**(tetëmbëdhjetë) **masa administrative**, nga të cilat janë **pa zbatuar 3**(tre), **15** (pesëmbëdhjetë) masa janë **në proces zbatimi.***
m. *Janë rekomanduar **9**(nëntë) **masa disiplinore**, nga të cilat janë **zbatuar pjesërisht 9**(nëntë) masa.*

n. *Është rekomanduar **1**(një)* ***masë për njoftimin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil****, e cila gjendet* ***e pa zbatuar****.*

Sa më lart rezultoi se, numri i rekomandimeve të zbatuara nga ana e Bashkisë Sarandë mbetet në nivel të ulët pavarësisht pranimit dhe angazhimeve institucionale të marra. Megjithëse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë nga përcjellja e tyre dhe efektet financiare të konstatuara kapin vlera të konsiderueshme mungojnë veprimet administrative të nevojshme për përmbushjen e tyre. Ndërkohë disa prej rekomandimeve megjithëse janë zbatuar në afate tepër të gjata nuk përputhen me masën e rekomanduar. Gjetjet e konstatuara në auditimet e KLSH nuk rezultojnë të jenë paraqitur për analizë apo diskutim në Këshillin Bashkiak sa i përket problematikave të evidentuara si dhe masave të të marra për përmirësim. Mangësitë e vërejtura mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në vijimësi nga KLSH si dhe masat e pamjaftueshme të marra në kuadër të përmirësimit të situatës, evidentojnë nevojën për rishikimin e mënyrës së qasjes institucionale në këtë drejtim. Kjo për shqyrtimin dhe marrjen e veprimeve administrative të përshtatshme në afate kohore të shkurtra, me cilësi të lartë vendimmarrëse, në kuadër të detyrave të caktuara nga ligjvënësi në mbrojtjen e interesit publik. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 73-75 dhe 118-162, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masat e nevojshme administrative e ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH të cilat evidentohen me status, *i pazbatuar, i zbatuar pjesërisht* apo *në proces zbatimi*, evidentuar në **Aneksin nr. 6** të Raportit Përfundimtar të Auditimit, me qëllim përmirësimin e gjendjes, rikuperimin e vlerave financiare të evidentuara si dhe vendosjen përpara përgjegjësisë të personave të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë sjellë pasoja negative në veprimtarinë e institucionit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Sarandë së bashku me njësitë administrative në varësi të saj disponon në strukturë **62 pozicione pune të cilat janë pjesë e shërbimit civil.** Nga këto, **17 pozicione** rezultojnë të plotësuara me punonjës të punësuar me akt-emërimi apo kontrata të përkohshme dhe **jo sipas një procedure të rregullt konkurrimi,** përkatësisht në 15 pozicione specialisti dhe 2 raste niveli drejtues në institucion. Problematika është konstatuar nga institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në inspektimin e kryer nga ky i fundit në Bashkinë Sarandë[7], ku në përfundim konkluzionet janë përcjellë pranë Bashkisë Sarandë me Vendimin nr. 117 datë 05.11.2019. Në këtë vendim Komisioneri ka trajtuar se, aktet e emërimit për këto 17 pozicione pune janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, pasi në çdo marrëdhënie të re pune që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *Për nëpunësin civil*, duhet detyrimisht të kryhet në bazë të një procedure të rregullt konkurrimi. Në vijim të këtij vendimi, Bashkia Sarandë ka nxjerr Urdhrin nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakanteò i cili nuk rezulton të jetë vënë në zbatim dhe të ketë kthyer situatën në legjitimitet, ndërkohë punonjësit e BS vijojnë punën në funksionet e mëparshme. Deri në përfundim të fazës audituese në terren, institucioni nuk e kishte riparuar ende këtë paligjshmëri të konstatuar rreth 17 muaj më parë. Ndërkohë punonjësit e emëruar vijonin kryerjen e funksioneve publike duke kryer veprime administrative haptazi në kundërshtim me bazën ligjore në fuqi dhe vendimet e organeve përkatëse të cilat mbikëqyrin veprimtarinë administrative të nëpunësve civil. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 82-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

[7] Burimi: Nga të dhënat e auditimit paralel që KLSH zhvilloi pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

3.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, të marrë masat e nevojshme administrative e ligjore zbatimin e rekomandimit të lënë nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin nr. 117 datë 05.11.2019, **për 17 punonjësit e emëruar në mospërputhje me dispozitat ligjore në fuqi** dhe të nxjerr përgjegjësitë individuale për punonjësit të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë zvarritur në mënyrë të pajustifikuar këtë proces.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë rezultoi se, nga ana e kësaj strukture nuk është bërë i mundur verifikimi i detyrave të lënë nga misionet e auditimit të kryera, pavarësisht se një nga drejtimet e auditimit në angazhimet e kryera është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Për vitet 2019 dhe 2020 ky verifikim nuk është realizuar në asnjë mision auditimi, ndërkohë si NJAB ashtu dhe titullari i institucionit nuk kanë arritur të informohen mbi nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara. Në dosjet e audituara rezultuan disa mangësi e parregullsi ku përmendim; njoftimi i njësisë publike ndodh në të njëjtën ditë me takimin fillestar (prezantues); inventari i sugjeruar në dosjet koherente të auditimit, nuk është kryer si duhet duke qenë se në pjesë më të madhe të dosjeve mungojnë të dhënat në lidhje me atë çfarë gjendet në dosje; evidentohen mungesa të dokumenteve si Plane Veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna; në dosjet e vitit 2019 mungon vetëvlerësimi periodik nga njësia e auditimit të brendshëm, observacionet e subjekteve janë pa datë hartimi, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim). Nuk dokumentohet që NJAB pas përfundimit të çdo angazhimi të auditimit të ketë njoftuar zyrtarisht subjektin e audituar, për reagimin ndaj projekt rekomandimeve të adresuara. Drejtori i NJAB, pranë Bashkisë Sarandë edhe pse është emëruar në pozicionin drejtor, është njëkohësisht edhe auditues duke qenë pjesë e programeve të angazhimeve të auditimit, çka cenon në mënyrë të pashmangshme sigurimin e cilësisë së auditimit, pasi në këto raste mungon sistemi i kontrollit mbi materialet e hartuara. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 24-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë, të marrë masat për verifikimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e përfunduara, për të ndjekur në vijimësi ecurinë e zbatimit të tyre si dhe për të informuar Titullarin e Institucionit mbi masat e marra nga subjekti i audituar si dhe shkallën e përmbushjes së tyre.

Në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Sarandë të marri masat për dokumentimin e plotë të veprimtarisë audituese konform përcaktimeve ligjore në fuqi si dhe të garantojë sigurimin e cilësisë në veprimtarinë audituese duke mos përfshirë në procesin auditues drejtuesin e kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, specialistja e NJAB, Zj.S P , është punësuar pranë Bashkisë Sarandë në funksionin ñSpecialiste Auditiò me kontratë 3- mujore sipas Urdhrit nr. 23, datë 15.03.2019, ndërsa me aktin nr. 23/1, të datës 21.06.2019 është emëruar në funksionin ñSpecialist i Auditit të Brendshëmò. Emërimi i saj në këtë detyrë bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 114/2015 ñPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikñ, Nenit 11, ñPunësimi i audituesit të brendshëmò, pika 2a, sipas së cilës, specialisti duhet të kenë diplomë

universitare të nivelit të dytë të cilën kjo punonjëse nuk e disponon. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 24-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për eliminimin e paligjshmërisë së konstatuar në emërimin e specialistes së NJAB me aktin nr. 23/1, të datës 21.06.2019, për të garantuar një strukturë auditimi me punonjës të cilët përmbushin kriteret ligjore dhe arsimin përkatës të parashikuar në ligj.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi proceset e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës buxhetore në Bashkinë Sarandë u konstatua se:
Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, sa i përket pjesës së të ardhurave të veta por dhe shpenzimeve të kryera.
Për vitin 2019, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 79% ose nga 1,242,506 mijë lekë të planifikuara në 986,868 mijë lekë të realizuara. Sa i përket programit Menaxhim, Administrim, Planifikim (aparatit të bashkisë) rezulton se është realizuar në masën 82 % ose nga 573,529 mijë lekë të planifikuara në 468,832 mijë lekë të realizuara.
Për vitin 2020, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 68% ose nga 1,294,726 mijë lekë të planifikuara në 883,078 mijë lekë të realizuara. Programi Menaxhim, Administrim, Planifikim (aparatit të bashkisë) rezulton se është realizuar në masën 70 % ose nga 285,127 mijë lekë të planifikuara në 199,319 mijë lekë të realizuara. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Sarandë apo në vendime.al ka mungesa dhe vonesa në afatet e publikimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore e Ligjit nr. 114/2014 ñPër të drejtën e informimitò. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 31-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit.
6.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa, të dokumentoj mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.
6.3 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa, për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultuan risqe buxhetore referuar detyrimeve të prapambetura. Të cilat më datë 31.12.2019 paraqiten në vlerën 67,663,864 lekë ndërsa më datë 31.12.2020 në vlerën 57,200,636 lekë nga e cila vlerat më të larta të palikuiduara rezultojnë, OSHEE **27,943,041** (të mbartura ndër vite) dhe K Shpk ,Korçë për pastrim e qytetit **17,678,509 lekë** (fatura të vitit 2020). Për OSHEE, energjinë elektrike nuk është bërë asnjë planifikim për shlyerjen duke çuar në rritjen e kësaj vlere nga viti në vit. Nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk është paraqitur në të gjitha rastet në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Një pjesë e kontratave janë regjistruar me vonesë në thesar. Parregullsitë e kanë ekspozuar institucionin drejt penaliteteve

për pagesa të vonuara. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 31-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, objektet e inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 1,132,520,369 lekë nuk janë të pajisur me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive ato paraqiten si më poshtë:
-llog 210 ñToka troje terreneò, 29 elementë në vlerën neto 115,397,833 lekë
-llog. 211 ñPyje plantacioneò, 2 elementë në vlerën neto 31,804,000 lekë,
-llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò, 14 objekte me vlerën neto 985,318,536 lekë
Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikate pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucionit janë kontabilizuar gabim si asete disa situacionime veprash në proces të cilat ende nuk ishin marrë në dorëzim në periudhën përkatëse. Duhet theksuar se, jo çdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet ne aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, dhe në rastin tonë janë rrugët dhe veprat ujore. Vetëm shpenzimet kapitale të cilat janë situacione përfundimtare dhe janë marrë në dorëzim objekti, atëherë kapitalizohet e gjithë vlera e tij të llogaria e aktivit. Shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale(kosto historike) për llogarinë 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, ka qenë në vlerën 78,717,784 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqërues në urdhër shpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, disa prej faturave të sipërcituara nuk përbëjnë rritje aktivi sepse projekti përkatës në fund të vitit 2019 nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Shpenzimet kapitale të cilat duhet të ishin regjistruar në llog. 231 dhe jo të kapitalizoheshin në llog. 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò. Shtesa e shpenzimit kapital prej 1,451,340 lekë për investimin e ñShkallëve lidhëse ndërmjet rrugëve në lagjen 2 dhe sistemime ne ambientet publikeò e vitit 2019, është marrë në dorëzim në vitin 2020, kështu që është nuk duhej të kapitalizohej në llog. 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò për vitin 2019 por ajo duhej të debitonte llog. 231 ñShpenzime për rritjen e AQTò. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Sarandë, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò për shumën 1,451,340 lekë për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, llogaria 202 ñStudime dhe Kërkimeò paraqitet në fund të vitit 2018 në vlerën neto 14,433,919 lekë dhe në fund të vitit 2019 në vlerën neto 23,441,536 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të një projekti për hartimin e planeve të detajuara vendore me vlerë 14,868,000 lekë ndërkohë që pakësimi nga amortizimi vjetor paraqitet 5,860,833 lekë.
Referuar pasqyrës mbi ndryshimet e AAM, në fillim të vitit 2019 gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në vlerën historike prej 104,693,177 lekë ndërkohë në fund të kësaj periudhe paraqiten 119,561,177 lekë dhe përbëhet nga 113 projekte për investime të kryera të cilat nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventarizimi kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderëve sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera nga ana e institucionit duhet të bëhej regjistrimi kontabël në kartelën e çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi bazuar në projekt-studimet. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

<u>10.1 Rekomandimi:</u> Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për të kryer sistemimet përkatëse në kontabilitet duke kaluar vlerën e tyre sipas çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të sistemohet llogaria nr.202 studime e kërkime për vlerën 104,693,177 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, referuar të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, Bashkia Sarandë zotëron 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit Butrinti, SH.A me NUIS ñL14717801Vò e cila është e organizuar në formën e një shoqërisë aksionare dhe ka si objekt veprimtarie të saj ñOrganizimi i aktiviteteve sportive ne fushën e futbollit...që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e sajò. Numri i aksioneve është 2,000 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion me një kapital në vlerë monetare prej 2,000,000 lekë. Kjo vlerë kapitali nga Bashkia Sarandë nuk gjendet e paraqitur në aktivet afatgjata financiare të Pasqyrave Financiare 2019. Më konkretisht, kjo vlerë nuk gjendet në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò. Mungesa e vlerës së kapitalit aksionar të Klubit të Futbollit Butrinti, SH.A. me vlerë kontabël 2,000,000 lekë në aktivet afatgjata financiare të Bashkisë Sarandë për vitin 2019, përbën mos pasqyrim të drejtë të informacionit financiar nga ana e saj. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

<u>11.1 Rekomandimi</u> Nga Bashkia Sarandë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet duke regjistruar pjesëmarrjen 100% që Bashkia Sarandë zotëron në kapitalin aksionar të Klubit të Futbollit Butrinti SH.A me vlerën kontabël 2,000,000 lekë, në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në ***llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm"*** paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe investime e shërbime. Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Sarandë nga sistemi SIFQ i thesarit, u identifikuan pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2020 por të paregjistruara në detyrimet e

prapambetura të vitit 2019. Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2019 dhe 2018 por të paregjistruara dhe të likuiduara në 2020, paraqiten në vlerën 38,910,086 lekë. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2019, ka nënvlerësuar llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëmò në këtë vlerë. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëmò të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019 përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave ***janë nënvlerësuar me 38,910,086 lekë***. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.**

12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshëmò e cila **është nënvlerësuar për vitin 2019 në vlerën 38,910,086 lekë.** Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht është joreal.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i 5 (pesë) procedurave të prokurimit ñBlerje me vlerë të vogëlò me fond limit 3,767 mijë lekë, rezultuan mangësitë si më poshtë vijon:

-Kërkesa për materiale janë bërë nga magazinierja znj. S F , pasi janë marrë kërkesat nga zyrat përkatëse. Theksojmë se, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas rregullores së brendshme të funksionimit të kësaj Bashkie, miratuar me VKB nr. 34 datë 05.06.2008, nuk është detyrë e magazinieres të hartojë kërkesat për materiale apo të hartojë përmbledhësen e kërkesave nga zyrat përkatëse. Gjithashtu procedura e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar.

-Mos caktimi i një personi apo strukture të posaçme, në të cilin të ngarkohet dhe kërkohet përgatitja e kërkesave bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 40, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, pika 4 e saj, është përcaktuar se, ñKur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyreò. Titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhër në të cilin të ngarkohet dhe kërkohet përgatitja e kërkesave, në kundërshtim me pikën 35.a dhe 36 të UMF nr.30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, nenin 6, germa (e), dalë në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò .

-Jo në të gjitha rastet e audituara është vepruar sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 40, ku është përcaktuar se, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, në pikën 2 të tij është përcaktuar se, ñNë rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël kryhet me mjete elektronike, anëtarët e komisionit ftojnë të paktën 5 (pesë) operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronikò, pasi në tre prej tyre janë ftuar vetëm 2-3 nga 5 OE të kërkuar.

-Në ftesën për ofertë me objekt prokurimi ñShpenzime mirëmbajtje mjetesh për ujitjen dhe kulliminò, nuk është përcaktuar lloji i mjetit/eve dhe numri i mjeteve të bordit për tu mirëmbajtur. Mos përcaktimi i llojit të mjeteve, është në kundërshtim me nenin 40, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, pika 1, ku është përcaktuar se: ñAutoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përllogaritur është më e ulët se 800,000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e

kontratave, që do të prokurohen. Për këtë procedurë rezulton se, nuk ka një akt konstatim/kërkesë nga personat përgjegjës për kryerjen e shërbimit.

-Në procedurën me objekt ñShpenzime për blerje dezinfektantë për kopshtet dhe shkollatò me fond limit 800,000 lekë, në specifikimet teknike referuar fotove të vendosura në ftesën për ofertë, rezulton markë e vendosur në kundërshtim me nenin 23 ñSpecifikimet teknikeò, të LPP.

-Në procedurën ñRiparim mjeti tip ekskavator me gomaò, me fond limit 800,000 lekë mungon proces verbali për përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, 40, ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò. Në lidhje me realizimin e këtij shërbimi rezulton se nuk ka urdhër për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim si dhe nuk ka akt marrje në dorëzim, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, pjesa ñMarrja në dorëzim e aktiveve të furnizuaraò. Mos nxjerrja e urdhrave është në kundërshtim me pikën 35.a dhe 36 të po këtij udhëzimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë, të merren masat e nevojshme për organizimin e punës mbi planifikimin e rregullt të kërkesave për blerje me vlerë të vogël, nxjerrjen e urdhrave përkatës, dokumentimin e mallrave apo shërbimeve të marra, etj, konform përcaktimeve ligjore në fuqi si dhe të sigurohet trajnim i vazhdueshëm i punonjësve të cilët angazhohen për këto procedura.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurës për leje ndërtimi rezultoi se, leja e zhvillimit nr. 214, datë 05.08.2019 dhe lejes së ndërtimit nr. 268 datë 19.12.2019 me objekt ñStrukturë banimi dhe shërbimi 5 kate me 1 kate parkim të hapur mbi tokëò në njësinë strukturore SA.UB.8.448, paraqitur nga zhvilluesi ñP 2020ò SHPK dhe ndërtuesi shoqëria " M "SHPK, projektuar nga arkitekti E M , është miratuar pa plotësuar kushtin e ruajtjes së distancës midis gjurmës së ndërtimit nga kufiri i pronës si dhe objektit në ndërtim nga objektet ekzistuese (distanca ndërtesa nga ndërtesa). Ky veprim është bërë në kundërshtim me nenet 34, 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"* të ndryshuar si dhe në kundërshtim me nenin 46 pika 7 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 76-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa dhe të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave në 3 nivele; distancë ndërmjet ndërtesave, ndërmjet ndërtesës dhe kufirit të pronës si dhe ndërmjet ndërtesës dhe trupit të rrugës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në procedurave të prokurimit publik të zhvilluara nga Bashkia Sarandë për periudhën nën auditim 01.07.2019-31.12.2020, me fond limit 198,091 mijë lekë ose 53% e fondeve limit gjithsej të prokuruar, rezultuan problematika në vendosjen e kritereve për kualifikim dhe garantimin e një pjesëmarrje të gjerë ku përmendim:
1. Në kriteret e vendosura për pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik është kërkuar përmbushja individualisht e tyre nga çdo OE pjesë e BOE çka e humbet qëllimin e bashkimit midis tyre. Po kështu, përcaktimi i punësimit të stafit teknik me afat të përcaktuar punësimi pranë OE, pa u

fokusuar tek vjetërsia në punë, vendosja si kriter e dëshmive dhe certifikatave të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, vërtetimet mbi detyrimet nga Bashkia Sarandë, etj, vlerësohet që kanë kufizuar garën midis OE dhe nuk kanë siguruar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në këto procedura, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, neni 46 pika 3 si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, neni 26 pika 5, neni 61 pika 2, e saj.
2. Institucioni ka hartuar regjistrat e parashikimit në sistemin elektronik të APP të cilët janë publikuar prej saj. Konstatohet se, regjistrat e parashikimit nuk janë dërguar pranë degës së thesarit në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar, nenit 5 pikat 1 dhe 4 të saj, ñRegjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë të marrë masat që vendosja e kritereve në procedurat e prokurimit të bëhet në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, duke mos krijuar kufizime të paargumentuara të pjesëmarrjes në tender dhe duke stimuluar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në këto procedura.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masat për trajnimin e stafit të ngarkuar me kryerjen e procedurave të prokurimit me qëllim uljen e riskut për parregullsi në të gjitha fazat e procedurave të prokurimit publik, nga hartimi i regjistrave të prokurimit, deri në përfundimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e marrjes në dorëzim dhe pagesës së ñShërbimit të pastrimit të qytetitò rezultoi se: Kontrata bazë e pastrimit të qytetit përfundonte më datë 13.03.2020. Për shkak të situatës së pandemisë Covid-19 dhe në vijim të Aktit Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 Bashkia Sarandë ka kaluar për miratim në Këshillin Bashkiak amendimin e kontratës për këtë shërbim me afat deri në lidhjen e kontratës së re, amendim i miratuar me Vendimin nr. 21 datë 26.03.2020. Vendimi është aprovuar edhe nga Prefektura e Qarkut me shkresën nr. 363/1 prot, datë 30.03.2020. Në dokumentacionet justifikuese për marrjen e shërbimit të cilat i bashkëlidhen pagesave të kryera nga Bashkia Sarandë gjatë periudhën 01.07.2019-31.12.2020 gjendej vetëm raporti teknik mujor i cili shoqëronte faturën tatimore të lëshuar nga OE por i pa shoqëruar me raportet ditore për marrjen në dorëzim të shërbimit, të cilat janë të nevojshme për dokumentimin e përmbushjes së shërbimit, proceseve të punës, angazhimin e stafit dhe mjeteve të parashikuara, zbatimin e grafikut të punimeve nga ana e OE konform kontratës, etj. Gjithashtu, nuk gjendeshin procesverbalet për ditët që shërbimi nuk mund të kryhej, si rrjedhojë e kushteve atmosferike me shira apo ngricë, që në çdo rast duhet të evidentoheshin çka e bën këtë proces jo të plotë dhe të mirë dokumentuar. Theksojmë se, marrja në dorëzim e këtij shërbimi të rëndësishëm nuk duhet të jetë vetëm një akt-konfirmimi shkresor, por një proces i përditshëm verifikimi dhe raportimi i shërbimit të kryer nga operatori, për të garantuar, cilësinë e kërkuar të shërbimit në dobi të komunitetit vendas si dhe për të garantuar efektivitetin e vlerave financiare të shpenzuara, çka mungon në rastin konkret. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë, të merren masat e nevojshme për të përmbushur korrektësisht përcaktimet sipas kontratës së lidhur me marrjen e shërbimit të pastrimit të qytetit,

në përputhje me specifikimet teknike të shërbimit të kërkuar, duke dokumentuar në çdo rast nëpërmjet raporteve ditore shërbimin e kryer/pa kryer dhe garantuar përfitimin e një shërbimi pastrimi sa më cilësor në dobi të komunitetit vendas.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në relacionin e mbajtur nga komisioni i inventarizimit, më datën 19.12.2019 pas verifikimit në terren, është evidentuar mosrakordim ndërmjet gjendjes kontabël dhe asaj fizike. Ky mosrakordim material kishte të bënte me kontejnerët e mbeturinave të cilët i janë dhënë në dorëzim operatorit ekonomik ñK ò SHPK me NIPT J G, i cili ka lidhur kontratën e pastrimit të qytetit të Sarandës për vitin 2018. Sasia e kontejnerëve të munguar, që kanë qenë nën përgjegjësi të operatorit ekonomik ñK ò SHPK është 155 kontejnerë metalik dhe 13 kontejnerë plastik. Për këtë arsye, nga komisioni i inventarizimit më datë 25.11.2019 është mbajtur një procesverbal ku specifikohet mungesa e kontejnerëve të sipërcituar. Referuar kontratës që autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë ka me operatorin ekonomik ñK ñ SHPK në nenin 26.1 pika citohet ñ Mirëmbajtja dhe siguria e kontejnerëve do të kryhet nga sipërmarrësiò. Mungesa e inventarëve kontejnerë mbeturinash me vlerë kontabël **5,365,918 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Sarandë**. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 48-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

<u>1.1 Rekomandimi:</u> Nga Bashkia Sarandë, të marren masa për arkëtimin e vlerës **5,365,918 lekë nga operatori ekonomik "K " SHPK me NIPT J G** duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, duke iu referuar dhe kontratës së lidhur mes palëve për kryerjen e shërbimit, si dhe të nxirren përgjegjësitë ndaj përgjegjësve material në Bashkinë Sarandë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñRehabilitim rrugësh dhe rikualifikim pjesor me asfalt në Sarandë dhe Ksamilò Bashkia Sarandë, me vlerë 6,429,060 lekë me TVSH, fituar nga Kontraktori ñA ò SHPK, në objekt rezultuan diferenca në volume pune të zërit të punimeve ñSpërkatje me emulsion bituminoz 1.5/m2ò në Rrugët ñTeutaò; ñSelim Islami, lagjja nr. 4, Sarandëò; ñIsadora Dunkan, Ksamilò, në vlerën **417,600 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10 prot, datë 01.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe sipërmarrësit ñA ò SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>2.1. Rekomandimi:</u> Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **417,600 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria ñA ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 10 prot, datë 01.07.2019 me objekt ñRehabilitim rrugësh dhe rikualifikim pjesor me asfalt në Sarandë dhe Ksamilò, Bashkia Sarandë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Investime në lagjet e qytetit, kënde lojërash, rrugë betoni, sistemim ndriçimi lagjja nr. 1,2,3,4 dhe periferia Sarandë*ò Bashkia Sarandë, me vlerë 14,163,420 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm të shoqërive ñM ò SHPK & ñB ò SHPK, përfaqësuar nga shoqëria ñM ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve ñF.V Hekur betoni periodik Ø 4 mm.ò, në vlerën **455,850 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot, datë 10.06.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe BPSH ñM ò SHPK & ñB ò SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **455,850 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve bashkimi i përkohshëm të shoqërive ñM ò SHPK & ñB ò SHPK, përfaqësuar nga shoqëria ñM ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot, datë 10.06.2019 me objekt ñ*Investime në lagjet e qytetit, kënde lojërash, rrugë betoni, sistemim ndriçimi lagja nr. 1,2,3,4 dhe periferia Sarandë*ò, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñ*Riparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bankë kopshti – Kështjella Ksamil*ò Bashkia Sarandë, me vlerë 14,125,728 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve ñE ò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve ñShtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 1-1^2-2^5-5; Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3.5 cm, me makineri. Rr. Kështjellë-Peme e thatë, Seksioni 19-19^20-20 S-1; Skarifikim shtresë asfalti me makineri. Rr. Kështjellë-Pemë e thatë. Seksioni 1-1^2-2^5-5; Skarifikim shtresë asfalti me makineri. Seksioni 19-19^20-20ò, në vlerën **509,625 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9 prot datë 06.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Sarandë dhe sipërmarrësit ñE ò SHPK. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **509,625 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve bashkimi i përkohshëm të shoqërive ñE ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9 prot, datë 06.07.2020 me objekt ñ*Riparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bankë kopshti – Kështjella Ksamil*ò, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të plazhit për vitin 2019 dhe 2020, në të gjitha rastet rezultoi se:

a. Kontratat janë lidhur jashtë afatit të përcaktuar në nenin 4 pika 4 të VKM nr. 171, datë 27.3.2019 për miratimin e rregullores ñPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò, ku përcaktohet se njësitë e qeverisjes vendore duhet të lidhin kontratat e qirasë së plazheve deri me datën 31 mars. Gjithashtu, për vitin 2019, në 21 kontrata plazhi, hapësira e dhënë në përdorim për stacion plazhi, është më e vogël se 200 m^2, në kundërshtim me kërkesat e pikës 7 të VKM-së së mësipërme.

b. Paketa fiskale e vitit 2019 nuk rezulton e përditësuar me ndryshimet që kërkon VKM nr. 171, datë 27.3.2019. Në kontratat për vitin 2019, sasia e ditëve për të cilat subjektet duhet të paguajnë qira është llogaritur 135 ditë. Sipas përcaktimeve të VKM nr.171, datë 27.3.2019, subjektet duhet të paguanin 153 ditë qira plazhi dhe jo 135 ditë, ndërsa efektet financiare janë llogaritur në auditimin e mëparshëm që KLSH ka zhvilluar pranë Bashkisë Sarandë.
c. Nga një kampion i përzgjedhur rastësor prej 10 kontratash, rezultoi se kontratat nuk përmbanin bashkëlidhur dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për plotësimin e aplikimit, sikurse përcaktohet në nenin 9 të VKM nr.424, datë 27.5.2020. Gjithashtu, databaza e kontratave të plazheve e mbajtur në format elektronik, ka pasaktësi në përcaktimin e sipërfaqeve për disa subjekte dhe gabime në llogaritje, duke mos garantuar informacion të plotë dhe të besueshëm. Në një nga kontratat është konstatuar pasaktësi në llogaritjen e sipërfaqes dhe konkretisht, në kontratën e lidhur me datë 16.07.2020 ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe E D Person fizik, më përfitues Bashkinë Sarandë, është konfirmuar marrja në përdorim e hapësirës së plazhit prej 200 m^2. Ndërkohë, në llogaritjen e vlerës që duhet të paguhet, të bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Sarandë, sipërfaqja e llogaritur është 144 m^2. Llogaritja e pagesës është bërë për një sipërfaqe 56m^2 më pak sesa kontrata, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 42,000 lekë** për buxhetin e NJVV. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **42,000 lekë** nga Personi Fizik **E D** , e cila përbën dëm ekonomik si pasojë e llogaritjes së pasaktë të sipërfaqes.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në vitin 2019 rezulton të jenë paguar 4,391,882 lekë për vendimet gjyqësore si rrjedhojë e dëmshpërblimit të akorduar për largim të padrejtë nga puna të punonjësve. Gati gjysma e këtyre vendimeve i përkasin viteve të mëparshme ndërsa vlera prej 1,969,060 lekë janë vendime të cilët kanë marrë formë të prerë gjatë vitit 2019. Pagesa e dëmshpërblimeve paraqitet në vlerën prej 2,964,509 lekë dhe pjesa tjetër përbëhet nga pagesa e tarifës përmbarimore prej 1,427,373 lekë. Për vitin 2020 vlera e dëmshpërblimeve të paguara për largim nga puna është 950,000 lekë, pa pagesë të tarifës përmbarimore, ndërsa për periudhën janar-shkurt 2021 paraqitet 381,350 lekë. Për vitet 2019-2021/02 evidentohen në total **5,723,232 lekë** efekte financiare negative në buxhet si rezultat i zbatimeve të vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna. Problematika e krijuar evidenton nevojën për qasje institucionale më të kujdesshëm nga nivelet menaxheriale mbi marrëdhëniet e punësimit në vijim. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 31-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Sarandë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore, të nxjerr arsyet, përgjegjësitë për humbjen e tyre dhe të marrë masat e nevojshme për eliminimin e procedurave të parregullta në largimin e punonjësve dhe efekteve negative që këto vendime krijojnë në buxhetin e njësisë vendore.

1.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të ndjekë proceset në të gjitha shkallët e gjykimit duke u kujdesur që të evitohet tarifa e shoqërive përmbarimore e cila rëndon padrejtësisht buxhetin e njësisë vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Rikonstruksion i Ujësjellësit Ksamil (Depo+Rrjeti shpërndarës)-lagja nr.3 dhe nr.4", viti 2020"* rezultoi llogaritje e gabuar e fondit limit. Në këtë procedurë me urdhrin e prokurimit nr. 24 datë 12.10.2020, protokoll ska, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka caktuar një shoqëri private R shpk, për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë tender. Kjo shoqëri ka hartuar projektin përkatës të këtij investimi i cili është përcjell nga Ujësjellës Kanalizimet SHA, Sarandë me shkresën nr. 396/4 prot, datë 16.09.2020. Baza ligjore e përdorur në urdhër është VKM nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave për prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 59 dhe 61 pika 2 e tij. Nga ana e R nuk është hartuar një procesverbal apo akt i cili të përcaktojë fondin limit por në dosje gjendet vetëm një preventiv zbatimi punimesh i ndërtuar bazuar në manualin e punimeve të ndërtimit/2015 me një vlerë fondi limit 131,206,085 lekë. Nëse do ti referohemi relacionit teknik të paraqitur nga R shpk, (në faqen e tij të parë i referohet vitit 2018 ndërsa firma elektronike në fund të materialit mban datën 13.10.2020). Në të përshkruhen llogaritjet e volumeve të projektit të cilat janë dukshëm më të vogla se preventivi i hartuar. Nga auditimi u evidentuan ndryshime në volume lidhur me zërin ñGërmimeò i cili në relacion paraqitet 8,553.5 m3 (7,553.5+1,000) nga të cilat 1,000 m3 paraqitet volumi i depos së ujit, ndërsa në preventiv ky zë punimi paraqitet 11,032 m3 ose 2,478.5 m3 më tëpër në vlerën 2,974,200 lekë pa tvsh. Ndërkohë, zëri ñMbushje me material të gërmuarò paraqitej në relacionin teknik në volumin 5,257.3 m3 ndërsa në preventiv paraqitej 12,230 m3 ose 6,972.7 m3 më tepër në vlerën 3,486,350 lekë pa tvsh. Efekti financiar llogaritet në shumën **6,460,550 lekë.** *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të analizojë procedurën e hartimit në mënyrë të pasaktë të fondit limit për objektin, *"Rikonstruksion i Ujësjellësit Ksamil (Depo+Rrjeti shpërndarës)-lagja nr.3 dhe nr.4"* në vlerën prej **6,460,550 lekë** dhe të nxjerr përgjegjësitë përkatëse.
2.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet një grupi pune me specialist të fushës, të kryej verifikimet e nevojshme mbi punimet e kryera në vepër për zërin ñGërmimeò dhe ñMbushje me material të gërmuarò, të evidentuar nga ana jonë me diferencë midis volumeve të parashikuara në relacionin teknik dhe preventivin e hartuar, duke reflektuar korrigjimet e nevojshme në situacionin përfundimtar.

Brenda datës 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Instalim kamerave të sigurisë në qytet", viti 2019"* rezultuan mangësi në hartimin dhe llogaritjen e fondit limit dhe më konkretisht:
Artikujt e preventivit renditur në numrat nga 17 deri 19 dhe 21-22, nuk gjenden në specifikimet teknike mbi mallrat dhe shërbimin e kërkuar. Preventivi ka të përfshira 60 licenca për kamerat në vlerën 342,000 lekë (Nr. 19) ndërkohë që kamerat nuk paraqesin nevojë për licencim të posaçëm. Po kështu evidentohet se shërbimi i lidhjes në rrjet për 1 vit (nr. 21) përkatësisht 17 lidhje të tilla në vlerën 2,584,000 lekë nuk duhet të ishte pjesë e kësaj procedure në afatgjatë pasi lidhja e rrjetit nëpërmjet internetit mund të ishte i nevojshëm vetëm në fazën e testimit por jo më tej pasi ky shërbim nuk lidhet me investimin por është një shërbim i cili do të prokurohet i ndarë në vijimësi. Në zërin ñMirëmbajtje e kamerave dhe sistemit për një vitò, vlera për 60 kamera është

llogaritur 1,849,980 lekë, ku çmimi për njësi është parashikuar 30,833 lekë ndërkohë që blerja e një nga 44 kamerat B 8MPX është 34,852 lekë pra thuajse sa vlera e mirëmbajtjes për një vit ku kamerat janë prokuruar me një garanci 2 vjeçare. Për këto kamera norma efektive e shpenzimit llogaritet rreth 88% e çmimit të blerjes, vlerë e cila është disa herë më e lartë edhe se amortizimi vjetor i pranuar për pajisjet informatike. Disa nga zërat e përmendur më sipër të cilët kanë qenë të pa përshkruar qartë mund të kenë patur ndikim në mungesën e ofertuesve në këtë procedurë duke kufizuar pjesëmarrjen dhe mos stimuluar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara në hartimin e fondit limit krijojnë efekte financiare negative në buxhet të cilat llogariten në vlerën prej **4,775,980 lekë**. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 54-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të analizojë procedurën e hartimit në mënyrë të paargumentuar të preventivit dhe fondit limit në vlerën prej **4,775,980 lekë** duke nxjerr përgjegjësitë individuale përkatëse.

Menjëherë

3.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masat për hartimin e saktë të preventivit dhe fondit limit bazuar në kriteret teknike dhe ligjore duke garantuar përdorimin me ekonomicitet, efektivitet, dhe efiçencë të fondeve publike.

Në vijimësi

D. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat, nga ana e Bashkisë Sarandë rezultoi se:

a. Për vitin 2019, numri i bizneseve debitorë paraqitet 1,996 subjekte dhe vlera e debisë paraqitet 240,293,817 lekë, ndërsa për vitin 2020 numri i bizneseve debitore është 2,313 subjekte dhe vlera e debisë është 286,286,480 lekë. Debitorët e tatim taksave gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 kanë pësuar rritje. Vlera prej **286,286,480 lekë** për taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, është borxh tatimor i pa mbledhur dhe përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në vlerën më sipër, rritja e debisë në terma bruto për periudhën **vitet 2019** dhe **2020** llogaritet **86,436,484 lekë.**

b. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë, për periudhën nën auditim nuk ka llogaritur në asnjë rast gjoba/kamata për mospagimin në afat të taksave dhe tarifave nga subjektet, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar dhe në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018 ó*Për miratimin e paketës fiskale 2019'*. Kjo Drejtori nuk disponon një databazë analitike të debitorëve, në mënyrë që të llogaritet saktësisht vlera e kamatëvonesave dhe gjobave për secilin debitor, dhe më pas të ndërmerren hapat e mëtejshëm institucional për arkëtimin e tyre.

c. Regjistri i tatimpaguesve nuk paraqet informacion të plotë, pasi nuk paraqet debinë e mëparshme të mbartur të secilit tatimpagues, por vetëm debinë e vitit ushtrimor. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar dhe nuk ndihmojnë për analizat të nevojshme.

d. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH*ò, i ndryshuar, lidhur me mospagimin në afat të detyrimit tatimor, tatimpaguesit duhet të paguajnë gjobë, sikurse përcaktohet në nenin 114 të këtij ligji në vlerën rreth **62,696,739 lekë** gjobë për pagesë të vonuar e llogaritur me 0,06% në ditë të detyrimit, por jo më tepër se 365 ditë, për taksat dhe tarifat vendore të papaguara e cila përbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë. Në këtë vlerë përfshihet dhe gjoba për detyrimin e shtuar në **vitet**

2019 dhe **2020** e llogaritur në vlerën rreth **18,929,590 lekë**.
e. Në paketën fiskale të vitit 2019 të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 07.12.2018, në pikën B.8, përcaktohet se vlera e gjobës për pagesat e vonuara do të jetë 0,05 % të detyrimit për çdo ditë vonesë. Ky përcaktim i paketës fiskale lidhur me moslikuidimin në afat të taksave dhe tarifave, bie në kundërshtim me përcaktimin e nenit 114 ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet vlera e gjobës për pagesat e vonuara 0,06%. Për sa më sipër, Këshilli Bashkiak nuk ka kompetencë të përcaktojë vlera të ndryshme nga ato që janë përcaktuar në ligj.
f. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk rezulton të ketë ndërmarrë masa për arkëtimin e detyrimeve dhe nuk ka zbatuar asnjë masë shtrënguese. Deri në përfundim të auditimit në terren , nga kjo Drejtori nuk është dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Siguruese mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të kërkojë, arkëtimin e vlerave debitore nga bizneset, duke zbatuar sipas rastit edhe masat shtrënguese në zbatim të Kreut XI ñ*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*ò të Ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar. Konkretisht:
-Detyrimet për mospagesën e taksave dhe tarifave **në vlerën 286,286,480 lekë**;
-Gjobat për pagesë të vonuar në vlerën **62,696,739 lekë. (**Kjo vlerë të saktësohet pas llogaritjeve të kryera nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore).

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të llogarisë vlerën e saktë të gjobave për pagesë të vonuar/kamatat për çdo debitor për secilin vit, dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.
1.3 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, të marrë masa për të korrigjuar paketën fiskale aktuale në lidhje me nivelin e gjobave për pagesë të vonuar në shumën 0,05% të detyrimit për çdo ditë vonesë, duke e saktësuar në masën 0,06% e detyrimit, por jo më shumë se 365 ditë referuar kuadrit ligjor në fuqi.
1.4 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, të bashkërendoj veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës (Drejtoria Tatimore Rajonale, Qendra Kombëtare e Biznesit, etj.), dhe të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj. Të zhvillohet korrespondencë e rregullt dhe periodike me QKB-në, QKL-në, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, ZVRPP-në, ALUIZNIN, etj, për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj por edhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura nga Bashkia Sarandë për mbledhjen e të ardhurave nga ana e agjentëve tatimorë dhe rakordimet me ta, rezultoi se:
a. Bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe UKT nuk është efektiv, pasi nuk bëhen rakordime mujore mbi numrin e faturave të lëshuara, numrin e faturave të arkëtuara dhe debitorët, sikurse përcaktohet në akt-marrëveshjet nr. 390 prot, datë 12.02.2019 dhe nr.678 prot, datë 21.02.2020. Bashkia Sarandë informohet vetëm mbi pagesat, të cilat i merr vazhdimisht në mënyrë manuale nga bankat. Drejtoria e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë nuk ka kërkuar nga UKT të dhëna periodike të detajuara, por merr nga bankat vetëm vlerën e arkëtimeve, gjë e cila ka shkaktuar gabime në mbajtjen e të dhënave dhe në pasqyrimin e saktë të situatës lidhur me arkëtimet dhe debitorë e taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimit.

b. Vlera e debisë nga familjarët për taksën e ndërtesës deri në vitin 2020 është 39,384,280 lekë ndërsa për tarifën e shërbimit deri në vitin 2020 është 50,421,939 lekë. Vlera e debisë për këtë taksë e cila në total arrin vlerën prej **89,806,219 lekë** e pambledhur nga agjenti tatimor UKT dhe e pakontabilizuar në regjistrat e Bashkisë Sarandë, përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e kësaj të fundit. Në vlerën më sipër, rritja e debisë në terma bruto, për periudhën **vitet 2019** dhe **2020** llogaritet **50,654,610 lekë.** Gjithashtu konstatohet se, për këta debitorë nuk është aplikuar gjobë për pagesë të vonuar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar. **Vlera 19,667,562 lekë** (89,806,219 lekë x 0.06% x 365=19,667,562 lekë) <u>për pagesë të vonuar e pallogaritur dhe e paarkëtuar, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.</u> Në këtë vlerë përfshihet dhe gjoba për detyrimin e shtuar në **vitet 2019 dhe 2020** e llogaritur në vlerën rreth **11,093,360 lekë.**

c. Përveç agjentëve tatimor të jashtëm, Bashkia Sarandë aplikon mbledhjen e taksës mbi tokën bujqësore nëpërmjet agjentëve të brendshëm, punonjës, të cilët i punëson me kontratë pune 3-mujore. Nga shqyrtimi i procedurës së mbledhjes së kësaj takse, rezulton se lë vend për abuzime dhe gabime operacionale, pasi pagesa iu mblidhet zotëruesve të tokës bujqësore nëpërmjet mandat arkëtimeve të bëra dorazi, dhe më pas paratë derdhen në bankë nga agjenti tatimor. Nga sa më sipër, rezulton se vlera e debisë nga taksa mbi tokën bujqësore është **23,048,008 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë. Kjo vlerë është e pakontabilizuar në regjistrat e Bashkisë Sarandë nga e cila shtesa për **vitet 2019 dhe 2020** paraqitet **8,164,213 lekë**.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>2.1 Rekomandimi:</u> Bashkia Sarandë, të verifikoj gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e ndërtesës, tarifën e shërbimit dhe taksën mbi tokën bujqësore, të kontabilizoj pjesën e pakontabilizuar të këtyre detyrimeve dhe të kërkoj sipas ligjit arkëtimin e vlerave debitore:

-Detyrimet për taksën e ndërtesës në vlerën **39,384,280 lekë;**

-Detyrimet për tarifën e shërbimit në vlerën **50,421,939 lekë;**

-Detyrimet për taksën e tokës në vlerën **23,048,008 lekë.**

-Gjobën për pagesë të vonuar për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit në vlerën **19,667,562 lekë.** (Kjo vlerë të saktësohet pas llogaritjeve të kryera nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore).

<u>2.2 Rekomandimi:</u> Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të llogarisë vlerën e saktë të gjobave për pagesë të vonuar/kamatat për çdo debitor për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit, dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.

<u>2.3 Rekomandimi:</u> Bashkia Sarandë të kryejë rakordime periodike me agjentin tatimor UKT, nëpërmjet të cilit të marrë informacion mbi numrin e faturave të lëshuara, numrin e faturave të arkëtuara dhe debitorët.

<u>2.4 Rekomandimi:</u> Bashkia Sarandë të marrë masa që zotëruesit e tokës të kryejnë pagesën e taksës për tokën bujqësore pranë degëve të bankave dhe jo pagesave me para në dorë nëpërmjet mandat arkëtimeve nga agjentët tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në listën që Bashkia Sarandë dispononte mbi subjektet që tregtojnë hidrokarbure brenda territorit të saj, përmbante 15 subjekte që e ushtrojnë këtë aktivitet dhe të cilëve iu ka përfunduar licenca përpara fundit të vitit 2020.

-Nga kjo listë, vetëm 1 subjekt, óO shpkô ka bërë rinovim të licencës, ndërkohë pjesa tjetër e subjekteve operojnë pa licencë që nga viti 2015, në kundërshtim me nenin 14 të VKM nr.970,

datë 2.12.2015 dhe në kundërshtim me nenin 9 të VKM nr. 344, datë 19.4.2017. Si rrjedhojë, **vlera prej 14,000,000 lekë që duhet të ishte arkëtuar nga rinovimi i licencave, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.** Kjo vlerë është llogaritur në bazë të listës së subjekteve që disponon Bashkia Sarandë e cila nuk rezulton e azhurnuar në terren. Rregullisht, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore duhet të verifikonte në terren nëse subjektet e kësaj liste operojnë aktualisht në treg, kanë mbyllur aktivitetin dhe nuk janë objekt tarifimi, apo nëse ka subjekte të reja të cilat janë hapur dhe duhet të shtohen në këtë listë. Bashkia Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për identifikimin e subjekteve që operojnë pa licencë dhe për arkëtimin e tarifave, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15.1 të VKM nr.970, datë 2.12.2015. Gjithashtu, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh. Në këtë drejtim vihet re një neglizhencë totale nga ana e strukturave përkatëse të Bashkisë Sarandë për kontrollin e këtyre subjekteve lidhur me detyrimet tatimore të cilat kanë ndikime financiare në buxhetin e NJVV. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, pas kryerjes verifikimeve përkatëse, mbi vijueshmërinë e aktivitetit nga këto 14 subjekte për vitet 2019 dhe 2020, duke shfrytëzuar të dhëna të nevojshme nga Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, QKB si dhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, të marrë masa për kontabilizimin e detyrimit dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **14,000,000 lekë (** 1,000,000 lekë/ licencë).
3.2 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, të verifikojë të gjitha subjektet me objekt aktiviteti ñTregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëseò të cilët operojnë në territorin e saj dhe për subjektet të cilët operojnë pa licencë duke kryer pezullimin e aktivitetit të tyre deri në licencimin konform legjislacionit në fuqi.
3.3 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh duke kryer kontrolle të vazhdueshme në terren si dhe duke marrë të dhëna zyrtare nga QKB apo Drejtoria Rajonale e Tatimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Sarandë për investimet publike të prokuruara dhe të realizuara gjatë periudhës vitet 2019 dhe 2020 vetëm në 5 raste nga investimet e kryera në infrastrukturë i ka pajisur me lejen përkatëse, ndërsa në 28 raste të tjera punimesh të situacionuar në vlerën 298,470,231 lekë kjo leje mungon, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, i ndryshuar. Mospajisja me lejet përkatëse për kryerjen e punimeve të ndërtimit krijon precedent të gabuar në veprimtarinë institucionale të Bashkisë Sarandë duke qenë financues i këtyre projekteve por gjithashtu dhe organi i cili duhet të kujdeset për garantimin e mbikëqyrjes dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit. Kjo përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore në fuqi. Evidentohet se, institucioni nuk ka arritur të garantojë një bashkëpunim të brendshëm efektiv midis drejtorive për aq kohë sa investimet e veta kanë mbetur të pa pajisura me leje për kryerjen e punimeve të ndërtimit. Veç aspekteve që lidhen me procesin e mbikëqyrjes së territorit dhe mungesës së koordinimit të brendshëm, kryerja e punimeve të ndërtimit në mungesë të lejes përkatëse të ndërtimit të lëshuar nga autoritetet e fushës, ndikon në mos përfitim të kreditimit të TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e blera në funksion të punimeve të situacionuara nga subjekti

ndërtues i cili nuk duhet të kishte filluar punimet në mungesë të saj. Dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë që kryerja e punimeve pa lejet përkatëse ndikon në mospërfitimin e zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Kreditimi i padrejtë i TVSH-së ul padrejtësisht detyrimet e pagueshme në buxhetin e shtetit nga subjekti ndërtues, të cilat mund të shkojnë deri në 93% të TVSH-së së vlerës së punimeve të faturuara, llogaritur në vlerën **55,515,463 lekë** (298,470,231 x 20% x 93%). *(Trajtuar më hollësisht në faqen 82-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve konstatimin e KLSH-së mbi mungesën e Lejeve të Ndërtimit të veprave infrastrukturore evidentuar në Aneksin nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit me qëllim vlerësimin e detyrimeve tatimore për TVSH-në në shumën e llogaritur prej rreth **55,515,463 lekë** ndaj subjekteve përkatës.

Menjëherë

E.1. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me statuse të parashikuar në ligje të veçanta. Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 ñTë drejtat dhe detyrat e KLSH-sëò, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, nenin 37 ñMasa disiplinoreò të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, ***i rekomandojmë*** **Kryetarit së Bashkisë Sarandë**, që të vlerësojë shkeljet dhe masën disiplinore nga *"Vërejtje"/ "Vërejtje me shkrim"* deri në *"Largim nga puna"/"Largim nga Shërbimi Civil"* për punonjësit si më poshtë:

1. Znj. T S , me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Financiar, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, për shkeljet e konstatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar për vitet 2019, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, mosmarrjen e masave për mungesat inventariale, moszbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparëshme, etj.
2. Z. L B me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në mos evidentimin e subjekteve taksapaguese (fizike/juridikë); mos menaxhim të duhur dhe efikas në drejtim të vjeljes së të ardhurave, kontabilizimit të detyrimeve, ndjekjes së debitorëve, moszbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparëshme, etj.
3. Z. J M në cilësinë e Ish Drejtorit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore (me delegim), për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në mos evidentimin e subjekteve taksapaguese (fizike/juridikë); mos menaxhim të duhur dhe efikas në drejtim të vjeljes së të ardhurave, kontabilizimit të detyrimeve, ndjekjes së debitorëve, moszbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparëshme, etj.
4. Z. P Z , me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit për miratimin të lejes në kundërshtim me dispozitat ligjor në fuqi duke mosrespektuar distancat midis objekteve ndërtimore si dhe mungesë koordinimi për pajisjen e veprave publike me leje ndërtimi.
5. Z. E B në cilësinë e Ish Kryeinspektor në IMT, për mosmarrjen në kohë të masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, moszbatim të Urdhrave të Titullarit nr. 116/1 datë 29.10.2019, nr. 147/1 datë 05.12.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të KLSHò, si dhe mungesën e kontrollit në punimet publike të kryera pa lejen e ndërtimit.

6. Z. G D në cilësinë e Ish Drejtor në Drejtorinë e Policisë, Kontrollit dhe Mbrojtjes së Territorit për mosmarrjen në kohë të masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, moszbatim të Urdhrave të Titullarit nr. 116/1 datë 29.10.2019, nr. 147/1 datë 05.12.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të KLSHò, si dhe mungesën e kontrollit në punimet publike të kryera pa lejen e ndërtimit.
7. Për punonjësit e tjerë, të cilët në Raportin Përfundimtar të Auditimit janë evidentuar me mangësi dhe parregullsi në kryerjen e veprimtarisë administrative, *i rekomandohet* Kryetarit të Bashkisë Sarandë, që nëpërmjet një grupi pune, të vlerësojë shkeljet dhe të nis menjëherë procedurat për dhënien e masës disiplinore përkatëse.

E.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte *"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna"* për punonjësit:
1. Z. A K me detyrë Ish Kryeinspektor në IMT për mosmarrjen në kohë të masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, moszbatim të Urdhrave të Titullarit nr. 116/1 datë 29.10.2019, nr. 147/1 datë 05.12.2019 ñPër zbatimin e rekomandimeve të KLSHò, si dhe mungesën e kontrollit në punimet publike të kryera pa lejen e ndërtimit.
2. Z. G M me detyrë Ish Drejtor në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, për mosmarrjen e masave të nevojshme në zbatim të Vendimit nr. 117 datë 05.11.2019 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për Bashkinë Sarandë si dhe mospërmbushjen e Urdhrit nr. 46 datë 29.05.2020 , ñPër nisjen e procedurave për shpalljen e vendeve vakante, të pozicione të cilat janë pjesë e Shërbimit Civilò.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Sarandë, Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore**, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar.

G. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do të vlerësoj marrjen e masave, nga Bashkia Sarandë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim si dhe atyre të lëna në auditimet e mëparshme por që kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e punës, dhe përmbushjen e objektivave institucional në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçencës së fondeve publike.

V. ANEKSE

Aneksi 1 - "Qasja dhe metodologjia e auditimit"
Aneksi 2- "Mbi Njësinë e Auditimit të Brendshëm"
Aneksi 3 - "Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit"
Aneksi 4 - "Zbatimi i kontratave për punë publike"
Aneksi 5 - "Investimet në infrastrukture dhe Lejet e Ndërtimit"
Aneksi 6 - "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm"
Aneksi 7 - "Mbi ankesat e paraqitura në KLSH"

ANEKSI I
QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Materialiteti
Përcaktimi i materialitetit sipas **sasisë** përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet **deri në 2%** në nivel grupi dhe llogarie.
Një gabim/anomali është ñmaterialò, individualisht ose kur bashkohet me gabime/anomali të tjera, në qoftë se në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojë në vendimet e marra nga drejtimi.

Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material për nga përmbajtja - duke ndikuar kështu në konkluzionet e auditimit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; e megjithatë mbetet në gjykimin e KLSH-së, nëse për raste të veçanta këto parregullsi/gabime do të merren në konsideratë në raportin dhe opinionin e auditimit.

Përcaktimi i materialitetit nga ***ana cilësore*** ñ*Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose nëvarësi të kontekstit të tyre*ò të cilat do të lidhen me përputhmërinë e veprimtarisë së institucionit vlerësohen materiale nga ana cilësore për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e Bashkisë Sarandë.

Vlerësimi i riskut të auditimit
Të kuptuarit e strukturës së kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet, përcaktimi i drejtimeve kryesore të auditimit, Vlerësimin e përgjithshëm mbi ekzistencën dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm me qëllim përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut të njësisë që auditohet.

Fazat:
Njohja e aktivitetit të subjektit me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e riskut të brendshëm.
Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm
Përcaktimi i Riskut të Zbulimit, është risku që audituesi nuk do të arrijë të zbulojë një shmangie, e cila nuk është korrigjuar nga vetë sistemet e kontrollit të brendshëm të subjektit.

KLSH aplikon Modelin e Sigurisë, që tregon se niveli i besueshmërisë rrjedh nga dy burime kryesore që janë: sistemet e kontrollit dhe testet thelbësore.
Si pikënisje shërben risku i brendshëm

Risku i brendshëm (jo i lartë = 0.6 dhe i lartë = 1.0)
Gjykohet dhe vlerësohet që në fazën e planifikimit dhe ushtrimit të auditimit Përputhshmërie, se mund të kemi elementë materialë për vlerësimin e një risku të brendshëm, që lidhet me një nivel të mundshëm të shmangieve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjykohet se ka elementë të ***riskut të brendshëm,*** që lidhen me procesin e vendimmarrjes, organizimin dhe funksionimin, kuadrin rregullator mbi të cilin ushtrohet veprimtaria por dhe madhësisë së saj risku i brendshëm paraprakisht vlerësohet ***Jo i Lartë***.

Risku i Kontrollit të brendshëm (I ulët = 0.15, I mesëm = 0.25, dhe I lartë = 1.0)
Bazuar në të dhënat paraprake kontrolli i brendshëm ekziston dhe ka të ngjarë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme gjatë periudhës nën auditim. Por bazuar në kompleksitetin e operacioneve të subjektit dhe natyrën e kompleksitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigjohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm paraprakisht vlerësohet në nivelin ***I Mesëm***.

Riskut i zbulimit
Duke qenë se KLSH konsideron ***Riskun e Auditimit*** në masën **5%** duke konsideruar një siguri auditimi prej 95% , ***Risku i zbulimit*** i përcaktuar mbi modelin e sigurisë
Bazuar në informacionin paraprak, lidhur me zbatimin e procedurave mbi inventarët, bazës ligjore të përdorur për kryerjen e tyre, një bazë e konsoliduar të cilës i referohet administrata shtetërore, mbikëqyrjen e procesit nga Nëpunësi Autorizues dhe ai Zbatues i kësaj procedure bën që vlerësimi mbi metodën e auditimit të jetë i fokusuar në problematikën e ngritur, me metodë, auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje mbi bazë risku. Kjo për vet faktin se zona e llogarisë është e specifikuar prej problematikës së përcjell për auditim ku rëndësi i jepet edhe gjykimit profesional të audituesit nëse një kontroll i veçuar ose në kombinim me të tjerë, është i përshtatshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti si dhe dokumentacionin shoqërues dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve.

ANEKSI nr.2

Tabela nr. 1: Realizimi i Planeve Vjetore 2019

Institucioni	Auditimet e vitit 2019		Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimit	Sa është dëmi ekonomik i konstatuar, vlerë /lekë
	Të planifikuara	Të realizuara			
Drejtoria Juridike	1	1	I lartë	Përputhshmërie	1,545,000
Klubi i Futbollit ñButrintiò	1	1	I mesëm	Të kombinuara	-
Drejtoria e Burimeve Njerëzore	1	1	I mesëm	Të performances	-
Qendra e Kulturës	1	1	I lartë	Të kombinuara	-
Qendra Ditore Polivalente	1	1	I mesëm	Të kombinuara	1,000
Drejtoria Ekonomike	1	1	I mesëm	Financiare	-
Drejtoria e Taksave	1		I lartë	Përputhshmërie	-
Drejtoria e Urbanistikës	1		I mesëm	Përputhshmërie	-
Gjithsej	**8**	**6**			**1,546,000**

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 2: Realizimi i Planeve Vjetore 2020

Institucioni	Auditimet e vitit 2020		Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimit	Dëmi ekonomik i shkaktuar ne 2020 /lekë
	Të planifikuara	Të realizuara			
Drejtoria E konomike	1	1	I lartë	Përputhshmërie	110,000
Ndërmarrja e Shërbimeve	1	1	I mesëm	Përputhshmërie	-
Drejtoria e Taksave	1	1	I mesëm	Përputhshmërie	71,000
Drejtoria e Shërbimeve	1	1	I lartë	Përputhshmërie	2,412,000
Zyra Ekonomike e Arsimit	1	1	I mesëm	Përputhshmërie	44000
Drejtoria Juridike	1	1	I lartë	Përputhshmërie	-
Shtëpia e Fëmijës	1	1	I lartë	Përputhshmërie	-
Zyra e Politikave dhe Mbështetjes Sociale	1	1	I mesëm	Përputhshmërie	-
Gjithsej	**8**	**8**			**2,637,000**

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 3: Llojet e auditimit të përcaktuar tek plani i NJAB dhe tek programi i angazhimit të auditimit 2019.

Institucioni	Llojet e Auditimeve e vitit 2019 (Plan/ Fakt)	
	Plani i angazhimeve të NJAB	Të realizuara (Verifikim i dosjeve të zgjedhura të auditimit)
Drejtoria Juridike	Përputhshmërie	Përputhshmërie
Qendra e Kulturës	Të kombinuara	Përputhshmërie
Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Të performancës	Përputhshmërie

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 4: Llojet e auditimit të përcaktuar tek plani i NJAB dhe tek programi i angazhimit të auditimit 2020

Institucioni	Auditimet e vitit 2020	
	Plani i angazhimeve të NJAB	Të realizuara (Verifikim i dosjeve të zgjedhura të auditimit)
Drejtoria E konomike	Përputhshmërie	Përputhshmërie
Drejtoria e Shërbimeve	Përputhshmërie	Përputhshmërie
Zyra Ekonomike e Arsimit	Përputhshmërie	Përputhshmërie

Burimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Sarandë

ANEKSI nr.3

Tabela nr. 1: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në varësi, Viti 2019

Programi	Emërtimi	Art	Plani 12 mujorit 2019	Realizimi i 12 mujorit 2019	Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit përfundimtar të vitit 2019
1110	Paga	600	91.220.000	68.956.000	**76%**
1110	Sigurime Shoqerore	601	15.217.000	10.333.000	**68%**
1110	Shpenzime Operative	602	75.668.000	55.097.000	**73%**
1110	Këshilltarët	602	7.000.000	4.118.000	**59%**
1110	Shpenzime për projekte artistike	602			
1110	Shpenzime për këshillin artistic	602			
1110	Fondi i veçantë	606			
1110	Agjent Tatimor	602	2.000.000		**0%**
1110	Projekte me financim nga KE	604	4.000.000	2.698.000	**67%**
1110	Bonus qeraje/ strehimi	602	1.000.000		**0%**
1110	Fond i emergjencave në infrastrukturë dhe emergjencave civile	602	5.000.000	4.586.000	**92%**
1110	Detyrime të prapambetura	602	28.000.000	11.775.000	**42%**
1110	Investime të palikujduara	231	57.000.000	55.325.000	**97%**
1110	Vendime Gjyqësore	604	9.000.000	6.144.000	**68%**
1110	Sport klub Butrinti sh.a	604	14.000.000	14.000.000	**100%**
10140	Mbështetje sociale nga të ardhurat e bashkisë	606			
1110	Fond i Kontigjencës	609	3.000.000		**0%**
1110	Fond Rezervë	609	2.000.000		**0%**
1110	Këshilli I Qarkut	604	2.000.000	1.000.000	**50%**
1110	Investime Aparati	231	139.878.000	117.254.000	**84%**
1110	Investime nga buxheti i shtetit	231	117.546.000	117.546.000	**100%**

1110	**Totali: Menaxhim,Administrim,Planifikim**	**573.529.000**	**468.832.000**	**82%**
4570	**Tot: Investime,Rruge rrjete,Transport**	**107.236.000**	**0**	**0%**
10910	**Tot.: Mbrojtja nga zjarri**	**17.741.000**	**17.020.000**	**96%**
4240	**Tot.: Bordi i kullimit**	**5.966.000**	**2.577.000**	**43%**
4260	**Tot.: Administrimi i pyjeve**	**2.574.000**	**907.000**	**35%**
4980	**Tot.: Çerdhja e femijeve**	**14.411.000**	**12.432.000**	**86%**
6260	**Tot.: Shërbimet publike**	**177.210.000**	**171.653.000**	**97%**
8250	**Tot.: Qendra Kulturore**	**23.149.000**	**20.327.000**	**88%**
9120	**Tot.: Arsimi baze dhe parashkollor**	**78.506.000**	**78.019.000**	**99%**
9230	**Tot.: Arsimi i mesem i përgjithshëm**	**4.543.000**	**4.000.000**	**88%**
9240	**Tot.: Arsimimi profesional**	**14.731.000**	**13.746.000**	**93%**
10410	**Tot.: Kujdesi social**	**7.910.000**	**5.483.000**	**69%**
10430	**Tot.: Kujdesi social nga shteti**	**215.000.000**	**191.872.000**	**89%**
Totali		**1.242.506.000**	**986.868.000**	**79%**

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 2: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në varësi, Viti 2020

Programi	Emërtimi	Art	Plani 12 mujorit 2020	Realizimi i 12 mujorit 2020	Realizimi në (%) i buxhetit vjetor ndaj Planit përfundimtar të vitit 2020
1110	Paga	600	93.720.000	78.124.000	**83%**
1110	Sigurime Shoqerore	601	15.717.000	13.088.000	**83%**
1110	Shpenzime Operative	602	72.270.000	60.464.000	**84%**
1110	Këshilltarët	602	7.400.000	4.976.000	**67%**
1110	Shpenzime për projekte artistike	602	9.250.000		**0%**
1110	Shpenzime për këshillin artistic	602	270.000		**0%**
1110	Fondi i veçantë	606	1.000.000	252.000	**25%**
1110	Agjent Tatimor	602	5.000.000	4.452.000	**89%**
1110	Projekte me financim nga KE	604	4.000.000		**0%**
1110	Bonus qeraje/ strehimi	602	1.000.000	864.000	**86%**
1110	Fond i emergjencave në infrastrukturë dhe emergjencave civile	602	9.000.000	8.925.000	**99%**
1110	Detyrime të prapambetura	602	25.000.000		**0%**
1110	Investime të palikujduara	231			
1110	Vendime Gjyqësore	604	10.000.000	5.850.000	**59%**
1110	Sport klub Butrinti sh.a	604	19.500.000	19.500.000	**100%**
10140	Mbështetje sociale nga të ardhurat e bashkisë	606	5.000.000	1.824.000	**36%**
1110	Fond i Kontigjencës	609	3.000.000		**0%**
1110	Fond Rezervë	609	2.000.000		**0%**
1110	Këshilli I Qarkut	604	2.000.000	1.000.000	**50%**
1110	Investime Aparati	231			
1110	Investime nga buxheti i shtetit	231			
1110	**Totali: Menaxhim,Administrim,Planifikim**		**285.127.000**	**199.319.000**	**70%**
4570	**Tot: Investime,Rruge rrjete,Transport**		**451.499.000**	**187.841.000**	**42%**

10910	Tot.: Mbrojtja nga zjarri	17.743.000	17.236.000	97%
4240	Tot.: Bordi i kullimit	5.966.000	2.833.000	47%
4260	Tot.: Administrimi i pyjeve	2.372.000	2.054.000	87%
4980	Tot.: Çerdhja e femijeve	15.211.000	12.152.000	80%
6260	Tot.: Shërbimet publike	174.410.000	128.530.000	74%
8250	Tot.: Qendra Kulturore	23.536.000	18.914.000	80%
9120	Tot.: Arsimi baze dhe parashkollor	80.913.000	69.136.000	85%
9230	Tot.: Arsimi i mesem i përgjithshëm	4.543.000	3.235.000	71%
9240	Tot.: Arsimimi profesional	14.596.000	9.245.000	63%
10410	Tot.: Kujdesi social	3.810.000	3.233.000	85%
10430	Tot.: Kujdesi social nga shteti	215.000.000	229.350.000	107%
Totali		1.294.726.000	883.078.000	68%

Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 3: Vendimet gjyqësore për largimet nga puna viti 2019

Burimi: Drejtoria Juridike, Bashkia Sarandë

Tabela nr. 4: Vendimet gjyqësore për largimet nga puna viti 2020

Nr	Emertimi	Tipologjia	Vendimi Gjykates se Apelit ose te Larte		2020		
			Nr	**Date**	Shtesa 2020	Likujdime 2020	Vlera e mbetur per vitin pasardhes
1	I	Largim nga sherbimi civil	510	12.03.2015		500,000	-
2	M	Largim nga sherbimi civil	193	25.01.2018			-
3	A	Largim nga sherbimi civil	20-2016-870/522	06.09.2016			-
4	B	Demshperblim per pushim te padrejte nga puna	3568	11.10.2018			150,000
5	A	Demshperblim per largim nga puna	Vgjat nr 4550 date 13.12.2018				-
6	A (30.03.2018 deri 31.05.2019)	Demshperblim per largim nga puna	Vgja nr.30.03.2018			450,000	231,350
7	R	Pagese tarife permbarimore	Vgj.a nr 252 date 02.05.2018				-
8	K	Pagese tarife permbarimore	Vgj.a nr 252 date 02.05.2019				-
9	J	Pagese tarife permbarimore	Vgja nr 74 date 7.02.2018				-
10	L	Pagese tarife permbarimore					-
11	P	Pagese tarife permbarimore					-
12	T	Pagese tarife permbarimore	Vgjaat nr 305 date 05.02.2019				-
13	A	Pagese tarife permbarimore	Vgjs nr 23-2019-266 date 20.02.2019				-
14	T	Pagese tarife permbarimore	Vgjaat nr 305 date 05.02.2019				-
15	F	Pagese tarife permbarimore	Vgja 909 date 06.07.2018				-
16	A	Pagese tarife permbarimore					-
17	E	Pagese tarife permbarimore	Vgjagj nr 239 date 07.05.2019				-
		TOTALI			**-**	**950,000**	**381,350**

Burimi: Drejtoria Juridike, Bashkia Sarandë

ANEKSI nr.4
Mbi prokurimet Publike

-Zbatimi i kontratave për punë publike.

Tabela nr. 4.4.1. Kontrata për punë publike të realizuara për vitin 2019

Nr	Objekti prokuruar	Fondi limit pa TVSH në leke	Kontrata me OE fitues		Operatori fitues	Vlera e plote sipas kontrates	Real i kontratës
			Nr/ datë	Vlera pa TVSH në lekë			
1	Rehabilitim rrugesh dhe rikualifikim pjesor rrugesh ne Sarande dhe Ksamil	5,557,550	01.07.2019	5,557,550	**A**	6,669,060	100%
2	Instalime elektrike ne Shkollen 9 tetori dhe Ksamil	8,105,460	10.06.2019	8,105,460	**A**	9,726,552	100%
3	Ndricim rrugor ne rrugen Shen gjergji dhe fshatin Cuke	2,719,280	06.05.2019	2,719,280	**A**	3,263,136	100%
4	Sistemim rruge te brendshme fshati Gjashte	2,533,113	25.06.2019	2,533,113	**J**	3,039,736	100%
5	Ndertim segment rrugor Bugenville- Eko kampus	7,130,913	01.07.2019	7,130,913	**A**	8,557,096	100%
6	Investime ne kende lojrash dhe sistemime me beton ne lagjet 1,2,3,4	11,802,850	10.06.2019	11,802,850	**M**	14,163,420	100%
7	Rikonstruksion I rruges Dea Ksamil	3,737,664	26.06.2019	3,737,664	**J**	4,485,197	100%
8	Hidroizolimi pjesor I godines bashkise,institucione arsimore(shkolla 9 tetori,shkolla Metoq) dhe shkalle emergjente ne Çerdhe	1,807,360	25.10.2019	1,807,360	**I**	2,168,832	100%
9	Shkalle lidhese ndermjet rrugeve ne lagjen nr 2 dhe sistemime ne ambjente publike	3,029,500	01.07.2019	3,029,500	**I**	3,635,400	100%
10	Riparim I sistemit KUB ne Ksamil e Sarande	4,947,865	27.11.2019	4,947,865	**E**	5,937,438	100%
11	Shtrim me beton rruga Baba sherif, i.Qemali, Adria dhe rruge te brendshme	13,784,076	10.06.2020	13,784,076	**E**	16,540,891.2	100%
	Shuma 2019	**65,155,631**	**-**	**65,155,631**	**-**	**78,186,757**	100%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e prokurimeve në Bashkinë Sarandë

Tabela nr. 4.4.2. Kontrata për punë publike të realizuara për vitin 2020

Tabela nr. 2. Kontrata për punë publike të realizuara për vitin 2020

Nr	Objekti prokuruar	Fondi limit pa TVSH në leke	Kontrata me OE fitues		Operatori fitues	Vlera e plote sipas kontrates	Real i kontratës
			Nr/ datë	Vlera pa TVSH në lekë			
1	Riparim i sistemit KUB ne Lagjen Nr.3	4,519,848	26.05.2020	4,519,848	**N**	5,423,817.00	100%
2	Ndertimi i rruges se "Arbrit" ne Koder	5,250,000	18.05.2020	5,099,460	**J**	6,119,352.0	100%
3	Qendra sociale ne funksion te rehabilitimit te femijeve me aftesi ndryshe	4,166,667	28.09.2020	4,062,660	**S**	4,875,192.0	100%
4	Riveshje me asfalt i rrugës "Idriz Alidhima"	8,333,333	20.06.2020	8,075,400	**A**	9,690,480.0	100%
5	Rikualifikim trotuari te kryqezimi I rr.Mithat HOXHA me rr.Jonianet	2,087,430	10.08.2020	2,000,000	**E**	2,400,000.0	100%
6	Rruge te brendshme, lirim sheshesh dhe kende lojrash ne Sarande	3,333,333	05.08.2020	3283533	**J**	3,940,239.6	100%
7	ñRiparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bank - Kopështi -Kështjella Ksamilò	12,000,000	06.07.2020	11,771,440	**E**	14,125,728.0	100%
8	Sinjalistika horizontale dhe vertikale	5,833,333	22.06.2020	5635500	**S**	6,762,600.0	100%
9	Rehabilitimi i shëtitores në Ksamil	3,821,000	24.08.2020	3,821,000.0	**A**	4,585,200.0	100%
10	ñInvestime në lagjet e qytetit, kënd lojnash , sistemim ndriçim Lagj nr.1,2,3,4 dhe periferia Sarandëò	37,100,008	16.09.2020	37,100,008	**M**	44,520,009.6	Kontratë në Proces 2021
11	Hidroizolim i godinës së bashkisë dhe restaurimi i fasadës	6,083,333	19.01.2020	5,536,435.0	**N**	6,643,722.0	100%
12	Ndërtim stacionesh për autobuzat interurbane	4,140,000	05.10.2020	4,140,000	**S**	4,968,000.0	100%
13	ñInvestime në infrastrukturën arsimore në shkollën 9 vjeçare " 9 Tetori"ò	3,816,000	05.10.2020	3,816,000	**O**	4,579,200.0	100%
14	Ndërtim rrugor ne rrugen Shen Gjergji fshati Gjashte	3,678,702	19.10.2020	3,678,701.67	**I**	4,414,442.0	100%
15	Riparimi i sistemit KUZ në Lagjet e Sarandës	3,065,602	28.10.2020	3,065,602	**E**	3,678,722.0	100%
16	Shtrimi me beton i rrugës tek kryqëzimi i shkollës Gjashtë, shtrim dhe rehabilitim rrugësh të brëndshme të Gjashtës ,Lekurës me ndriçimò	10,000,000	02.11.2020	9,892,595	**E**	11,871,114.0	Kontratë në proces 2021
17	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ksamil, pjesa e I	**27,381,839**	**--**	**27,381,839**	**A**	32,858,206.8	Kontratë në proces

							2021
18	Rikonstruksion i ujësjellësit Ksamil(Depo+Rrjeti shpërndarës-lagja nr.3 dhe nr.4	**131,208,333**	**27.11.2020**	**131,133,987**	**C shpk**	157,360,784.0	Kontratë në proces 2021
19	Ndërtim i tualeteve publike tek Tregu Industrial, Sarande	2,916,667	-	2,808,512	**I**	3,370,214.4	Kontratë në proces 2021
20	Sistemim i ujërave të shiut tek lagja Burimi Metoq	2,013,808	01.12.2020	1,636,005	**I**	1,963,206.0	Kontratë në proces 2021
21	ñRrugë të brendshme me beton në fshatin Shelegar, Berdeneshdhe Manastirò	2,666,667	10.12.2020	2,623,158	**D**	3,147,790.0	Kontratë në proces 2021
22	Riveshje pjesë të dëmtuara me asfalt në rrugët e Sarandës	3,350,000	04.12.2020	3,350,000	**J**	4,020,000.0	Kontratë në proces 2021
23	Rivitalizimi i infrastrukturës rrugore në Lagjen Nr.1	5,833,333	15.12.2020	5,769,400	**A**	6,923,280.0	Kontratë në proces 2021
	Shuma 2020	**292,599,236**	**-**	**290,201,083**		**348,241,299.40**	

Burimi i të dhënave: Drejtoria e prokurimeve në Bashkinë Sarandë

ANEKSI nr.5
Investimet në infrastrukture dhe Lejet e Ndërtimit

Në lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Pagesa progresve deri me 31.12.2019	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	Hidroizolim pjesor godina e Bashkisë,institucioneve arsimore , shkolla ñ9-Tetoriò,shkolla Metoq dhe shkallë emergjence në çerdhe	**1,807,360**	I	J
2	Instalime elektrike shkolla ñ9-Tetoriò dhe shkolla Ksamil	**8,105,460**	A	J
3	Investime në Konviktin e Shkollës së Mesme	**3,015,150**	M	J
4	Investime në lagjet e qytetit, kënde lojrash ,rrugë betoni ,sistemim ndriçimi lagja nr.1,2,3,4 dhe periferia Sarandë.	**11,802,850**	M	J
5	Ndërtimi i segmentit rugor ndërmjet Bugenville dhe Eko - Kampus.	**7,130,912**	A	J
6	Ndiçim në Berdenesh dhe Manastir	**1,459,675**	L	L
7	Ndriçim rrugor tek Rruga ñShën Gjergjiò dhe rrugë betoni fshati Çukë	**2,718,280**	A	J
8	Rehabilitim rrugësh dhe rikualifikim pjesor me asfalt në Sarandë & Ksamil.	**5,357,550**	A	J
9	Rikonstruksion i rrugës ñDEAò Ksamil.	**3,737,664**	J	J
10	Rikontruksion i rrugës ñSabri Prevezaò tek Parku	**4,616,073**	A	J
11	Riparimi i sistemit KUB në Sarandë dhe Ksamil	**4,947,865**	E	J
12	Shkallë lidhëse ndërmjet rrugëve në lagjen 2, dhe sistemime ambientesh publike.	**3,029,500**	I	J
13	Shtrim me beton rruga ñBaba Sherifiò, rruga ñIsmail Qemaliò ,rruga ñIbrahim Rugovaò, rruga ñAdriaò dhe rruge të brendshme	**13,784,076**	E	K
14	Sistemim rrugë të brëndshme me beton të fshatit Gjashtë.	**2,533,113**	J	J
	Shuma Viti 2019	**74,045,528**		

Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë

Në lekë

Nr.	Objekti i Prokurimit	Pagesa progresve deri me 31.12.2020	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	NIPT i Operatorit Ekonomik
1	ñInvestime në infrastrukturën arsimore në shkollën 9 vjeçare " 9 Tetori"ò	3,816,000	O.	K
2	ñInvestime në lagjet e qytetit, kënd lojnash , sistemim ndriçim Lagj nr.1,2,3,4 dhe periferia Sarandëò	37,100,008	M	J
3	ñRrugë të brendshme me beton në fshatin Shelegar, Berdeneshdhe Manastirò	2,623,411	D	J
4	Hidroizolim i godinës së bashkisë dhe restaurimi i fasadës	5,536,435	N	K
5	Ndërtime stacione vendqëndrimi për autobuzat interurbane	4,140,000	S	K
6	Rehabilitimi i shëtitores në Ksamil	3,821,000	A.	J
7	Rikonstruksion i ujesjellesit Ksamil(Depo+Rrjeti shperndares-lagja nr.3 dhe nr.4	131,133,986	C	J
8	Rikualifikim trotuari te kryqëzimin i Rr. Mithat Hoxha me Rr. Jonianët	2,000,000	E	K
9	Riparim dhe veshje me asfalt të rrugës Tirana Bank - Kopështi -Kështjella Ksamil	11,771,440	E	K
10	Riparimi i sistemit KUZ në Lagjet e Sarandës	2,053,590	E	J
11	Riveshje me asfalt i rrugës ñIdris Alidhimaò	8,075,400	A	J
12	Riveshje pjesë të dëmtuara me asfalt në rrugët e Sarandës	3,300,500	J	J
13	Rivitalizimi i infrastrukturës rrugore në Lagjen Nr.1	5,769,400	A	J
14	Rrugë të brëndshme , lirim sheshesh dhe kënde lojrash në Sarandë	3,283,533	J	J
	Shuma Viti 2020	**224,424,703**		
	VLERA E PUNIMEVE tE KRYERA GJITHSEJ 2019+2020	**298,470,231**		

Burimi i të dhënave: Bashkia Sarandë

ANEKSI nr.6

Mbi ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH rezultoi se:
Auditimi i mëparshëm në subjektin ñBashkia Sarandëò është kryer sipas programit të auditimit nr. 365/1 datë 28.05.2019, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 30.06.2019. Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 365/7 prot. datë 27.09.2019.
-Në vijim, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna pranë ñBashkisë Sarandëò, është kryer me auditimin tematik të KLSH-^{së}, referuar programit të auditimit nr. 610 prot, datë 25.06.2020 ku është ri-kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve e gjetura me status i pazbatuar apo në proces zbatimi. Raporti Përfundimtar i Auditimit mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna dhe shkresa përcjellëse, janë administruar në Bashkinë Sarandë me nr. 5229 prot datë 07.12.2020.

Ecuria e zbatimit të rekomandimeve paraqitet paraqitet si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1. Gjetje nga auditimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), është ngritur për vitet 2017-2018 si dhe janë realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin, por nuk ka raportime të dokumentuara për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò *(Trajtuar hollësisht në pikën (A), faqen 34-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.1 <u>Rekomandimi</u>: Nëpunësit Autorizues dhe struktura e Auditit të Brendshëm, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Kryerja e raportimeve te dokumentuara për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të dokumentohen dhe arkivohen që ato të ndihmojnë konkretisht për përmirësimin e punës dhe uljen e risqeve në punë.

<u>-Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave, nuk është hartuar regjistri i riskut si dhe nuk është përcaktuar koordinatori i riskut.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
- <u>Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, në bazë të ligjit nr.</u>10296, datë 08.07.2010"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 9 dhe 10, si dhe Udhëzimit nr.16, datë 25.07.2016 "Mbi përgjegjësitë dhe detyrat e Kordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kordinatorit të Riskut në Njësitë Publike", me Urdhër nr.139, datë 30.09.2020, ***ka caktuar Kordinatorin e Riskut për Bashkinë Sarandë,*** *ku ngarkohet për zbatimin e detyrave që rrjedhin nga legjislacioni përkatës. Drejtoria e Auditit të Brendshëm gjatë hartimit të Planit Strategjik dhe Vjetor, harton dhe ben Vlerësimin e nivelit të riskut për të gjithë subjektet që duhet të*

auditohen nga NjAB, bashkëgjitur planeve të hartuar dhe derguar në Drejtorinë e Harmonizimit për AB.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Për periudhën deri më datë 31.12.2020 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ôPër përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike. ôTitullari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet Urdhrit nr. 139, datë 30.09.2020 ka caktuar kordinatorin e riskut për Bashkinë Sarandë, Znj. L . Në këtë rast, përgjegjësinë e koordinatorit të MFK dhe të riskut, e ka nëpunësi autorizues, i cili është Z. i caktuar nëpërmjet shkresës nr. 3004 prot, datë 23.07.2020 dhe është ai që duhet të delegojë disa prej detyrave, dhe jo Titullari. Për më tepër, nuk mund të delegohen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë, por sikurse përcakton ligji, disa prej tyre. Në urdhrin e caktimin të koordinatorit të riskut, nuk përcaktohen se cilat nga detyrat janë deleguar. (trajtuar më hollësisht në pikën nr. 1 *Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin).*

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

2.2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Sarandë nuk është aplikuar një sistem i përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar. Në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Sarandë janë është përcaktuar qartë mënyra menaxheriale dhe përgjegjësit e punonjësve, si dhe raportimi i tyre ne mënyrë periodike. të kontrollit, në zbatim sipas nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, për përcaktimin menaxheriale dhe përgjegjësitë, sipas parashikimeve të nenit 9 të këtij ligji, për periudhën objekt auditimi *(Trajtuar hollësisht në pikën A, faqen 34-39, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialit të fushës të hartojë rregulloren e re të funksionit të Bashkisë Sarandë, duke ju përshtatur organizmit të ri që ka pësuar kjo njësi vendore, pas riorganizimit të bashkive, duke përcaktuar qartë mënyra menaxheriale dhe përshkrimet e detyrave për çdo vend pune, përgjegjësit e punonjësve, si dhe raportimi i tyre ne mënyrë periodike në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe dispozitave në fuqi.

-Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Në zbatim të Urdhrit nr. 1641 prot, datë 14.05.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores së funksionimit të brendshëm Administrativ" të Bashkisë Sarandë dhe institucionet në varësi. Aktualisht nga grupi i punës na u relatua se janë në fazë përfundimtare, pra nga drejtorit përkatëse është hartuar drafti por ende nuk ka kaluar në këshillin bashkiak për miratim.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Grupi i punës për hartimin e Rregullores së Funksionimit Administrativë të Bashkisë dhe Njësive të Varësisë, ngritur sipas Urdhrit të mesipërm, ka mbaruar Draft Rregulloren dhe në mbledhjen e rradhës të Këshillit të Bashkisë do kalojë për miratim.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Institucioni ende nuk disponon rregulloren e brendshme megjithëse ky dokument ka një rëndësi të lartë jo vetëm për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive individuale por dhe përrmbushjes së fuknsioneve publike.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

3.7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt *"Pastrim dhe largim i mbetjeve, viti 2018*ò, u konstatua se Bashkia Sarandë ka realizuar 4 shtesa kontrate me po të njëjtin OE dhe konkretisht:
1. Kontrata nr. 4/1, datë 13.03.2018, për periudhën e mbulimit me shërbim nga data 13.03.2018 deri më 24.05.2018 (73 ditë punë) për vlerën prej 6,616,965 lekë, ose **7,940,358 lekë me TVSh**.
2. Kontrata nr. 4/2, datë 26.05.2018, për periudhën e mbulimit me shërbim nga data 26.05.2018 deri më 06.08.2018 (73 ditë punë) për vlerën prej 9,857,215 lekë, ose **11,828,658 lekë me TVSh**.
3. Kontrata nr. 4/3, datë 07.08.2018, për periudhën e mbulimit me shërbim nga data 07.08.2018 deri më 18.10.2018 (73 ditë punë) për vlerën prej 7,821,715 lekë, ose 9,386,058 lekë me TVSh.
4. Kontrata nr. 26, datë 07.10.2018, lidhur nga Bashkia Sarandë përfaqësuar nga ish-Kryetarja zj. F dhe Sipërmarrësi shoqëria ñK ò, përfaqësuar nga Administratori z. M për periudhën e mbulimit me shërbim nga data 19.10.2018 deri më 31.12.2018 (74 ditë punë) për vlerën prej 7,094,000 lekë, ose 8,512,800 lekë me TVSh.
Në total të 4 kontratat kapin vlerën prej **31,389,895 lekë pa TVSh/ ose 37,667,874 lekë me TVSh**, pra të katër kontratat në total janë sa 84% e vlerës totale të kontratës fazë/fillestare, nr. 4, datë 13.03.2017, me afat nga data 13.03.2017 deri më 12.03.2018 (365 ditë), për vlerën prej 37,451,650 lekë ose 44,941,980 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me pikën ñc*",* pika 3/b, pika 5/b*,* si dhe pika 5/b/ii/b*,* si dhe nenit 36 pika ñcò *"Procedura me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës",* Kreun IX ñEkzekutimi dhe mbikëqyrja e Kontratësò, neni 76 ñKohëzgjatja e kontratësò, pika 4,5 dhe 6, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 402, DATË 13.05.2015, me vendimin nr. 823, datë 23.11.2016 me vendimin nr. 797, DATË 29.12.2017 dhe me vendimin nr. 80 datë 14.2.2018ò. *(Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqe 146-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.7.1. <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, Drejtorinë e Shërbimeve Bashkia Sarandë dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve publike, të marri masa për planifikim në kohë të tenderit për pastrimin e qytetit të Sarandës dhe Njësisë administrative Ksamil, me qëllim mos krijimin e precedentit për shmangie nga procedurat e prokurimit, më shumë se një herë të shtesës prej 20% të kontratës së mëparshme.
Kryetari i Bashkisë Sarandë, duke qenë se njësia që drejton ka shtrirje vogël territoriale të vlerësojë mundësinë e realizimit të shërbimit të pastrimit me Ndërmarrjen e Shërbimeve, kjo edhe në formën e një projekti pilot të aplikuar fillimisht në disa fshatra apo zonën e Ksamilit.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Procedura e prokurimit është zhvilluar në kohën e duhur, por për shkak të ankesave është pezulluar nga KPP. (Bashkëlidhur dokumentacionin përkatës).

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Në proces zbatimi

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Janë marrë masa nga Njësia e Prokurimit që në vazhdimësi procedura e prokurimit për pastrimin të zhvillohet normalisht konformë legjislacionit. Akoma nuk kemi mundësi që pastrimin e qytetit ta kryejmë më mundësitë tona.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Nisur nga ecuria e procedurave të prokurimit mbi pastrimin e qytetit, kostove dhe problematikave të tjera evidentuara edhe në auditimet e KLSH sa i përket planifikimit në kohë dhe eleminimin e shtesë

kontratave, rezulton se, procedurat për këtë shërbim nuk kanë arritur të përmbushen në kohë, përmendim këtu zgjatjen e periudhës së kontraktimit nga data 13.03.2020 në të cilën ka përfunduar kontrata e parë në 23.11.2020 në të cilën është lidhur kontrata e re. Ndërkohë që rekomandimi i lënë mbi zhvillimin e një projekti pilot krijon hapësirë për mirëmenaxhim fondesh si dhe për një shërbim më cilësor.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

4.9. Gjetje nga auditimi: Për dy vitet ushtrimore 2017-2018 llogaria 202 ñ*Studime dhe Kërkime*ò paraqitet me të njëjtën gjendje në vlerën 14,433,919 lekë, kjo vlerë e cila i përket 112 projekt-studimeve nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ñAneksi 1 Pika 2 Klasa 2,me VKM nr 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò, Seksioni II ñAktivet Qëndrueshme Patrupëzuaraò Pika 1/b ñKlasifikimi kontabëlò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqe 63-101 dhe aneksin nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.9.1.<u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke krediturar llog. 202 ñ*Studime dhe Kërkime"* dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

<u>-Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi në mbyllje të pasqyrave financiare llog. 202 "Studime dhe Kërkime" paraqitet në vlerën 23,441,536 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 1372 prot, datë 23.04.2020, dërguar degës së thesarit Sarandë.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Vlera e projekteve prej 14.433.919 lekë është e mbartur prej vitesh dhe nuk mund ti bashkohet vlerës së aktivit , pasi janë projekte të para dhjetë e me shumë viteve dhe vlera e tyre është amortizuar.Në vazhdimësi, për projektet që do të zbatohen rishtaz, do të ndiqet procedura e rekomanduar nga grupi i Klsh-së.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Pavarësisht periudhës së gjatë të mbartjes, këto vlera duhet të jenë objekt rregullimi sa kohë që ato përmbushin kushtet për regjistrimin në këtë zë të kontabilitetit.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

5.10. Gjetje nga auditimi: Në vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) të klasës 21 për vitin 2017 në vlerën 3.356.915.085 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 3,766,275,808 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar në mënyrë të sintetizuar të gjitha shtesat dhe pakësimet. Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat financiare kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve

kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30. *(Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqe 63-101 dhe aneksin nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.10.1.<u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit**,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

*<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa realizuar pasi nga Drejtoria Ekonomike nuk është krijuar një regjistër analitik aktivesh sipas formatit**,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.*

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në Drejtorinë Ekonomike ka rregjister Aktivesh analitike për ato aktive që janë të veçanta, ndersa për sa i përket aktiveve që janë të përbera nga grup zerash materialesh dhe punimesh të të njëjtës natyrë, përfshi edhe shërbime, nuk mund të inventarizohen ze për ze, por në një aktiv me një emërtim të vetëm, atë me të cilin është berë Akt-Marja në dorezim dhe Akt-Kolaudimi në menyrë sintetike. Në vazhdimësi do të ndiqën rekomandimet e Klsh-së për evidentimin në rregjistër të gjithë zerave të aseteve.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Nga ana e Bashkisë Sarandë nuk rezulton të jetë përmbushur rekomandimi i lënë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

6.12. Gjetje nga auditimi: KLSH konstaton se në llogarinë 404 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to (për investime)*ò nuk është kontabilizuar vlera prej 58,774,022 lekë, që përfaqëson faturat e palikujduara në fund të vitit 2018 për investime të financuara nga të ardhurat (e analizuar sipas tabelës të paraqitur në aneks). Gjendja tepricë e kësaj llogaritje për vlerën prej 58,774,022 lekë nuk është përfshirë në gjendjen tepricë të llogarive 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò të paraqitura në bilanc, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion jo real kontabël në mbyllje të PF të vitit 2018 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 *(Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqe 63-101 dhe aneksin nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.12.1. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të kryejë veprimet e kontabilizimit në rastet e kryerjes së investimeve në momentin e mbërritjes së faturës dhe çeljes së fondeve, për njohjen dhe realizimin e investimeve, duke prekur llogaritë përkatëse në mënyrë që në fund të vitit të ushtrimor të paraqiten në bilanc detyrimet reale ndaj të tretëve në llogaritë e detyrimeve.

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Nuk janë kryer veprime sipas rekomandimeve të KLSH-së, për pasojë ky rekomandim do të konsiderohet i pa realizuar.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Në proces zbatimi

Komente nga subjekti i audituar:
Vlera e investimeve të palikujduara deri në fund të vitit 2018, të cilat u planifikuan dhe u likujduan në vitin ushtrimor 2019 nuk mund të kontabilizohen në 2019. Përsa i përket faturave të palikujduara për investimet e krijuara gjatë vitit 2019 u kontabilizuan në llogarinë 467"kreditor të ndryshëm" në shumën 21.967.000 lekë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Ky rekomandim do të jetë objekt verifikimi për pasqyrat financiare për vitin 2020 që do të hartohen nga institucioni.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

7.13. Gjetje nga auditimi: Për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018 nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo projekte investimesh për vlerë të plotë të kontratës, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur ndërhyn pagesa. Kështu nuk janë bërë regjistrimet kontabël në llog. 231 ñShpenzime për investime për aktive afatgjata materialeò për 19 kontrata në vlerën 71,609,194 lekë të financuara nga të ardhurat dhe për 6 kontrata në vlerën 944,867,923 lekë të financuara nga FZHR, pra nuk janë kryer në kohën e krijimit të detyrimit për tôu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, duke rënduar gjendjen financiare të Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò Kapitulli I, pika 1. Me dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 *(Trajtuar më hollësisht në pikën (C) faqe 63-101 dhe aneksin nr.5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.13.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi në mbyllje të pasqyrave financiare llog. 231 "Shpenzime për investime për aktive afatgjata materiale" paraqitet në vlerën 0 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 1372 prot, datë 23.04.2020, dërguar degës së thesarit Sarandë.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Ky rekomandim është në proces pasi për vitin 2020 kontabilizohen kontratat dhe në bilancin e vitit 2020 do të pasqyrohen detyrimet e palikujduara ndaj të tretëve.
Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Ky rekomandim do të jetë objekt verifikimi për pasqyrat financiare për vitin 2020 që do të hartohen nga institucioni.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

8.15. Gjetje nga auditimi: Nga testimi i kontratave të investimeve rezultoi se: për 19 kontrata në vlerën 71,609,194 lekë të financuara nga të ardhurat dhe për 6 kontrata në vlerën 944,867,923 lekë, financuara nga FZHR, kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura për blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e pagesave për fatura të mbërritura. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, pra as në momentin e mbërritjes së faturës dhe as të çeljes së fondeve. Pra regjistrimet kontabël janë kryer në momentin e kur është kryer pagesa dhe jo në kohën e lindjes të një detyrimi për tâu paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, duke rënduar gjendjen financiare të Bashkisë.
Ky konstatim vlen për të gjitha rastet e lidhjes së kontratave me të tretët, të cilat nuk janë evidentuar në kontabilitet në vlerë të plotë, duke mos paraqitur vlerën e plotë të detyrimeve të lindura nga angazhimet financiare të krijuara nga lidhja e kontratave me të tretët, veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël òKapitulli I, pika 1. Me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.15.1 <u>Rekomandimi:</u> Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar nga lidhja e kontratave të lidhura dhe jo thjesht kur ndërhyn pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.
<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim është i pa zbatuar

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Ky rekomandim është në proces pasi për vitin 2020 kontabilizohen kontratat dhe në bilancin e vitit 2020 do të pasqyrohen detyrimet e palikujduara ndaj të tretëve.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Ky rekomandim do të jetë objekt verifikimi për pasqyrat financiare për vitin 2020 që do të hartohen nga institucioni.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

9.16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 130 lejeve zhvillimore, mbi verifikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, aplikimin e tarifave për shërbim si dhe gjobave për shkelje të lejes, u konstatua se në **25 raste** nuk janë aplikuar penalitetet për vënie në përdorim të objektit, pa u pajisur me parë me leje përdorimi nga Bashkia Sarandë, për vlerën prej **7,500,000 lekë** *(vlera minimale e gjobës të përcaktuar ligjërisht 25 x 300,000 lekë)* ose 12,500,000 lekë *(vlera maksimale e gjobës 25 x 500,000 lekë)*, duke krijuar mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë, veprime në

kundërshtim me nenin neni 40, shkronja ñfò të ligjit nr. 107, datë 31.04.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar *(Trajtuar hollësisht në pikën (B/1.5) faqen 60-62, të Raport Auditimit).*

9.16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, të marrë masa për aplikimin dhe arkëtimin e vlerës së gjobave të 25 rasteve në vlerën **7,500,000 lekë,** për vënie në përdorim të objektit, pa u pajisur me parë me leje përdorimi nga Bashkia Sarandë.

*- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit nuk është kryer asnjë procedurë ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të 25 rasteve në vlerën **7,500,000 lekë.***

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:

Drejtoria Juridike ka bërë ri-njoftimet e subjekteve të mesipërmë me qëllim arkëtimin e këtyre shumave detyrim si masë sanksioni ndaj veprimeve të paligjshme për kryerjen e ndërtimit pa leje. Disa prej tyre kanë kërkuar nga Gjykata Adminitrative e Shkallës së Parë Gjirokaster anullimin e këtij vendimi ku është vendosur mospranimi i kërkesë padisë për shkak së nuk është ezauruar ankimi administrativ ndaj tyre dhe në disa raste nuk është pranuar padia për shkak se ka kaluar afati administrativ i përcaktuar brenda të cilës mund të kërkohej pavlefshmëria e vendimit për dënim me gjobë(këto vendime gjenden pranë Zyrës Juridike,Bashkia Sarandë). Nga ana jonë është kërkuar nisja e procedurave për vënien në ekzekutim të Aktit Administrativ(vendim me gjobë) duke ju drejtuar Gjykatës kopetente për shdërimin e vendimit të kundravajtjhes në Titull ekzekutiv,sipas ligjit nr.10279/2010, nenet 9, 22, 24 dhe 30. Gjobat e vendosura nga IVMT-ja, trajtohen sipas ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" ku parashikohet çfarë përbën kundërvajtje, çfarë statusi kanë gjobat e vëna nga Inspektoret vendor, si shqyrtohen ato, si bëhet ankimimi ndaj tyre, si ekzekutohen(mënyra për ti arkëtuar).

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Nga ana e institucionit nuk janë paraqitur akte shkresore mbi kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së sipërpërmendur.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

10.17. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procedurën e diskutimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve:

a) Buxheti për vitet 2017 dhe 2019 nuk është përgatitur dhe miratuar brenda datës 25 dhjetor të vitit paraardhës.

b) Buxhetet nuk janë paraqitur për miratim brenda muajit nëntor të vitit buxhetor nga Kryetari i njësisë të qeverisjes vendore në Këshillin Bashkiak.

c) Nuk është e qartë nëse buxhetet janë publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 15 ditëve nga miratimi i tyre.

ç) Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka bërë analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti.

Në vitin 2017 buxheti është miratuar më shumë se tre muaj me vonesë dhe në vitin 2019 është miratuar me disa ditë vonesë. Në asnjë nga vitet e audituara nuk është paraqitur brenda afatit për miratim në Këshillin Bashkiak. Vendimet e KB për buxhetet, nuk gjenden të publikuara në Buletinin e Njoftimeve Publike, por disa prej tyre janë në faqen e internetit vendime.al.

Për vitin 2017, gjendja në fillim të vitit ka qenë 450,204 mijë lekë dhe transferta specifike 214,998 mijë lekë. Gjendja në fund për vitin 2017 ka qenë 467,036 mijë lekë.
Për vitin 2018, gjendja në fillim të vitit ka qenë 467,036 mijë lekë dhe transferta specifike 225,529 mijë lekë. Gjendja në fund për vitin 2018 ka qenë 336,505 mijë lekë.
Për vitin 2019, gjendja në fillim të vitit ka qenë 336,505 mijë lekë dhe transferta specifike 226,533 mijë lekë. Gjendja në fund për vitin 2019 ka qenë 563,038 mijë lekë.
Shlyerja e detyrimeve të prapambetura është buxhetuara njësoj në shumën 25,000 mijë lekë, për secilin nga vitet e audituara.
Nga të ardhurat e veta janë paguar 43 punonjës më shumë se totali para reformës territoriale, të punësuar kryesisht në shërbimet publike dhe në administratë. Efekti financiar i 43 punonjësve është 40,000 mijë lekë bruto, duke zbritur efektet e rritjes së pagave (nga të cilat 15% është efekti i rritjes së pagave sipas kategorive dhe 5% efekti i rritjes së pagës minimale) ndikimi në buxhetin e Bashkisë Sarandë është 32 milion lekë shpenzime më shumë nga të ardhurat e veta, pa përfshirë shpenzimet për sigurime shoqërore, shëndetësore, leje, etj., për këta punonjës.
Për vitin 2017, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 60% ose nga 568,564 mijë lekë të planifikuara në 342,849 mijë lekë të realizuara.
Për vitin 2018, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 73% ose nga 1,444,650 mijë lekë të planifikuara në 1,049,947 mijë lekë të realizuara.
Për vitin 2019, sipas zërave të buxhetit rezulton se në total buxheti i Bashkisë (nga granti, të ardhurat dhe transferta specifike) është realizuar në masën 33% ose nga 1,242,506 mijë lekë të planifikuara në 417,844 mijë lekë të realizuara.
Ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre *(Trajtuar hollësisht në pikën (B), faqen 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.17.1 <u>Rekomandimi</u>: Për vitet në vazhdim, Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa për diskutimin e buxhetit të vitit pasardhës në këshillin bashkiak brenda muajit nëntor të vitit buxhetor dhe për miratimin përfundimtar të tij jo më vonë se data 25 dhjetor. Këto vendime të publikohen rregullisht brenda 15 ditëve në buletinin e Njoftimeve Publike dhe zbatimi i buxhetit të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti.
Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Sarandë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.
Me qëllim krijimin e një administrate funksionale, profesionale dhe të përgjegjshme, Kryetari i Bashkisë Sarandë të analizojë strukturën e burimeve njerëzore, të përcaktojë në mënyrë të hollësishme detyrat e çdo drejtuesi dhe punonjësi, të përcaktojë afatet në kryerjen e detyrave dhe të kontrollojë sistematikisht zbatimin e tyre, të kërkojë punonjës profesionistë dhe të përkushtuar gjatë rekrutimit, duke mos bërë shpenzime kolosale për vende pune jofunksionale, të krijuara dhe në shërbim të interesave të ngushta dhe pa interes për komunitetin.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Sarandë nr.25, datë 24.04.2020, janë miratuar tavanet Buxhetore të PBA-së 2021-2023, ku janë parashikuar burimet e brendshme duke i dhënë përparësi shpenzimeve për investime.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Në proces zbatimi

Komente nga subjekti i audituar:
Me vendim nr.79, datë 29.12.2018 është miratuar në Këshillin e Bashkisë, Buxheti i Bashkisë Sarandë për vitin 2019, me vendim nr.43, datë 23.12.2019 është miratuar në Këshillin e Bashkisë, Buxheti i Bashkisë Sarandë për vitin 2020. Kryetari i Bashkisë me Urdhër ka miratuar Strukturën e burimeve Njërëzore për vitin 2019 dhe për vitin 2020 dhe detyrat funksionale për çdo specialist janë përcaktuar në Draft Rregulloren e re që do miratohet në Këshillin e Bashkisë në mbledhjen e rradhës.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Institucioni ka hartuar dhe miratuar buxhetet vjetore dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve. Vendimet e Këshillit Bashkiak publikohen në faqen zyrtare të institucionit. Për vitin 2020 janë hartuar raportet e monitorimit të buxhetit mbi realizimin e tij. Problematike mbetet situata sa i përket mungesës së Rregullores së Brendshme si dhe procedurave të rekrutimit të cilat janë konstatuar me mangësi të theksuara nga rezultatet e inspektimit të kryer nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i cili me vendimin nr. 117 datë 05.11.2019 ka evidentuar një sërë të metash dhe mangësish ende të papërmbushura nga institucioni.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

11.18. Gjetje nga auditimi: Në administratën e Bashkisë Sarandë nuk është paraqitur në të gjitha rastet në Degën e Thesarit Sarandë, dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik. Një pjesë e kontratave janë regjistruar me vonesë në thesar.
Për procedurat e raportuara si të prapambetura nuk është ruajtur plotësisht radha e financimit.
Deri në datën 30.06.2019, Bashkia Sarandë ka pasur 4,942 mijë lekë shpenzime gjyqësore të papaguara dhe deri në datën 31.12.2018 ka pasur 36,705 mijë lekë detyrime të papaguara ndaj të tretëve, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet.
Shpenzimet gjyqësore të palikujduara, në rreth 60% të tyre janë shpenzime gjyqësore, detyrimet e të cilave kanë lindur përpara vitit 2015 dhe për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, nuk janë likuiduar 10 vendime gjyqësore në vlerën 4,942 mijë lekë dhe në total 12 vendime gjyqësore në vlerën 12,477 mijë lekë.
Faturat e palikujduara për investime dhe shpenzime të ndryshme, në datën 31.12.2018 paraqiten në vlerën **36,705 mijë lekë**. Faturat e palikujduara, në masën 98,75% të tyre janë shpenzime, kontratat e të cilave janë lidhur para vitit 2015 dhe për vitet 2016, 2017, 2018, 2019, nuk janë likuiduar 13 fatura (mallra/shërbime) të mbartura në vlerën 36,705 mijë lekë. Pavarësisht se nga personeli përgjegjës pretendohet se pagesat në shumicën e rasteve nuk janë bërë për shkak të mangësive në dokumentacion, nuk është zhvilluar asnjë korrespondencë me subjektet kreditore, me synimin për të plotësuar mangësitë dokumentare dhe për të sqaruar problemet e pretenduara të cilat janë bërë shkak për moskryerjen e pagesave. Gjithashtu edhe për vlerën më të madhe kreditore, e cila ka qenë energji elektrike, nuk është bërë asnjë planifikim për shlyerjen dhe kjo vlerë është rritur nga viti në vit.
Nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk janë zhvilluar procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura *(Trajtuar hollësisht pikën (B), në faqen 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.18.1 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës), të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të palikuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre për vlerën **36,705 mijë lekë**.

Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës), të respektojë radhën e financimit për procedurat e raportuara si të prapambetura dhe të zhvillojë procedura të mjaftueshme për planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) nuk është paraqitur në këshillin bashkiak një material i faturave të palikuiduara në vite, si dhe nuk është hartuar një grafik duke zbatuar radhën e pagesave sipas kohës së krijimit të tyre.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Nga Drejtoria Ekonomike është miratuar në Këshillin e Bashkisë lista e faturave të palikujduara me reformen territoriale si dhe u hartua grafiku i shlyerjes i cili u paraqit në Ministrinë e Financave. Pas vitit 2015, për çdo vit, faturat e palikujduara, grafiku dhe vlera e shlyerjes së tyre janë trajtuar në buxhetin dhe në buxhetin faktit të çdo viti janë pasqyruar edhe në pasqyrat financiare në fund të çdo viti ushtrimor.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit nuk është paraqitur relacioni me të cilin është bërë paraqitja e situatës së detyrimeve të prapambetura në Këshillin Bashkiak pas rekomandimit të lënë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

12.20. Gjetje nga auditimi: Për asetet e dhëna me qira nga Bashkia, nga auditimi u konstatua se për asnjë rast nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH, apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, asnjë nga objektet e dhëna me qira nuk figuron i regjistruar në AKSH, pra në asnjë rast Bashkia Sarandë nuk rezulton të disponojë Titull (Certifikatë Pronësie) për objektet e kontraktuara. Nga sa më sipër, rezulton se padrejtësisht Bashkia ka lidhur kontrata për objekte të cilat nuk i ka në pronësi *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqen 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.20.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qira dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Bashkia Sarandë të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.
- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi nga Bashkia Sarandë nuk ka përditësuar sipërfaqet faktike në dispozicion dhe ato të regjistruar në AKSH apo në listat e transferimit të pasurive nga KM.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Për sa me sipër, Bashkia Sarandë ka filluar procedurat përkatëse sipas rekomandimeve të Klsh-së.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit ende nuk janë përmbushur rekomandimet e lëna pasi procesi i regjistrimit të pronave nuk ka përfunduar. Mungojnë informacionet e hollësishme mbi asetet e dhëna me qera.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

13.21. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1236/24prot, datë 02.06.2017, dhe në zbatim të planit të veprimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Sarandë, të miratuar me shkresën nr. 881/2prot, datë 26.05.2017, **konstatohet se**:
a- Mbi zbatimin e *masave organizative* të rekomanduara nga KLSH, konstatohet se nga 15 masa me vlerë 220,987 mijë lekë (*të ardhura të munguara*), janë pranuar 15 masa me vlerë 22,987 lekë, nga të cilat zbatuar 3 masa, në proces zbatimi 2 masa dhe pa zbatuar 10 masa në vlerë 220,987 mijë lekë.
b- Mbi zbatimin e *masave shpërblim dëmi*, të rekomanduar nga KLSH, konstatohet se nga 34 masa me vlerë 127,865,553 lekë, janë pranuar 26 masa me vlerë 97,336,541 lekë, nuk janë pranuar 8 masa me vlerë 30,529,021 lekë. Nga të pranuarat janë arkëtuar 3 masa me vlerë 76,971 lekë dhe nuk janë arkëtuar **23 masa me vlerë 97,259,570 lekë**.
c- Nga **21 masa** disiplinore, janë pranuar 21 masa. Nga të pranuarat **3 masa** nuk janë dhënë sipas rekomandimit të KLSH, pasi masa *"Largim nga puna"* është ndryshuar në masë ñ*Pezullim nga e drejta e ngritjes ne detyre, përfshirë rritjen ne shkallen e pagës për një periudhe deri ne dy vjet*ò për 2 punonjës dhe masë ñ*Vërejtje*ò për një punonjës. Ndërsa për **18 punonjësit** e tjerë masa e dhënë sipas rekomandimit të KLSH.
d- *Agjencinë e prokurimit publik;* me vendim nr. 73, datë 31.08.2017 janë vendosur **9** masa administrative me gjobë në vlerën totale prej **1,890,000 lekë,** por nga verifikimi rezultoi se megjithëse kjo vlerë është kontabilizuar në ditarin e veprimeve të ndryshme me shuma respektive për çdo gjobë, por nuk kishin filluar kryerja e ndalesave nga paga.
e- *Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit, Bashkia Sarandë,* nuk ka marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, Ligjit Nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò i ndryshuar, Kreu III neni 29 dhe Kreu IV neni e 52, të vendosë masë administrative, për**:** znj. F në masën 500,000 lekë; Ing. K në masën 200,000 lekë dhe Ing. në masën 200,000 lekë.
Pavarësisht nga puna e bërë nga administrata e Bashkisë Sarandë, për masat e mësipërme, Bashkia Sarandë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktar nuk ka filluar kryerja e ndalesave, **duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit**, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit ñPër Kundërvajtjet Administrativeò (brenda 2 viteve), sipas vendimit administrativ të dënimit me gjobë *(Trajtuar gjerësisht në pikën (E), faqe 173-175, të Raport Auditimit).*

13.21.1. <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë të hartojë *menjëherë* plan pune dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të rikërkuar zbatimin e Rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1236/14, datë 28.04.2017, respektivisht:
a- Për 12 masa organizative, respektivisht pikat: 1; 3; 4; 5; 6; 8; 9; 10; 112; 13; 14 dhe 15.
b- Për 23 masa shpërblim dëmi në vlerën **96,760,520 lekë**, respektivisht pikat: 1; 2; 3; 7; 9; 11 deri 14; 16 deri 26; 27 deri 32 dhe 34.
c-Për masat administrative sipas vendimit të APP nr. 73, datë 31.8.2017, për arkëtimin gjobave e penalieteve te vendosura në vlerën e mbetur prej **1,890,000 lekë ndaj anëtarëve të KVO, respektivisht** për punonjësit: znj. F ish kryetare e bashkisë për vlerën 200,000 lekë;

znj. E për vlerën 120,000 lekë; z. E për vlerën 70,000 lekë; z. H për vlerën 50,000 lekë; në masën 300,000 lekë anëtarët e KVO z. E , z. P , znj.T ; në masën 70,000 lekë anëtarët e NJP Z. A , E dhe M ; në masën 100,000 lekë z. B ; në masën 70,000 lekë anëtarët e KVO z. F , A ; në masën 50,000 lekë anëtarët e KVO z. A dhe M , *duke vepruar si më poshtë*:

1. Drejtoria Juridike, të nisë procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës), duke i ngarkuar edhe me kamat vonesa të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò.

2. Drejtoria Juridike, pas llogaritjes të kamat vonesave për gjobat e vendosura nga APP, të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò, i ndryshuar.

3. Kryeinspektori i IMTV, Bashkia Sarandë, nëse nuk ndjek procedurat e nevojshme ligjore për vendosjen dhe arkëtimin e 3 gjobave në vlerën prej 900,000 lekë, respektivisht: **znj. F** në masën 500,000 lekë; **Ing. K** në masën 200,000 lekë dhe **Ing. A** në masën 200,000 lekë, **ndaj Kryeinspektorit të IMTV, të fillojnë procedurat e largimit nga detyra**, bazuar në Nenin 44-Përgjegjësia e punonjësit të organit administrative, ku <u>përcaktohet se:</u> *Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ***.**

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim është i pa zbatuar pasi nga Kryetari i Bashkisë Sarandë nuk është hartuar një plan pune i veçantë në rikërkimin e zbatimin e Rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1236/14, datë 28.04.2017. Gjendja e të cilave paraqitet e pa ndryshuar. Trajtuar gjerësisht në pikën (E), faqe 173-175, të Raport Auditimit dërguar në Bashkinë Sarandë me shkresën nr. 365/7 datë 27.09.2019).

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>

- Drejtoria juridike ka bërë njoftimet për çdo subjekt për vënin në ekzekutim të 25 vendimeve për gjobat e vëna nga IVM-Bashkia Sarandë dhe aktualisht nga subjektet janë ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokaster ku vazhdojmë të jemi në proces gjyqësor.

- Kryeinspektori i IVMT-së, Bashkia Sarandë, sipas rekomandimit të KLSH-së, është larguar nga detyra.

- Për sa i përket zbatimit të Rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1236/14, datë 28.04.2017, është berë Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, nga ana e Titullarit të Bashkisë, janë nxjerrë urdhrat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve. Është hartuar Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019 për zbatimin e rekomandimeve për përiudhen 01.01.2017 – 30.06.2019.Janë berë njoftimet përkatëse subjekteve privatë.

-Me Urdhër nr.95, datë 23.07.2020 të Kryetarit të Bashkisë, janë berë njoftimet përsonave përgjegjës që rezultojnë debitor, sipas Vendimit nr.14, datë 10.03.2020 të APP-së, por vazhdojnë proceset gjyqësore në Gjykatën Administrative Shkalla e Dytë Tiranë.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>

Nga ana e institucionit nuk rezulton të jenë marrë masa për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga KLSH dërguar me shkresën nr. 1236/24prot, datë 02.06.2017, dhe në zbatim të planit të

veprimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Sarandë, të miratuar me shkresën nr. 881/2prot, datë 26.05.2017, për 12 masa organizative, 23 masa shpërblim dëmi në vlerën **96,760,520 lekë,** masat administrative sipas vendimit të APP nr. 73, datë 31.8.2017, për arkëtimin gjobave e penalieteve të vendosura në vlerën e mbetur prej **1,890,000 lekë ndaj anëtarëve të KVO.** Sa i përket largimit të Kryeinspektorit sqarojmë se gjatë periudhës Korrik 2019-Dhjetor 2020 janë ndryshuar 4 (katër) drejtues por në asnjë rast nuk evdientohet që ndryshimet të jenë kryer për çështje që lidhen me rekomandimin e lënë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

13.22. <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Sarandë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2017 ï 30.6.2019, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër Financat e Vetëqeverisjes Vendoreò.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim është i pa zbatuar pasi nga Bashkia Sarandë nuk na u paraqit ndajë relacion i këshillit bashkiak mbi njohjen dhe analizimin e Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Nga ana e Titullarit institucionit janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe konkretisht, është nxjerrë Urdhri nr. 116 dhe 116/1 datë 29.10.2019, Urdhri nr. 147/1 prot, datë 05.12.2019, mbi hartimin e grupit të punës për verifikimin e shkeljeve, planit të veprimit dhe marrjen e masave për zbatim të rekomandimeve të lëna.

Statusi aktual i rekomandimit
Zbatuar pjesërisht

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Ska

13.22.1 Rekomandim: KLSH i rikërkon, Titullarit të Bashkisë të mare masat, për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuar dhe njëkohësisht përshpejtimin e masave që janë në proces zbatimi.

Menjëherë

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Nga praktika e deritanishme, nuk ekziston ndonjë rast që Kryetari i Bashkisë të raportoj në Këshillin e Bashkisë Raportin Përfundimtar të Auditimit. Këtë praktikë kemi praktikuar edhe tani.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Mungon dokumentacioni apo relacioni mbi paraqitjen e konkluzioneve të KLSH në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

B/I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ñKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, **nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Sarandë),** të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **11,612,883 lekë**, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se vlera **11,612,883** lekë nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468-debitorë të Pasqyrave Financiare më datën 31.12.2019 (bilanci vjetor 2019) dërguar në degën e thesarit me shkresën nr. 1372 prot datë 23.04.2020.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **11,612,883 lekë**
Deri më datën 26.08.2020 nuk është arkëtuar asnjë **lekë**
Duke mbetur pa u arkëtuar vlera **prej..... 11,612,883 lekë**

Por edhe pse kanë kaluar mbi 8 muaj (Nëntor 2019 Gusht 2020), nga krijimi i grupit të punës sipas urdhrit nr. 116-116/1 datë 29.10.2020 drejtoria e financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve, si dhe nuk janë nisur njoftimet për subjektet debitorë si dhe nuk janë nxjerr urdhër ekzekutimet. Gjithashtu nga Bashkisë Sarandë nuk është hartuar padi civile për shpërblim dëmi ndaj Operatorit ekonomik si më poshtë:

Në mënyrë tabelore rekomandimet, arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

	Emër Mbiemër/Subjekti	Numri ekmandimit sip shkre (Vendimi	Natyra e Shkeljes	Rekomanduar Gjithsej në Leku	uk Pranoh nga Subjek	Janë pranuar Në lekë	Nga të pranuarat:			
							rkëtuar De 28.08.20	Në Proces Arkëtim	Në Proces Gjyqësor	isur Njoftir s'kanë Pagu
a	b	c	d	1	2	3 (2-1)	4	5	6	7
	KVO	1.1	Skualifikim i OE	274,395		274,395				
	KVO	2.1	Skualifikim i OE	743,200		743,200				
	ñB ò SHPK	3.1	Paguar me shumë se sa kontrata	470,534		470,534				
	BOE) ñE ò, & ñF ò SHPK	4.1	Punime të pakryera	1,537,700		1,537,700				
	(BOE) ñT ò & ñF ò	5.1	Punime të pakryera	923,000		923,000				
	OE ñA ò SHPK	6.1	Punime të pakryera	513,234		513,234				
	OE ñJ ò SHPK	7.1	Punime të pakryera			354,852				
	OE ñE ò SHPK	8.1	Punime të pakryera	530,632		530,632				
	OE ñJ ò SHPK	9.1	Punime të pakryera	246,238		246,238				
	Shoqëria ñA ò	10.1	Mos llogaritje penaliteti	1,128,280		1,128,280				
	Shoqëria ñA ò	11.1	Mos llogaritje penaliteti	822,008		822,008				

	JV ñB ò,	12.1	Punime të pakryera	3,136,810		3,136,810				
	27 vendime gjobe	13	Gjoba policia bashkiake	932,000		932,000				
	SHUMA			**11,612,883**		**11,612,883**				

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt *"Sinjalistika vertikale, vijëzimi për vitin 2017",* me fond limit 1,915,776 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria ñT ò, me vlerë kontrate 1,796,040 lekë, konstatohet se kualifikimi i shoqërisë ñT ò nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur asnjë nga operatorët pjesëmarrës nuk plotësojnë kriteret për kualifikim, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës, ose mangësitë e evidentuara në operatorë pjesëmarrës, mund të klasifikoheshin si devijime të vogla në zbatim të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, dhe të vlerësoje kriteri kryesorë ñ*Çmimi më i leverdishëm*ò, këtë rast kontrata është shoqëria ñR. ò me vlerë 1,521,645 lekë ose më të ulët se shoqëria fitues në vlerë më pak për **274,395 lekë** *(Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqe 112-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **274,395 lekë,** ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në shkeljet e konstatuara në procedurën me objekt *"Sinjalistika vertikale, vijëzimi, viti 2017.*

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/4, datë 26.01.2021 për shoqërinë "T " me vlerë 274.395 lekë.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht prej shërbimit postar. Ndërkohë vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt *"Meremetime me asfalt të rrugëve të brendshme", viti 2018",* me fond limit 4,166,666 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria ñA ò, me vlerë kontrate 4,059,200 lekë, konstatohet se nga KVO është bërë skualifikimi me të padrejtë i OE

me ñJ ò me ofertë më të favorshme ekonomike, për një shkak/argument i cili nuk rezulton i qenësishëm dhe për më tepër i pakërkuar për tu plotësuar në DST, çka ka bërë që skualifikimi nga KVO i OE me ofertë më të ulët, për mos plotësim të kritereve të DST, me pasojë dëm ekonomik për vlerën **743,200 lekë pa TVSh**, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 ñ*Objekti dhe qëllimi*ò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñ*Parimet e përzgjedhjes*ò germa (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46 dhe 53, 55, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 **"**Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014,të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar *(Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqe 125-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. <u>Rekomandimi</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë, të analizojë shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e padrejtë të shoqërisë ñJody-Kompanyò, me pasojë dëm ekonomik për vlerën **743,200 lekë**, si dhe të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës nga drejtuesit dhe personat përgjegjës në këtë procedurë.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH". Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/5, datë 26.01.2021 për shoqërinë "J me vlerë 743,200 lekë

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurës me objekt *"Shërbim i ruajtjes Fizike, Bashkia Sarandë",* për vitin 2017 me fond limit 3,595,359 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria ñB me vlerë kontrate 3,595,355 lekë dhe për vitin 2018 me fond limit 4,333,333 lekë, me vlerë kontrate 4,289,173 lekë, konstatohet se paga bazë për llogaritjen e sigurimeve shoqërore e shëndetësore (deklaruar në ofertën e shoqërisë) nuk përputhet me atë të deklaruar në listëpagesat mujore, për diferencë në shumën 3,000 lekë/muaj, duke rënduar padrejtësisht fondin e ruajtjes së objekteve, Bashkinë Sarandë dhe Stadiumin e qytetit për vlerën **403,200 lekë** (3,000 lekë x 5.6 x 24 muaj). Gjithashtu dhe vlera e sigurimeve shoqërore rënduar padrejtësisht, si rezultat i mos deklarimit të saktë të pagës bazë paraqitet në vlerën ***67,334 lekë*** për dy periudhat.
Gjithsej rënduar padrejtësisht për vlerën **470,534 lekë**, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore edhe shëndetësore në RSH, i ndryshuar me

Akt-Normativ të KM nr. 1, datë 25.01.2017 dhe VKM nr. 37, datë 21.01.2016 ñPër përcaktimin e pagës mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore....ò, si dhe nenin 2 të nenit 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar *(Trajtuar gjerësisht në pikën (D), faqe 101-163, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **470,534 lekë**, ndajë shoqërisë **"B "** për periudhën e viteve 2017 dhe 2018**.**

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/3, datë 26.01.2021 për shoqërinë "B " me vlerë 470.534 lekë.
<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të zbatimit të punimeve në kontratën me objekt *"Rikonceptim dhe Rivitalizim i Qendrës së Qytetit të Sarandës, Rruga e Flamurit", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 102,518,468 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) ñE ò , & ñFushaò , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **1,537,700 lekë pa TVSH,** për punime të pakryera dhe punime në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 Prot, datë 30.06.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) ñE ò , & ñF ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. <u>Rekomandimi</u>: Të merren masa nga Bashkia Sarandë, që tõi kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ñE ò , & ñFushaò , në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 6 prot, datë 30.06.2016, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **1,537,700 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të

konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Drejtoria Ekonomike, në zbatim të Urdhrit nr.116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, ka nxjerrë dhe janë berë njoftimet përkatëse për çdo subjekt. Nuk ka arkëtime.
Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit nuk është paraqitur informacion mbi realizimin e rekomandimit për realizimin e punimeve konfirmuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit përshumën prej **1,537,700 lekë pa TVSH** e konstatuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Në mungesë të punimeve vlera më sipër duhej kontabilizuar dhe arkëtuar nga Bashkia Sarandë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Rikonstruksion dhe shtrim i rrugës bujqësore së fshatit Pal*", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 88,904,403.6 lekë me TVSH, fituar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) ñT ò & ñF ò , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **923,000 lekë pa TVSH,** për punime të pakryera dhe punime në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 2 Prot, datë 08.03.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe Bashkimi i Operatorëve Ekonomik (BOE) ñT ò & ñF ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Sarandë, që tôi kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ñT ò & ñF ò , në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 2 prot, datë 08.03.2018, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **923,000 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).
- Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH". Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit të mesipërm dhe në vazhdimësi Situacioni i punimeve të konfirmohet nga strukturat përgjegjëse, sipas rekomandimit tuaj dhe në zbatim të Urdhërit nr.116, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë dhe Planit të Veprimit të hartuar nga ana jonë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Nga ana e institucionit nuk është paraqitur informacion mbi realizimin e rekomandimit për realizimin e punimeve konfirmuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit përshumën prej **923,000 lekë pa TVSH** e konstatuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Në mungesë të punimeve vlera më sipër duhej kontabilizuar dhe arkëtuar nga Bashkia Sarandë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Meremetime me asfalt të rrugëve të brendshme*", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 5,845,248 lekë me TVSH, fituar nga Operatorit Ekonomikë ñA ò , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **513,234 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 13 Prot, datë 11.06.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe sipërmarrësit të punimeve, Operatorit Ekonomik ñA ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. <u>Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **513,234 lekë pa TVSH** nga Operatorit Ekonomikë ñA ò , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 13 Prot, datë 11.06.2018, me objekt ñMeremetime me asfalt të rrugëve të brendshmeò, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH". Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
<u>Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/2, datë 26.01.2021 për shoqërinë "A " shpk me vlerë 513.234 lekë.</u>

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Sistemi i rrugës Tirana Bankë drejt liqenit në Ksamil*", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 6,701,700 lekë me TVSH, fituar nga Operatorit Ekonomik ñJ ò , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **354,852 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 29 Prot, datë 25.02.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe sipërmarrësit të punimeve, Operatorit Ekonomik ñJ

ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. <u>Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **354,852 lekë pa TVSH** nga Operatorit Ekonomikë ñJ ò , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 29 Prot, datë 25.02.2019, me objekt ñSistemi i rrugës Tirana Bankë drejt liqenit në Ksamilò, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/5, datë 26.01.2021 për shoqërinë "J " me vlerë 354.852 lekë.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rehabilitimi dhe vitalizimi i Korpusit dhe i terreneve sportive të shkollës ñH. Tahsinò, *Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 63,124,740.6 lekë me TVSH, fituar nga Operatorit Ekonomikë (OE) ñE ò, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **530,632 lekë pa TVSH,** për punime të pakryera dhe punime në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 23 Prot, datë 13.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe Operatorit Ekonomik (OE) ñE ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. <u>Rekomandimi</u>: Të merren masa nga Bashkia Sarandë, që tô kërkojë Operatorit Ekonomikë (OE) ñE ò, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 23 prot, datë 13.09.2018, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **530,632 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të

konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit të mesipërm dhe në vazhdimësi. Situacioni i punimeve do konfirmohet nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Sarandë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"*Investime për rikonstruksione në ambientet e konviktit si dhe terrene sportive*", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës 3,982,992 lekë me TVSH, fituar nga Operatorit Ekonomikë ñJ ò , rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **246,238 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve Nr. 17$_{Prot}$, datë 23.04.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe sipërmarrësit të punimeve, Operatorit Ekonomik ñJ ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 <u>Rekomandimi</u>: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **246,238 lekë pa TVSH** nga Operatorit Ekonomikë ñJ ò , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me Nr. 17 Prot, datë 23.04.2018, me objekt ñInvestime për rikonstruksione në ambientet e konviktit si dhe terrene sportiveò, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/5, datë 26.01.2021 për shoqërinë "J " me vlerë 246238 lekë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë

marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacioni mbi zbatimin e kontratës datë 10.06.2019 me objekt *"Instalime elektrike shkolla "9-Tetori" dhe shkolla Ksamil ", viti 2019",* konstatohet se deri në momentin e hartimit të këtij akti nga shoqëria nuk ishte paraqitur asnjë situacion pjesore ose përfundimtar (konfirmuar kjo dhe nga Drejtoria Ekonomike). Referuar nenit 3 të kontratës punimet duhet të përfundonin në afatin 30 ditë nga moment i lidhjes, pra nga data 10.06.2019 deri me datë 10.07.2019, gjë e cila nuk ka ndodhur.
Në këto kushte nga Bashkia Sarandë (personat përgjegjës), nuk janë llogaritur penalitet për mos përfundim të afat të punimeve nga data 10.07.2019 deri me datë 09.08.2019 (neni 27 I kontratës) në vlerën **1,128,280 lekë** (9,726,552 lekë x 4/1000 x 29 ditë kalendarike), vlerë e cila konsiderohet dem ekonomik në buxhetin e bashkisë, dhe ngarkon me përgjegjësi **shoqërinë 'A** për shlyerjen e dëmit, në kundërshtim me nenet 3 dhe 27, të kontratës datë 10.6.2019, të lidhur midis investitorit (Bashkia Sarandë) dhe sipërmarrësit shoqërisë :A ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 162-170, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. <u>Rekomandimi:</u> Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,128,280 lekë** nga shoqëria **"A** në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8, datë 10.6.2019, me objekt ñInstalime elektrike shkolla ñ9-Tetoriò dhe shkolla Ksamil, viti 2019ò, Bashkia Sarandë, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mos përfundimit në afat të punimeve.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372, datë 26.01.2021 për shoqërinë "A me vlerë 1.128.280 lekë.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacioni mbi zbatimin e kontratës datë 06.05.2019 me objekt: *"Investime në Konviktin e Shkollës së Mesme", viti 2019"*, konstatohet se deri në momentin e hartimit të këtij akti nga shoqëria nuk ishte paraqitur asnjë situacion qoftë pjesore apo përfundimtar. Referuar nenit 3 dhe 27 të kontratës punimet duhet të përfundonin në afatin 30 ditë nga moment i lidhjes, pra nga data 06.05.2019 deri me datë 06.06.2019, gjë e cila nuk ka ndodhur.
Në këto kushte nga Bashkia Sarandë (personat përgjegjës), nuk janë llogaritur penalitet për mos përfundim të afat të punimeve nga data 06.06.2019 deri me datë 09.08.2019 (neni 27 I kontratës) në vlerën **822,008 lekë** (3,261,936 lekë x 4/1000 x 63 ditë kalendarike), vlerë e cila konsiderohet dem ekonomik në buxhetin e bashkisë, dhe ngarkon me **përgjegjësi shoqërinë "A " për shlyerjen e dëmit**, veprime në kundërshtim me nenet 3 dhe 27, të kontratës nr. , datë 6.5.2019, të lidhur midis investitorit (Bashkia Sarandë) dhe sipërmarrësit shoqërisë ñA ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 162-170, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1. <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **822,008 lekë** nga shoqëria **"A ",** në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 06.05.2019, me objekt ñInvestime në Konviktin e Shkollës së Mesmeò, viti 2019ò, Bashkia Sarandë, vlerë e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e mos përfundimit në afat të punimeve

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në bazë të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë "Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së", Drejtoria Ekonomike me Njoftim nr.372, datë 26.01.2021 ka njoftuar subjektin përkates.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *"EKO Kampus Sarandë", Bashkia Sarandë,* me vlerë të kontratës (me TVSh) 330,577,453 lekë, fituar nga JV ñB ò & ñP ò & ñB ò, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,136,810 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 20 prot datë 21.12.2015 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe

ñBeanò & ñP ò & ñB ò *(Trajtuar më hollësisht në pikën (D/1.4) faqet 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. <u>Rekomandim</u>: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,136,810 lekë pa TVSh** nga JV ñB ò & ñP ò & ñB ò, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 20 prot. datë 21.12.2015, me objekt ñEKO Kampus Sarandëò, Bashkia Sarandë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë, Drejtoria Ekonomike ka nxjerrë Njoftimin nr.372/1, datë 26.01.2021 për shoqërinë "B " & "P " &"B " me vlerë 3.136.810 lekë.

<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Sipas tabelës së detyrimeve në datën 31.12.2020 institucioni ka kontabilizuar detyrimin në regjistrat përkatës gjatë vitit 2020 sipas urdhrit nr. 116/1 datë 29.10.2019. Shkresa njoftuese megjithëse është hartuar me vonesë, në fund të muajit janar 2021, nuk përmban adresë të shoqërisë sipas të dhënave të vetëdeklaruar të shoqërisë në QKB. Institucioni, nuk paraqiti informacion nëse njoftimet janë marrë në dorëzim nga subjekti apo janë kthyer sërisht nga shërbimi postar. Vlera rezulton ende në regjistrin e detyrimeve.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk është lidhur asnjë kontratë dhe rrugët e qytetit janë të mbushura me tabela treguese për parkime të rezervuara dhe me vijëzimet përkatëse. Qytetarët penalizohen me gjoba nga policia për parkime të mundshme në vendet e rezervuara ose vijnë rrotull në kërkim të një vendi parkimi.

Nga 32 vende parkimi të rezervuara, janë paguar vetëm 5 vende, në vlerën 175,000 lekë. Vlera e paarkëtuar prej **932,000 lekë** për tabelat dhe vijëzimet që vazhdojnë të qëndrojnë në rrugët e qytetit të Sarandës, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë *(Trajtuar hollësisht në pikën (b) faqen 50-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 <u>Rekomandimi</u>: Nga administrata e Bashkisë Sarandë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, civile apo penale, sipas rastit. Për personat të cilët i kanë tabelat dhe vijëzimet dhe nuk kanë bërë kërkesa për ndërprerjen e kontratës me bashkinë, të bëhet menjëherë faturimi i vlerës totale të debisë, për të gjithë periudhën e përdorimit të tabelave. Për personat sipas tabelës bashkëlidhur (tabela të përditësohet nga zyra përkatëse e Bashkisë Sarandë me pagesat e bëra ndërkohë) në anekset e këtij Raporti, të kontabilizohet vlera prej **932,000 lekë** nga parkimet e rezervuara, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë, duke llogaritur edhe kamatëvonesat dhe të fillojnë menjëherë procedurat e vjeljes duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. **Për personelin përgjegjës të merren masa të mëtejshme ligjore.**

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8, datë. 27.09.2019, ka nxjerr Urdhrin nr. 116 dhe 116/1, datë 29.10.2019, është ngritur grupi i punës "Mbi verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përcjell nga KLSH" Deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është kryer asnjë procedurë tjetër ligjore.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, dërguar me shkresë nr.1348/35, datë 10.01.2020, kemi theksuar së ky rekomandim nuk pranohet. Në observacionin e derguar nga specialisti i Transportit në Drejtorinë e Shërbimeve sqarohen të gjitha rastet e parkimeve të rezervuara si dhe pagesat e kryera.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Sa trajtuar në raportin Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimin përkatës, nga ana e institucionit nuk janë marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e shumës.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò neni 15 shkronja (b) dhe (c) ï *Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 ñKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëò, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, **nga Kryetari i Bashkisë Sarandë**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e të ardhurave të munguara në **vlerën 774,205,416 lekë**, si më poshtë:
-vlera 632,558,098 lekë, mos arkëtimin të vlerës së debitorëve të subjekteve fizik/ juridike dhe abonentëve familjarë dhe kontratat e plazheve.
-vlera 141,647,318 lekë, mos arkëtim të vlerës **të 171 gjobave** të pa arkëtuara nga IMTV.

Në mënyrë më të detajuar gjetjet janë paraqitur si vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit (IMT) Bashkia Sarandë, janë vendosur **171** gjoba në vlerën **141,647,318 lekë**, penalitetet të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërkimit të tyre, nga e cila për **25 gjoba** në vlerën prej **16,470,410 lekë**, dukë qenë se kanë kaluar 2 vjet nga nxjerrja e vendimeve, ka kaluar afati i parashkrimit.
Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridik dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën prej **141,647,318 lekë,** në kundërshtim me:
a-neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeveò, me ndryshime, ***përcaktohet se*: -***Gjoba paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë,*

deri në një muaj. *Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.*
-Neni 15-*(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);*
b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò.
c-Nga Sektori Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò, i ndryshuar.
d-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Sarandë nuk ka marrë masat dhe nuk ka kërkuar në Gjykatë rivendosjen në afat të 25 vendimeve të gjobave në vlerën **16,470,410 lekë,** në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, ñKodi i Procedurës Civile në RSHò i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: *Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit dhe nenet* 151 dhe 152, të ñKodit Procedurës Civile në RSHò *(Trajtuar gjerësisht në pikën (B) faqe 43.46, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) Drejtoria Juridike e dhe Financës Bashkisë Sarandë:
a. të marrin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat të 25 vendimeve të gjobave në vlerën **16,470,410 lekë,** bazuar në nenet 151 dhe 152, të ñKodit Procedurës Civile në RSHò,
b. të marrin masa për kontabilizimin e vendimeve të gjobave të IMTV dhe kthimin në tituj ekzekutiv të **171 vendimeve** të dënimit me gjobë të vendosura nga IMTV për periudhën 2016-2019 për ndërtimet e kundërligjshme, në vlerën **141,647,318 lekë**, në zbatim të nenit 24-*Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv* , të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrative në, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar), bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeveò i ndryshuar),ò (*sipas listës që disponon IMTV Bashkia Sarandë*
*- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) Drejtoria Juridike e dhe Financës Bashkisë Sarandë nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme për rivendosjen në afat të 25 vendimeve të gjobave në vlerën **16,470,410 lekë,** bazuar në nenet 151 dhe 152, të "Kodit Procedurës Civile në RSH.*

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
- Drejtoria juridike ka bërë njoftimet për çdo subjekt për vënien në ekzekutim të 25 vendimeve për gjobat e vëna nga IVM-Bashkia Sarandë dhe aktualisht nga subjektet janë ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokaster ku vazhdojmë të jemi në proces gjyqësor.
- Kryeinspektori i IVMT-së, Bashkia Sarandë, sipas rekomandimit të KLSH-së, është larguar nga detyra.
- Për sa i përket zbatimit të Rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1236/14, datë 28.04.2017, është berë Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, nga ana e Titullarit të Bashkisë janë nxjerrë urdhrat përkatëse për zbatimin e rekomandimeve. Është hartuar Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019 për zbatimin e rekomandimeve për përiudhen 01.01.2017 – 30.06.2019. Janë bërë njoftimet përkatëse subjekteve privatë. Në zbatim të proces verbaleve mbajtur në vend, nga ana e Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së

Territorit, ka dal Njoftimi për shlyerjen e detyrimit firmosur nga Kryetari i Bashkisë për 21 subjekte të gjobitura (materiali bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Penalitetet e vendosur nuk rezultojnë të kontabilizuara në regjistrin e detyrimeve të Bashkisë Sarandë. Nuk rezulton të jenë marra masa për rivendosjen në afat të vendimeve për gjobat e vendosura. Nga ana e institucionit janë kryer vetëm disa njoftime të cituar më poshtë me shkresa të datës 06.08.2020 në vijim të nr. 3234 prot/viti 2020 për të cilat nuk janë paraqitur arkëtime.

Nr.	Personi/Shoqeria	Data e vendimit te gjobes	Vlera
1	F	22.09.2017	500,000
2	F	13.11.2017	1,145,865
3	A	31.08.2017	500,000
4	Z	06.11.2017	500,000
5	A	20.09.2017	500,000
6	R	18.04.2017	500,000
7	R	25.10.2018	500,000
8	B	27.04.2017	50,000
9	C	31.10.2017	720,000
10	A	19.12.2017	500,000
11	A	16.10.2017	500,000

Nr.	Personi/Shoqeria	Data e vendimit te gjobes	Vlera
12	S	31.10.2017	500,000
13	A	06.11.2017	500,000
14	R	29.08.2017	500,000
15	F	13.09.2017	16,926,063
16	S	10.04.2017	500,000
17	B	02.03.2017	500,000
18	J	26.07.2017	500,000
19	A	20.06.2017	500,000
20	T	13.07.2017	500,000
Shuma			26,841,928

Pra nuk kemi ecuri pozItive mbi masat e marra nga institucioni në përmbushjen e rekomandimit të lënë. Mosmarrja e masave bie në kundërshtim me urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 të Bashkisë Sarandë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka një numër të konsiderueshëm debitorësh nga biznesi, (aktualisht 2,259 ose mbi dy të tretat të cilët nuk mund tõ paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, por do tõ bashkëlidhen materialit në formë dixhitale, me CD). Nuk janë zbatuar procedurat për regjistrimin në kontabilitet të bizneseve debitorë, taksave dhe tarifave të familjarëve, gjobave dhe kamatëvonesave dhe në asnjë rast nuk janë llogaritur kamatëvonesat për bizneset për vlerën **494,696,729 lekë,** mos arkëtimin të vlerës së debitorëve të subjekteve fizik/ juridike dhe abonentëve familjarë dhe kontratat e plazheve, si vijon:
-vlera 21,885,556 lekë, për taksën e tokës.
-vlera 94,541,346 lekë, për taksat dhe tarifat e familjarëve *(taksa e ndërtesës në vlerën 35,746,629 lekë dhe tarifa e shërbimit në vlerën 58,794,717 lekë).*
-vlera 306,721,032 lekë, për bizneset e vogla dhe të mëdha (213,286,466 detyrim + 93,434,566 kamatëvonesash).
-vlera 71,548,795 lekë, për ndikimin në infrastrukturë nga objektet e legalizuara.
Nga Drejtoria e të Ardhurave Sarandë nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë, duke ribërë njoftim vlerësimet tatimore vendore për të gjithë subjektet debitorë. Nuk janë zbatuar masa shtrënguese, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore.
Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, asnjë kërkesë për të vendosur Barrë Sigurie mbi titujt e pronësisë për mjetet dhe pasuritë e paluajtshme, në kundërshtim me nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqen 50-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **<u>494,696,729 lekë</u>**, në bazë të nenit 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, si më poshtë vijon**:**
-vlera 21,885,556 lekë, për taksën e tokës.
-vlera 94,541,346 lekë, për taksat dhe tarifat e familjarëve *(taksa e ndërtesës në vlerën 35,746,629 lekë dhe tarifa e shërbimit në vlerën 58,794,717 lekë).*
-vlera 306,721,032 lekë, për bizneset e vogla dhe të mëdha (213,286,466 detyrim + 93,434,566 kamatë).
-vlera 71,548,795 lekë, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga objektet e legalizuara, duke ndjekur procedurat si vijon:.
a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore RSHò.
b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò.
c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat tatimore në RSHò, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.
d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, <u>të</u> bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 ñMospagimi i taksave dhe tatimeveò.
e- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ksamil, të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit. Të gjitha Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për gjithë tatimpaguesit (familjarë dhe biznese në territorin përkatës).

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Nga zyra e taksave dhe tarifave vendore është bërë njoftimi për likuidim të detyrimeve të prapambetura të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në total për 1996 subjekte debitorë. Për subjektet të cilave ju është bërë njoftimi dhe nuk kanë paguar detyrimin, nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore nuk është dërguar urdhër bllokim për llogarite si dhe nuk është vendosur barra siguruese dhe hipotekore, mbi pasurinë e tatim paguesit. Nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore na u relatua se subjektet juridike dhe subjektet fizike mbahen nëpërmjet sistemit I -T në të cilin regjistrohet çdo pagës e bërë si për pjesën e debitorëve ashtu dhe për pjesën e taksapaguesve jo debitor. Gjatë periudhës së verifikimit u hasën vështirsi në marrjen e informacionit se sa debitor kanë likuiduar detyrimet sipas konstatimeve te auditit në vlerën totale 494,696,729 lekë. *<u>Kjo për faktin se për të gjeneruar raporte nga sistemi duhet me pare të ishte kryer pagesa e shërbimeve të sistemit I -T</u> . Gjithashtu nga sektori i taksave dhe tarifave vendore na u relatua se çdo subjekt që është debitor dhe vjen të kryejë pagesën e radhës sistemi automatikisht e kalon për detyrimet e prapambetura. Gjendja debitorë deri më*

31.12.2020 paraqitet në vlerën 240,293,817 lekë për 1996 subjekte biznesi i vogël dhe biznesi i madh, konfirmuar me shkresën nr. 4022 prot datë 27.01.2020 (Bashkëlidhur dokumentacionin përkatës).

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Në proces zbatimi

Komente nga subjekti i audituar:

Taksa e tokës *- Vlera e debitorëve për taksën e tokës në 30.06.2019 ishte 21,885,566 lekë ndërsa në 31.12.2020 është 23,048,008 lekë . Gjatë kësaj periudhe vlera që mbetet për tu arkëtuar është 1,162,442 lekë . Vlera në lekë e taksës së tokës për 1 vit kalendarik është 6 milion lekë në 1500 persona që janë objekt i këtij taksimi . Arkëtimi i debitorëve është në proces , megjithëse të ngadaltë pasi subjektet debitorë janë kryesisht emigrant të cilëve për shkak të mbylljes së kufijve nga pandemia u është pamundësuar ardhja në Shqipëri .*

Taksa e familjarëve *– Vlera e debitorëve për taksat dhe tarifat e familjarëve në 30.06.2019 ishte 94,541,032 lekë ndërsa në datë 31.12.2020 ësht 89,808,218 lekë (tarifa shërbimit në vlerën 58,539,036 lekë dhe taksa e ndërtesës në vlerën 31,269,182 lekë). Gjatë kësaj periudhe debia është ulur me vlerën 4,732,814 lekë dhe vazhdon të jetë në proces zbritje .*

Taksa për bisneset e vogla dhe të mëdha *- Vlera e debitorëve në datë 30.06.2019 ishte 213,286,466 lekë . Ndërsa në 31.12.2019 vlera e debisë ishte 240,293,817 me dieferncë 27,007,351 lekë ndërsa në datë 31.12.2020 ishte 286,286,480 lekë më një diferencë në proces arkëtimi në vlerë 45,992,663 lekë .Totali i vlerës për këtë periudhë është 73,000, 014 lekë. Nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore jane marrë keto masa për arkëtimin e kësaj vlere : Shkresa për mbledhjen me forcë të detyrimeve të subjekteve debitore , bllokimi i veprimeve në qkb , mosdhënia e asnjë sherbimi në Bashki për subjektet debitore , si dhe lidhja e aktmarrveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të papaguar tatimor .*

Taksa e ndikimit në infrastrukturë *– Vlera e debitorëve në 30,06,2019 ishte 71,548,795 lekë ndërsa në 31.12.2020 është 74,889,519 lekë me një diferencë të kësaj periudhe në vlerën 3,340,724 lekë . Arkëtimi i kësaj vlere është ngadalësuar edhe për shkak të ndryshimit të kuadrit ligjor ku personat që legalizojnë nuk kanë detyrim paraqitjen e fatures prane zyres se legalizimeve per mbarimin e procedurave. Drejtoria e Taksave ka dërguar shkresë në Drejtorinë Vendore të ASHK Sarandë për personat që e kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe për personat debitorë me listat emerore për vitet 2017-2018-2019-2020.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Nga ana e institucionit nuk rezulton të jenë marrë masa shtrënguese me qëllim arkëtimin e detyrimeve të parapmbetura në kundërshtim kjo dhe me urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 të Bashkisë Sarandë. Pra nuk janë kryer minimalisht njoftimet e kërkesës për pagesë dhe më tej hapat e tjerë procedural. Të dhënat e paraqitura nga institucioni lidhur me numrin në ulje të debitorëve nuk rezultojnë të dokumentuara zyrtarisht me agjentët e mbajtjes së këtyre taksave dhe nuk japin siguri për numrin e saktë të tyre. Institucioni ende nuk ka filluar aplikimin dhe kontabilizimin e penaliteteve për pagesë të vonuar sipas dispozitave ligjore.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj

subjektesh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.
Nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se figurojnë rreth 40 subjekte (NUIS-e sekondare, përfshirë autobotet) të cilët kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj, si dhe në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga ish-komunat dhe ish-bashkia, si para konsolidimit, ashtu edhe pas konsolidimit, vazhdimisht është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet, në kundërshtim me VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, pika 9.
Sa më sipër, të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 02.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.
Në Bashkinë Sarandë pothuajse nuk disponohej asnjë informacion dhe të gjitha të dhënat u mblodhën nëpër subjekte gjatë zhvillimit të auditimit.
Për subjektet që nuk ka informacion, për efekt llogaritje është supozuar se kanë paguar nga 50,000 lek. Për subjektet që kanë paguar tarifën e autorizimit para datës 02.12.2015, nuk janë llogaritur diferenca.
Në shumicën e rasteve tarifa e pajisjes me autorizim për tregtimin e hidrokarbureve është llogaritur gabim për 14 subjekte të dhënat e të cilëve disponohen nga zyra e të ardhurave. Kjo përbën të ardhur të munguar për Buxhetin e Bashkisë Sarandë, në vlerën **9,350,000 lekë** *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqen 50-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 <u>Rekomandimi</u>: Nga administrata e Bashkisë Sarandë të marren masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **9,350,000 lekë**, (sipas detajimeve në anekset bashkëlidhur), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liçencohen apo të pezullohen, sipas rastit.
Bashkia Sarandë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh, por edhe regjistra të posaçëm për bizneset e tjera me natyrë specifike (si p.sh. mjete lundruese, automjete, subjekte që paguajnë rentën minerare, që përdorin pasuritë publike për grumbullimin e bimëve medicinale, peshkimin, etj). Bashkia Sarandë, të verifikojë bilancet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj, për të parë nëse ato kanë krijuar të ardhura nga zhvillimi i aktiviteteve me natyrë specifike, (shfrytëzime minerare, bimë eterovajore, peshkim, hidrokarbure, etj) për të cilat subjektet duhet të pajisen me leje apo autorizime të posaçme dhe që duhet të paguajnë tarifa të posaçme, pavarësisht nëse këto tarifa janë të drejtpërdrejta apo vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë. Në rast të mos reagimit nga këto institucione, të kërkohet zgjidhja e problemeve në rrugë administrative në instanca më të lartë, në rrugë gjyqësore apo të tjera, sipas rastit.
Bashkia Sarandë të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ZVRPP (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qira dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Bashkia Sarandë të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Me Urdhrin nr. 93, datë 21.07.2020, është krijuar "Komisioni i vlerësimit të aplikuesve të subjekteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënproduktet të saj" Nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk janë marren masa për kontabilizimin e detyrimeve si dhe nuk janë kërkuar në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej ***9,350,000***

lekë. *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqen 50-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe anekset bashkëlidhur raportit përfundimtar dërguar me shkresën nr. 365/7 datë.27.09.2019).*

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, dërguar me shkresë nr.1348/35, datë 10.01.21020, kemi theksuar së ky rekomandim nuk pranohet. Në observacionin e derguar nga specialisti i Transportit në Drejtorinë e Shërbimeve sqarohen të gjitha rastet e parkimeve të rezervuara si dhe pagesat e kryera.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit nuk evidentohen hapa të marra lidhur me rekomandimin e lënë për kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës financiare të rekomanduar, hartimin e regjistrave specifik, regjistrimin e pronave të Bashkisë pranë ZVRPP, etj.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka në administrim mbi 50,000 m^2 plazhe, të cilat janë dhënë në përdorim të subjekteve të ndryshëm. Kontratat nuk janë lidhur me administratorët e bizneseve, në asnjë kontratë nuk ndodhet numri i identifikimit të subjektit (NUIS), kontratat janë ndryshuar dhe nuk janë hartuar në përputhje me modelin sipas VKM-ve përkatëse dhe e gjithë kjo mënyrë të vepruari i ka lënë vend abuzimit dhe evazionit fiskal.
Për vitin 2017, janë lidhur 108 kontrata, për një sipërfaqe totale prej **25,366 m^2**. Sipërfaqja totale e plazhit të trajtuar në vitin 2017 rezulton 51,979 m^2. Sipërfaqe për publikun 7,930 m^2. ñBrez sigurieò 18,811 m^2.
Për vitin 2018, janë lidhur 118 kontrata, për një sipërfaqe totale prej **27,548 m^2**. Sipërfaqja totale e plazhit të trajtuar në vitin 2017 rezulton 51,979 m^2. Sipërfaqe për publikun 8,219 m^2. ñBrez sigurieò 20,329 m^2.
Për vitin 2019, janë lidhur 96 kontrata, për një sipërfaqe totale prej **21,574 m^2**. Sipërfaqja totale e plazhit të trajtuar në vitin 2019 është 45,282 m^2. Sipërfaqe për publikun 6,366 m^2. ñBrez sigurieò 16,962 m^2.
Sa sipër nuk është zbatuar kriteri i pikës IV ñ*Dispozitat e Funditò*, paragrafi 1, i VKM-së nr. 321, datë 28.5.2014 ñ*Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore*ò. Në bazë të kësaj dispozite, nga Bashkia Sarandë për të tre vitet e audituara duhet të ishin lënë në dispozicion të publikut gjithsej 30,741 m^2 plazhe ose **8,226 m^2** më shumë, të cilat sipas audituesve të KLSH konsiderohet se i janë marrë pa të drejtë nga administrata e Bashkisë Sarandë *(duke supozuar se janë marrë në konsideratë sipërfaqet e plota të të gjitha plazheve).*
Është abuzuar me tipologjinë e plazheve, në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.5.2016 ñ*Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò në nenin 3 ñ*Tipologjia e plazheve*ò, pasi përgjithësisht, në territorin e Bashkisë Sarandë plazhet janë të tipit B dhe pak të tipit AB, ku ndryshon vetëm gjatësia, jo përbërja apo elemente të tjera.
Plazhet e Sarandës janë konsideruar në mënyrë të qëllimshme dhe abuzive si të tipit A, duke zbritur në llogaritje të ashtuquajturin ñBrez Sigurieò, i cili sidoqoftë nuk përmendet në asnjë akt ligjor apo nënligjor, në kundërshtim me nenin 5 ñ*Kushtet minimale të stacionit të plazhit sipas tipologjisë së plazhit*ò.
Në bazë të argumentit të mësipërm, konstatohet **se për vitin 2017**, duhet të ishin realizuar **112,274,640 lekë** të ardhura nga kontratat e qirave për plazhet ose 81,835,440 lekë më shumë. Në

bazë të llogaritjeve, konstatohet se vlera prej **81,835,440 lekë,** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë.
Nuk është marrë parasysh VKM nr. 369, datë 18.5.2016 ñPër miratimin e rregullores ñPër kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhitò Neni 4 ñKriteret për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhitò, sipas të cilës përcaktohet se stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data 15 maj deri më 30 shtator dhe pika 11 sipas të cilës stacioni i plazhit duhet të mbahet i hapur nga subjektet të paktën gjatë afatit nga data 1 maj deri më 30 shtator.
Nga sa më sipër, krahas pavlefshmërisë së kontratave, nuk është llogaritur në rregull sasia e ditëve për të cilat subjektet duhet të paguajnë qira. Konkretisht, sipas përcaktimit të mësipërm, subjektet duhet të paguajnë 153 ditë qira plazhi. Ky gabim në llogaritje, së bashku me llogaritjet e gabuara të sipërfaqeve të dhëna me qira, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën **24,402,821 lekë**.
Për vitin 2018, të gjitha argumentet janë të njëjta, me përjashtim të afatit, i cili ka ndryshuar për vitin 2019. Konstatohet se paketa fiskale e vitit 2019 nuk është përditësuar me ndryshimet që kërkon VKM-ja nr. 171, datë 27.3.2019 ñ*Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*ò.
Të gjitha llogaritjet janë bërë duke marrë të mirëqenë vlerën e qerasë të miratuar nga Këshilli Bashkiak Sarandë në paketat fiskale të viteve përkatëse, pa shqyrtuar relacionet dhe argumentet që kanë detyruar Këshillin Bashkiak të miratojë këtë lloj uljeje, ndërkohë që të gjitha llojet e indekseve të çmimeve, jo vetëm në vendin tonë por në të gjithë rajonin e më gjerë rriten vit pas viti. Vlera për vitin 2018 është **22,273,108 lekë**.
Vlera prej **128,511,369 lekë** (përkatësisht 81,835,440 për vitin 2017, 22,273,108 për vitin 2018 dhe 24,402,821 për vitin 2019) e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë *(Trajtuar hollësisht në pikën (B) faqen 50-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1 <u>Rekomandimi:</u> Bashkia Sarandë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **128,511,369 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave, sipas kontratës nëse aplikohen, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.
Bashkia Sarandë, të marrë masa, duke zhvilluar edhe korrespondencën përkatëse me Ministrinë e Turizmit, për të verifikuar plotësinë e dokumentacionit dhe afatet kur janë lidhur kontratat e qerasë për plazhet. Për të gjitha plazhet me mangësi në dokumentacion, me mangësi në kushtet e sigurisë apo të stacionit të plazhit dhe për kontratat e lidhura jashtë afatit 31 mars, të fillojnë procedurat e anulimit si të jashtëligjshme dhe plazhet tõi kthehen publikut.

*<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi nga drejtoria e financës nuk është bërë kontabilizimi i vlerës prej **128,511,369 lekë,** Konfirmuar me shkresën nr. 1372 prot, datë 23.04.2020, dërguar degës së thesarit Sarandë.*

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Në Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, dërguar me shkresë nr.1348/35, datë 10.01.2020, kemi theksuar së ky rekomandim nuk pranohet. Detyrimi i mesipërm ka dalë nga llogaritja e gabuar e sipërfaqeve gje e cila është kundërshtuar në observacionin e paraqitur në takimin përfundimtar ballafaques në Tiranë me grupin e auditimit të Klsh-së. Bashkia Sarandë në llogaritjen e sipërfaqeve për vitet 2018 dhe 2019 ka respektuar rekomandimet e Klsh-së në auditimin e realizuar në Bashkinë Sarandë në vitin 2017. Edhe pse kontratat e plazheve janë lidhur

jashtë afateve që përcakton VKM-ja, detyrimet për tarifat janë paguar për gjithë periudhën sipas VKM-së.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit nuk evidentohen hapa të marra lidhur me rekomandimin e lënë lidhur me kontabilizimin e vlerave financiare të llogaritura, aplikimin e penaliteteve ndaj debitorëve për msopagesë në afat të detyrimit, etj.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

4.2 Rekomandim: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Sarandë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Menjëherë

Komente nga subjekti i audituar:
Ska
Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit nuk evidentohen hapa të marra lidhur me rekomandimin e lënë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

B/III. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: -Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 ï 30.6.2019 (*pasqyra Aneks D/1, bashkëlidhur materialit)*, konstatohet se janë kryer gjithsej **59** procedura me vlerë të fondit limit prej **448,589 mijë lekë** dhe vlerë kontrate të lidhur prej **428,482 mijë lekë**, ose mesatare ulje prej 4%.
Mbi bazën e të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur, grupi i auditimit nga **59** procedura me vlerë kontrate 428,482 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **44** procedura me vlerë **390,557 mijë** lekë, ose **91 %** e totalit të kontratave, ku në **23** procedura me vlerë kontrate 235,468 mijë lekë ose 60% e kontratave të audituara, janë konstatuar parregullsi në shpalljen fitues të OE me mangësi në plotësimin e kritereve të DST, procedurat përputhen formalisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për prokurimin publik, pasi KVO nuk është udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, sigurimit të dobishmërisë së përdorimit të fondeve publike, veprime në paligjshmëri ligjit të procedurave të prokurimit për vlerën **22,820,233 lekë** *(Trajtuar hollësisht në pikën (D) faqen 63-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.
1.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimin e fondeve publike, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i LPP, sigurimi i dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, për eliminimin nga procedura të operatorëve me ofertë më të leverdishme dhe me mangësi të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi titullari i AK nuk ka analizuar shkaqet dhe rrethanat që kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimin e fondeve publike.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Nga ana e Autoritetit Kontraktor,në vazhdimësi, do merren masa për eleminimin e gabimeve të konstatuara si nga Njësia e Prokurimit ashtu edhe nga KVO-ja për përdorimin me efiktivitet të fondeve publike.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e institucionit evidentohen disa hapa të marra nëpërmjet nxjerrjes së urdhrave për zbatimin e rekomandimeve, penaliteteve vendosura nga APP, masave displinore të dhëna, etj. Megjithatë ky rekomandim do të vlerësohet për përmbushjen e tij edhe në auditimin e radhës.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e rasteve të procedurave blerje me vlera të vogla, u konstatua në se **6** praktika me vlerë **2,625,270 lekë**, procedurat nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP, pasi në to mungonin disa nga dokumentet shoqërues të cilat duhet të shoqërojnë procedurën, shmangie nga procedurat e prokurimit dhe shpenzime pa efektivitet, Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 4, pika 26, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aseteve në sektorin publikò, pika 35; 36, si dhe Udhëzimi nr. 3, datë 27.01.2015 ñPër Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogëlò i ndryshuar, *VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 8, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 3, date 27.01.2015, "Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 2, datë 24.04.2017, pika 3;* pikën 1, të VKM nr. 870, datë 14.12.2011 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò dhe pika 1 e Udhëzimit nr. 22, datë 10.07.2013 ñMbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 te Këshillit te Ministrave ñPër trajtimin financiar te punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë venditò *(Trajtuar gjerësisht në pikën A faqe 99-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të analizojë shkeljet e konstatuara në **4** rastet me vlerë **2,625,270 lekë,** dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi nga titullari i Bashkisë Sarandë nuk janë analizuar shkaqet dhe rrethanat që kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimin e fondeve publike.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Janë analizuar praktikat e prokurimeve, sipas rasteve të përmendura, mungesën e dokumentacionit në disa praktika për shmangjen nga procedurat e prokurimit dhe shpenzimet pa efektivitet.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Nga ana e Titullarit institucionit janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe konkretisht, është nxjerrë Urdhri nr. 116 dhe 116/1 datë 29.10.2019, Urdhri nr. 147/1 prot, datë 05.12.2019, mbi hartimin e grupit të punës për verifikimin e shkeljeve, planit të veprimit dhe marrjen e masave për zbatim të rekomandimeve të lëna. Nga ana e subjektit mungon vlerësimi dhe nxjerrja e përgjegjësive për këtë rast.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñEKO Kampus Sarandëò, verifikimi i projektit të azhurnuar, të hartuar nga sipërmarrësi, të konfirmuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe projektuesi dhe të miratuar nga AK, si dhe verifikimi i librit të masave, konstatohet se nuk është argumentuar rritja e diametrit të hekurit punues në pllakën e themelit, nga Ø=18 mm, në Ø = 22 mm, si pasojë e të cilit është shtuar 50369 kg hekur gjithsej. Vlera e këtij volumi prej **5,188,003 lekë përbën përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet**. Projekti i këtij objekti, i cili është në vlerë më të madhe se 100 milionë lekë, nuk ka marrë oponencën teknike nga institucioni përkatës dhe për pasojë ndryshimi i projektit ka sjellë rritjen fiktive të vlerës së zbatimit, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar *dhe* kreun I, pika 1, të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 ñPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, me ndryshime *(Trajtuar hollësisht në pikën (D/1.4) faqen 163-166, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1 <u>Rekomandim</u>: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa për shqyrtimin me përgjegjësi të projekteve dhe pajisjen në kohë me oponencën teknike në zbatim të legjislacionit për disiplinimin e punimeve të ndërtimit, me qëllim që projektet të jenë cilësore dhe sa më afër projektit të zbatimit.

3.2. <u>Rekomandim</u>: Projektuesi të marrë masa për hartimin me korrektesë të te gjitha fazave të projektit të zbatimit, në mënyrë që ky projekt të mos pësojë ndryshime thelbësore që ndikojnë në vlerën përfundimtare të objektit.

<u>- Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se</u>: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi titullari i AK nuk ka analizuar shkaqet dhe rrethanat që kanë çuar në paligjshmërinë e përdorimin e fondeve publike.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

<u>Komente nga subjekti i audituar:</u>
Janë marrë masa nga Autoriteti Kontraktor për zbatimin në vazhdimësi të rekomandimit të dhënë.
<u>Qëndrimi i grupit të Auditimit:</u>
Nga ana e Titullarit institucionit janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe konkretisht, është nxjerrë Urdhri nr. 116 dhe 116/1 datë 29.10.2019, Urdhri nr. 147/1 prot, datë 05.12.2019, mbi hartimin e grupit të punës për verifikimin e shkeljeve, planit të veprimit dhe marrjen e masave për zbatim të rekomandimeve të lëna. Megjithatë ky rekomandim do të vlerësohet për përmbushjen e tij në auditimin e radhës.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

C. MASA ADMINISTRATIVE:

<u>C/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.</u>

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të

evidentuar dhe pasqyruar në akt-konstatimet nr. 2 dhe 3, datë 05.04.2019, vërejtjeve e komentet të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.
Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe nenet 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **11 (njëmbëdhjetë) punonjësve,** si më poshtë:
Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, përcjelle në Bashkinë Sarandë dhe KLSH-në me shkresën nr. 7712/6, datë 10.03.2020, e cila është protokolluar në Bashkinë Sarandë me shkresën nr. 1061, prot datë 11.03.2020 duke vendosur masa dënim me gjobe **për 15 persona** (nga të **cilët 4 punonjës** nuk janë në marrëdhënie me Bashkinë Sarandë, ndërsa vetëm 11 **persona** janë në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Sarandë). Për të cilët nga Bashkia Sarandë janë njoftuar personat mbi vendimin e APP, nuk janë kontabilizuar veprimet, dhe nuk kane filluar ndalesat pasi personat e atakuar nga vendimi i APP nr. 14 10.03.2020 kanë bërë kundërshtimin e vendimit në gjykatë. dhe më konkretisht:
Nga 15 persona për shumën e gjobave të vendosura nga APP prej **2,500,000** lekë ,
a. Deri më datën 26.08.2020 nuk është arkëtuar asnjë lekë
b. Janë nisur njoftimet por ende nuk kanë filluar ndalesat.
c. Nuk janë në marrëdhënie pune me Bashkinë 4 persona **860,000 lekë**
d. Në proces gjyqësorë vlera prej 2,260,000 lekë.
Në mënyrë të detajuar vendimet e APP paraqiten si më poshtë:
<u>Për 4 (katër) anëtarët e Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit.</u>
1. z. E , me detyrë specialist prokurimesh në Drejtorinë Juridike. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 200,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/10 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*
2. z. K , me detyrë ish- specialist prokurimesh në Drejtorinë Juridike. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 150,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/13 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë*
3. z. T , me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 40,000 lekë. Me shkresën nr. 3027 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*
4. z. K , me detyrë specialist IT ne Drejtorinë e Shërbimeve. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 130,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/3 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

<u>Për 7 anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave</u>.
1. z. E , me detyrë ish-Drejtor Juridik. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 170,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/7 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*
2. z. A , me detyrë Specialit në DPZHT. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 300,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/6 prot, date*

24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.

3. z. T **,** me detyrë Specialist në Drejtorinë e PZHT. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 200,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/1 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

4. z. M **,** me detyrë Specialist i projekteve dhe infrastrukturës në Drejtorinë e Programimit. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 250,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/2 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

5. z. V **,** me detyrë ish-specialist në DPZHT. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 70,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/14 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

6. z. J **,** me detyrë Zv/Kryetar Bashkie. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 60,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/4 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

7. znj. A **,** me detyrë Specialiste në Drejtorinë Ekonomike. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 150,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/9 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

Shtuar Agjencia e Prokurimit Publik

1. znj. F me detyrë ish kryetare e Bashkisë Sarandë. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 600,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/12 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

2. znj. A me detyrë specialiste në drejtorinë Juridike. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 100,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/8 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

3. znj. G **.** *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 40,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/11 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

4. z. H **.** *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 14, data 10.03.2020, ka dënuar me gjobe ne vlerën 40,000 lekë. Me shkresën nr. 3027/5 prot, date 24.07.2020, është bërë njoftimi për shlyerjen e detyrimit dhe deri në datën e verifikimit datë 26.08.2020, nuk është paguar asnjë lekë.*

Komente nga subjekti i audituar:

Në zbatim të Vendimit nr.14, datë 10.03.2020 të APP-së, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, për çdo person të përmendur në vendim sipas vleftës së rekomanduar, janë hartuar Njoftimet me nr. Datë 24.07.2020.

Njoftim nr.3027/10, dt.24.072020 subjekti E *për shumën 200 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/13, dt.24.072020 subjekti K *për shumën 150 mijë lekë*
Njoftim nr.3027, dt.24.072020 subjekti T *për shumën 40 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/3, dt.24.072020 subjekti K *për shumën 130 mijë lekë*

Njoftim nr.3027/7, dt.24.072020 subjekti E *për shumën 170 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/6, dt.24.072020 subjekti A *për shumën 300 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/1 dt.24.072020 subjekti T *për shumën 200 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/2, dt.24.072020 subjekti M *për shumën 250 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/14, dt.24.072020 subjekti V *për shumën 70 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/9, dt.24.072020 subjekti A *për shumën 150 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/12, dt.24.072020 subjekti F *për shumën 600 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/8, dt.24.072020 subjekti A *për shumën 100 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/11, dt.24.072020 subjekti G *për shumën 40 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/4, dt.24.072020 subjekti J *për shumën 60 mijë lekë*
Njoftim nr.3027/5, dt.24.072020 subjekti H *për shumën 40 mijë lekë*
Të gjithë personat janë në proces gjyqësor në Gjykaten Administrative Shkalla e dytë Tiranë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Nga ana e BS janë ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe konkretisht, është nxjerrë Urdhri nr. 116 dhe 116/1 datë 29.10.2019, Urdhri nr. 147/1 prot, datë 05.12.2019, mbi hartimin e grupit të punës për verifikimin e shkeljeve, planit të veprimit dhe marrjen e masave për zbatim të rekomandimeve të lëna Urdhri nr. 95 datë 23.07.2020 mbi zbatimin e vendimit të APP. Detyrimet janë përfshirë në listat e debitorëve të institucionit dhe janë bërë njoftimet përkatëse.

Nr	Emri	Mbiemri	Pozicioni	Rekomanduar Shuma lekë	Arkëtuar deri 31.03.21	Në proces gjyqësor	Nisur njofimet
1	E	L	S/prok. D.Juridike	200,000	9,000	PO	3027/10 24.07.2020
2	K	M	Ish. s/prok. D.Juridike	150,000			3027/13 24.07.2020
3	T	K	S/Dr.Shërbimeve	40,000	9,000	PO	3027 24.07.2020
4	K	A	S/ IT Dr. Shërbimeve	130,000	9,000	PO	3027/3 24.07.2020
5	E	G	ish-Drejtor Juridik	170,000	9,000	PO	3027/7 24.07.2020
6	A	B	S/ DPZHT	300,000	9,000	PO	3027/6 24.07.2020
7	T	H	S/ DPZHT	200,000	9,000	PO	3027/1 24.07.2020
8	M	Z	S/ Dr, Programimit	250,000	9,000	PO	3027/2 24.07.2020
9	V	T	ish-s/ DPZHT	70,000			3027/14 24.07.2020
10	J	M	Zv/Kryetar Bashkie	60,000	9,000	PO	3027/4 24.07.2020
11	A	D	S/Dr. Ekonomike	150,000	0	PO	3027/9 24.07.2020
a	**Shuma 1**			**1,720,000**	**72,000**		
	Shtuar APP						
12	F	K	Ish Kryetare Bashkisë	600,000			3027/12 24.07.2020
13	A	D	S/ D. Juridike	100,000	9,000	PO	3027/8 24.07.2020
14	G	M		40,000			3027/11 24.07.2020
15	H	K		40,000	9,000	PO	3027/5 24.07.2020
b	**Shuma 2**			**780,000**	**18,000**		
a+b+c	**TOTALI**			**2,500,000**	**90,000**		

Për periudhën Janar-Mars janë mbajtur rreth 90,000 lekë të reja për 10 punonjësit aktualë me një vlerë ndalese mujore 3,000 lekë/muaj, ndërkohë që vlera e plotë e detyrimit është 2.5 milion lekë. Pra arkëtimi gjendet në nivelin 3.6% të totalit të detyrimit. Ndërkohë nuk evidentohen arkëtime apo masa të marra për arkëtimin e ish punonjësve të tjerë, çka paraqet nevojën për marrjen e masave të menjëherëshme për rikuperimin e vlerave financiare si dhe përmbushjen e plotë detyrës nga ana e strukturave të ngarkuar për rikuperimin e tyre.

Statusi aktual i rekomandimit
Në proces zbatimi

C/2. Për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT).

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit",* i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a), të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Sarandë që** të kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative (gjobë) për një mbikëqyrës dhe një kolaudator punimesh**, si më poshtë:

1. Z. B , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me kontratën nr. 20/1 prot datë 21.12.2015, për shkeljet e konstatuara në objektin **"***EKO Kampus Sarandë", Bashkia Sarandë*, me sipërmarrës punimesh BOE ñB ò SHPK & ñP ò SHPK & ñB ò SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,136,810 lekë pa TVSh,** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Z. R , në cilësinë e drejtuesit ligjor të kolaudatorit të punimeve, me kontratën nr. 20/2 prot., datë 31.08.2018, për shkeljet e konstatuara në objektet ñEKO Kampus Sarandëò, Bashkia Sarandë, me sipërmarrës punimesh BOE ñB ò SHPK & ñP ò SHPK & ñB ò SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,136,810 lekë pa TVSh,** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt *(Trajtuar hollësisht në pikën (D/.1.4) faqen 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3. Z. I , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në objektin: ñRikonceptimi dhe Rivitalizimi i Qendrës së Qytetit të Sarandës, Rruga e Flamuritò, Bashkia Sarandë, me sipërmarrës punimesh BOE ñE ò & ñF ò SHPK, sipas kontratës nr. 6 prot, datë 30.06.2016 me vlerë 102,518,468 lekë me TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **1,537,700 lekë** pa TVSH, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt *(Trajtuar hollësisht në pikën (D/.1.4) faqen 163-173, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

-Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Kryetari i Bashkisë Sarandë ka nxjerr Urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 ku i ka kërkuar "Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor" të vlerësoj shkeljet e konstatuar dhe të vendos masë administrative (gjobë) për dy mbikëqyrës dhe një kolaudator punimesh. Deri në datën e verifikimit datë 24.07.2020 nga ana e IMTV Sarandë nuk është vendosur asnjë masë administrative.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Nr	Emri	Mbiemri	Pozicioni	Rekomanduar Shuma lekë	Arkëtuar deri 31.03.21	Në proces gjyqësor	Nisur njofimet
1	B	S	Mbikëqyrës	3,136,810	0		
2	R	S	Kolaudator	3,136,810	0		
3	I	P	Mbikëqyrës	1,537,700	0		
					0		

Komente nga subjekti i audituar:
Janë arkëtuar 93 mijë lekë personave aktualisht në marrëdhënje pune me Bashkinë, të gjithë personat janë në proces gjyqësor në Gjykaten Administrative Shkalla e dytë Tiranë.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Penalitetet e rekomanduara nuk rezulton të jenë vendosur nga ana e Kryeinspektorit të IMTV, në kundërshtim kjo me urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 të Bashkisë Sarandë.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

D. MASA DISIPLINORE:

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, germat (b, c, ç) e nenin 58-ñ*Llojet e masave disiplinore*ò, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 ñPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò, nenet 37 dhe 144, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò dhe nenit 9- *"Masa disiplinore",* të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë** që të kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH ï së, për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2018, të fillojnë procedurat për dhënien për **9 (nëntë)** punonjësve, si më poshtë**:**

a- *"Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",* neni 58 shkronja (b, c), deri në *"Largim nga Shërbimi Civil"*, për 8 (tetë) punonjësit *Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr.* 365/8 datë.27.09.2019 *ka nxjerr Urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 "Për marrjen e masave disiplinore".*

-Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Nga 8 masa të rekomanduara për masën "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet" , ***nga drejtoria e burimeve njerëzore nuk është ngritur komisioni disiplinor*** *për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga KLSH dërguar në Bashkinë Sarandë me shkresën nr. 365/8 datë.27.09.2019, për marrjen e masave disiplinore për 8 punonjesit. KLSH nuk është dakord me vendimin e Bashkisë Sarandë për mos marrjen e masës disiplinore ndaj 8 punonjësve, për të cilët i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që t'i rikërkojë Komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet" : si më poshtë:*

1. z. J , me detyrë Nënkryetar i Bashkisë, i komanduar si Drejtor i Tatim-Taksave. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

2. z. T , me detyrë Specialist për Transportin. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

3. zj. N , me detyrë specialiste e Sektorit të Inspektimit në Terren, në Drejtorinë e Tatim-Taksave. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

4. z. P **,** me detyrë specialist terreni në Drejtorinë e taksave Vendore. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

5. z. A , me detyrë arkitekt në Njësia Administrative Ksamil. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

6. z. T , me detyrë Specialist i Infrastrukturës Inxhinierike, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

7. z. L , me detyrë Specialist i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

b-"*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*", neni 58 shkronja (c), për 1 (një) punonjës, si vijon:

1. znj. T , me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, shkronja ñeò dhe ñçò të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë** të vlerësojë shkeljet e

konstatuara, duke vendosur marrjen e masës, ñ**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna"** deri në **"Largim nga puna", për 1 punonjës,** si më poshtë:
Nga verifikimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr. 365/8 datë 27.09.2019 ka nxjerr Urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 për marrjen e masave disiplinore, "Vërejtje me shkrim" për zj. V masë e cila rezulton e pa zbatuar, KLSH nuk është dakord me vendimin e Bashkisë Sarandë për mos marrjen e masës disiplinore ndaj zj. V , për të cilët i ri-kërkojmë Kryetarit të Bashkisë që, të filloj procedurat për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" deri në "Largim nga puna, si më poshtë:

1. zj. V , me detyrë Administratore e NjA Ksamil. *Nga verifikimi rezultoi se në dosjen individuale të punonjëses nuk ndodhet asnjë dokument për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", nga Kryetari i Bashkisë Sarandë në zbatim të rekomandimeve të KLSH.*

Komente nga subjekti i audituar:
Në zbatim të Urdhrit nr.116/1, datë 29.10.2019, të Kryetarit të Bashkisë, janë pranuar dhe janë dhenë masat disiplinore sipas këtij Urdhri sipas kolonës të tabeladhe në zbatim të Urdhrit nr.11, datë 22.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë, për ngritjen e Komisionit Disiplinor pë nëpunësit civilë të institucionit të Bashkisë, nga Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore janë berë njoftimet si me poshtë :
-Znj.V Administratore në Nj.A. Ksamil Njoftim nr.331/1 datë 22.01.2021
-Z.A Specialist i sekretarisë teknike Njoftim nr.331/2 datë 22.01.2021
-Z.J N/Kryetar i Bashkisë, i komanduar Drejtor i Tatim-Taksa me Njoftim nr.331/3, datë 22.01.2021
-Znj.T Drejtore e Dreëjtorisë së Zhvillimit Ekonomik Financiar me Njoftim nr.331/4, datë 22.01.2021
-Z.P Specialist –Inspektor veprimi i taksave në terren me Njoftim nr.331/5, datë 22.01.2021
-Z.T Specialist i Infrastrukturës Inxhinjerike në Dr.Planif.Kontroll Teritorit njoftim nr.331/6 dt.22.01.21
-Z.L Specialist projektimi dhe Infrastrukture në Dr.Shërbimeve me Njoftim nr.331/7, datë 22.01.2021
-Z.T Specialist për Trasportin dhe Sinjalistiken me Njoftim nr.331/8, datë 22.01.2021
-Znj.N me detyrë Specialist Inspektor Veprimi në Taksat në terren me Njoftim nr.331/9, datë 22.01.2021.

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni Zyrtar	Rekomandimi i KLSH dhe i APP	Masa e zbatuar		
				Masa Disipl.e dhënë dhe pranuar.	Shkresa apo vendimi nr dhe data	Lloji i masës së zbatuar
1	J	Nënkryetar i Bashkisë	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje me shkrim*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
2	T	Specialist për Transportin	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
3	N	specialiste e Sektorit të Inspektimit në Terren, në Drejtorinë e Tatim-Taksave	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Pa masë*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**

4	P	specialist terreni në Drejtorinë e taksave Vendore	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje me shkrim*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
5	A	arkitekt në Njësia Administrative Ksamil	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje me shkrim*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
6	T	Specialist i Infrastrukturës Inxhinierike në PZHT	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
7	L	Specialist i Shërbimeve Publike	*Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje me shkrim*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
8	T	Drejtore e Drejtorisë Ekonomike	*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet",*	*Vërejtje*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**
9	V	Administratore e NjA Ksamil	*Largim nga puna*	*Vërejtje me shkrim*	Urdhri nr.116/1, datë 29.10.2019	**zbatuar**

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Kryetari i Bashkisë Sarandë ka nxjerr Urdhrin nr. 116/1 datë 29.10.2019 për marrjen e masave dhe pas rreth 14 muajsh. Prej institucionit në zbatim të Urdhrit nr.11, datë 22.01.2021 të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur Komisioni Disiplinor dhe janë marrë masat displinore të cituara më mësipër të cilat në shumicën e tyre nuk përputhen me rekomandimet e lëna nga KLSH.

Statusi aktual i rekomandimit
Zbatuar pjesërisht

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTARTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civilò, të ndryshuar.

-Nga verifikimi i mëparshëm ka rezultuar se: Nga sektori i burimeve njerëzore nuk ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Statusi i mëparshëm i rekomandimit
Pa zbatuar

Komente nga subjekti i audituar:
Ska koment
Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Nga ana e institucionit nuk rezulton të jetë njoftuar Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për masat e marra.

Statusi aktual i rekomandimit
Pa zbatuar

ANEKSI nr.7
"Mbi trajtimin e ankesave të paraqitura në KLSH"

1. Ankesa e paraqitur nga z. A C administruar në KLSH me shkresën nr. 512 prot., datë 10.06.2020.
Për sa trajtohet nga ankuesi u kërkua informacion zyrtar nga Drejtoria Jurdike në Bashkinë Sarandë mbi këtë çështje. Me relacionin e datës 25.03.2021 kjo Drejtori ka sqaruar si më poshtë vijon:

Z.A C është pronar i një trualli i cili bën pjesë në njësinë strukturore SA.UB.3.394, zonë kjo pa studim pjesor urbanistik. Gjithashtu dhe prona kufitare me Z.A C bën pjesë në Njësinë Strukturore SA.UB.3.406, zonë pa studim pjesor urbanistik.
Për sa i përket nxjerrjes së Aktit ï Administrativ "Studim Zone Pjesor", Bashkia Sarandë nuk mund të ndërhyj për të nxjerr një akt-adminsitrativ të tillë pasi nuk është kompetenca e saj por kjo është kompetencë e Këshillit Kombëtar të Terrritorit (KKT) si një organ kolegjial i cili funksionon pranë Këshillit të Ministrave.
Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) me vendimin nr. 3 datë 16.10.2017, i cili ka hyrë në fuqi më datë 19.03.2018, ka miratuar PPV (Planin e Përgjithshëm Vendor), ku në të përfshihet dhe Zona objekt gjykimi. Theksojmë se nga ana e Bashkisë Sarandë nuk mund të kryhej asnjë Studim Pjesor për aq kohë sa ky Plan është në fuqi. Duke qenë në këto kushte se nga ana e Bashkisë Sarandë nuk mund të ndërhyej Z. A C ka paraqitur Padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë, me objekt "Kalim Servituri", padi e cila është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, e cila më vonë është bërë e ekzekutueshme në terren.
Për sa i përket pretendimit lidhur me Z. A R , Bashkia Sarandë dhe Z. R janë në proces gjyqësor për 3 Padi për të cilat Bashkia Sarandë është palë e paditur.
1-Padia e parë ka për objekt Servitur Kalimi,
2-Padia e dytë ka për objekt Parashkrim Fitues,
3-Padia e tretë Kundërshtimin e vendimit të IVMT-Bashkia Sarandë.
Z. C në dy paditë e para është ndërhyrës kryesor.

Deri në këtë fazë të auditimit Paditë janë duke u gjykuar në gjykatën përkatëse sipas objektit.

2. Shkresa "Për dijeni" paraqitur për nga z. E D j, administruar në KLSH me shkresën nr. 788 prot., datë 17.08.2020.
Më datë 17.08.2020 Z.E D i është drejtuar Prokurorsië së Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me një kallzim për Kryetarin e Bashkisë Sarandë Z.A G për disa vepra penale, Shpërdorim detyre, Shkelja e barazisë së Shtetasve, Korrupsioni Pasiv i Funksionarëve të Lartë Shtetërorë ose i të Zgjedhurve Vendorë, Falsifikimi i Dokumentacionit..

Këtë kallëzim Z.D e ka paraqitur për dijeni në disa institucioneve të tjera Këshilli i Ministrave dhe KRRTRSH Tiranë si dhe pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Për sa trajtohet nga ankuesi, lidhur me shitjen e një sipërfaqe trualli nga Bashkia Sarandë shtetases K B , u kërkua informacion zyrtar nga Drejtoria Jurdike në Bashkinë Sarandë mbi këtë çështje. Me relacionin e datës 25.03.2021 kjo Drejtori ka sqaruar si më poshtë vijon:
Ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe Z. K D (i ati i qytetarit E D j), ka patur një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për të cilin ka qenë palë paditëse:
Bashkia Sarandë dhe i Paditur: K D , me objekt òAnullimin e Vendimit nr. 13, datë 25.07.2000 të Këshillit Bashkiak Sarandëò, në emër të të paditurve. Anullimin tërësisht të kontratë së shitblerjes së truallit të të paditurve në bazë të vendimit nr. 13 datë 25.07.2000 si dhe fshirjen nga hipoteka të këtyre regjistrimeve.
Gjykata pasi ka shqyrtuar provat dhe faktet e këtij gjykimi ka vendosur: Pranimin e padisë sipas objektit të saj.
Vendimi mban nr.600, datë 04.10.2001, i cili nuk është ankimuar nga palët E l D , por është apeluar nga Z. G Z , ku ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit në bazë të vendimit nr. 20-2015-500/309, datë 26.05.2015.

3. Shkresa "Për dijeni" e paraqitur nga disa banorë të Bashkisë Sarandës administruar në KLSH me shkresën nr. 310 prot., datë 02.03.2021.
Më datë 23.02.2021 disa qytetarë të cilët janë blerës të disa apartamenteve në qendër të Qytetit të Sarandës i janë drejtuar Kryetarit të Bashkisë Sarandë dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë me një ankesë e cila është dërguar për dijeni edhe të disa institucioneve të tjera si Kryeminsitrit të Shqipërisë, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si dhe pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Në ankesën e tyre trajtojnë problematikën në një objekt banimi në të cilin dy katet e fundit nuk kanë mbaruar dhe përbëjnë rrezik për shembje dhe lagështirë. Gjithashtu banorët ngrenë shqetësimin për mospajisjen me çertifikatat e pronësisë. Për këtë problematikë nuk kanë gjetur zgjidhje nga investitori i objektit pasi nga ky i fundit pretendohet se, Bashkia Sarandë nuk zbatuar vendimet e gjykatave dhe së fundi atë të Gjykatës së Lartë mbi këtë çështje.

Për sa trajtohet në shkresë nga ana jonë u kërkua informacion zyrtar nga Drejtoria Jurdike në Bashkinë Sarandë mbi këtë çështje. Me relacionin e datës 25.03.2021 kjo Drejtori ka sqaruar si më poshtë vijon:

Bashkia Sarandë dhe z. G Z janë në konflikt gjyqësor çështje e cila nuk ka përfunduar. Nga ana e kësaj drejtorie është sqaruar gjithashtu se, Z. G Z ka ngritur padi kundër Bashkisë Sarandë me objekt "Detyrimin e Bashkisë Sarandë të shprehet me akt-administrativ për pajisje me leje ndërtimiò. Me Vendimin nr. 23-2013-2285/1553 datë 12.2.2013 është vendosur "Pranimi i padisëò, detyrimin e palës së paditur Bashkia Sarandë të shprehet me akt-administrativ në përputhje me kërkesat e ligjit, për trajtimin e kërkesës së paditësit G Z për pajisje me leje ndërtimi të miratuar me Vendimin e KKRT-së Bashkia Sarandë. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 27.11.2013. Më datë 29.01.2019, paditësi ka bërë padi si kërkues në Gjykatën e Shkallës së Parë Sarandë, me objekt *"Sqarim interpretim vendimi* ò, vendim i cili është apeluar nga Bashkia Sarandë në bazë të Ankimit nr. 1838 prot., datë

12.07.2019, ku në bazë të këtij ankimi, Gjykata e Apelit në bazë të Vendimit nr.20-2020-716/103, dat 24.09.2019 ka vendosur:
-Prishjen e vendimit nr. nr. 23-2019-747 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e Çështjes për gjykim në lidhje me kompetencën lëndore të Gjykatës së Lartë e cila nëpërmjet Kolegjit Administrativ në bazë të vendimit nr. 002-2020-127, datë 15.06.2020 ka vendosur:
-Përcaktimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje.
-Prishjen e Vendimit nr. 103 datë 24.09.2019 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë.

Deri në këtë fazë të auditimit çështja është për gjykim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe vazhdon të gjykohet.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT